

1 E hënë, 9 shkurt 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat përmbyllëse]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.10

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Sekretar i
7 seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
9 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
11 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
13 të gjithëve. Mirëmëngjes, dhe sikurse e dini sot do të
14 vazhdojmë me çështjen përmbyllëse të 06-s. Por, së pari,
15 dëshiroj që t'i kërkoj palëve që të prezantohen se kush është
16 i pranishëm në sallën e gjyqit, duke filluar nga Prokuroria.

17 ZNJ. WEST: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës,
18 sot ZPS-ja përfaqësohet nga Nathan Quick, Clare Lawson, z.
19 Alan Tieger, dhe Matthew Halling. Ndërkohë që unë jam Kim
20 West, Prokurore e Specializuar.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
22 Prokurore.

23 Mbrojtësi i Viktimave.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës, unë
25 jam Simon Laws. Jam përfaqësuesi i viktimave në këtë çështje.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Mbrojtësi i z. Thaçi.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

4 Unë jam Luka Misetiç, që jam Mbrojtja e z. Thaçi. Kam së

5 bashku znj. Nina Tavakoli; kemi këtu së bashku edhe z. Matej

6 Pustay, dhe dy anëtarë të tjerë të Mbrojtjes së z. Thaçi.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon.

8 Z. DIXON: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës,

9 unë jam Rodney Dixon, për z. Veseli. Unë mbështetem nga znj.

10 Rowan, znj. O'Reilly, ndihmësja ligjore dhe gjithashtu edhe

11 Herme Misetiç [Sipas përkthimit].

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

13 z. Dixon.

14 Z. Roberts, fjala është për juve, Mbrojtjen e z. Selimi.

15 Mirëmëngjes,

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës,

17 unë jam Geoff Roberts, përfaqësoj z. Selimi. Së bashku jam me

18 ekipin tim, me Eric Tully, me Chad Mair, Fortuna Sheremeti,

19 dhe pas meje janë dy persona të tjerë të ekipit tonë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani Mbrojtja

21 e z. Krasniqi.

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar

23 Gjykatës, unë jam znj. Alagendra për z. Krasniqi. Së bashku me

24 mua është z. Aidan Ellis, dhe Victor Baiesu që janë

25 bashkëmbrojtës; z. Mentor Beqiri, dhe z. Jakup Boriqi që janë

1 bashkëpunëtorë dhe janë mbështetës tonë; dhe një person tjetër
2 i ekipit është gjithashtu i pranishëm si pjesë e Mbrojtjes së
3 z. Krasniqi.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga Zyra
5 Administrative.

6 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Unë jam Fidelma Donlon, jam
7 Administratore e Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Për procesverbal, vërej që të katër të akuzuarit janë të
10 pranishëm në sallën e gjyqit sot.

11 Përpara sesa të fillojmë me argumentet përmbyllëse, me
12 deklaratat përmbyllëse, ka kërkuar leje fotografi në mënyrë të
13 tillë që të mund të bëjë disa fotografi të sallës së gjyqit.

14 Mund të vazhdoni, zotëri.

15 Sot do të vazhdojmë me deklaratat përmbyllëse të kësaj
16 çështje. Do të ndjekim rendin e ditës që është përcaktuar në
17 urdhrin e Trupit Gjykues për deklaratat përmbyllëse që është
18 parashtrimi i protokolluar F03639. Si kujtues, dua t'ju them
19 që seanca e ditës së sotme është planifikuar që të përfundojë
20 në orën 16.45. Do të kemi pushime të planifikuara për gjysmë
21 ore, njëherën në orën 10.30; më pas do të kemi pushimin në orën
22 11.00, që është pushimi i zakonshëm; kemi një pushim për
23 drekë, që është 1 orë e 30 minuta që fillon në orën 1.00; dhe
24 më pas kemi një pushim prej 15 minutash që fillon në orën
25 14.30; kemi dhe një pushim tjetër, 15 minuta, në orën 15.30 që

1 do të fillojë në 15.45.

2 Përpara kësaj ne kemi disa çështje paraprake që
3 dëshirojmë që të trajtojmë.

4 Së pari, në datën 6 nëntor 2025, Trupi Gjykses lëshoi
5 urdhrin F03565 në të cilin urdhëroi palët dhe pjesëmarrësit që
6 të jepen parashtrimet e tyre lidhur me realizueshmërinë e
7 procesit të zhdëmtime pas përfundimit të argumenteve
8 përmbyllëse dhe përpara nxjerrjes të aktgjykimit për këtë
9 çështje gjyqësore. Pasi ka shqyrtuar parashtrimet e palëve dhe
10 të pjesëmarrëse, Trupi Gjykses konfirmon se ai ruan apo mban
11 pozicionin e vet të cilin e ka parashtruar më përpara në
12 urdhrin e datës 4 dhjetor 2024, konkretisht që kërkesat për
13 zhdëmtime duhet të dorëzohen nga Mbrojtësi i Viktimave pas
14 aktgjykimit në këtë çështje dhe pas vendimeve të fajësisë, në
15 qoftë se ato do të jepen si të tilla për pika të ndryshme dhe
16 pas vendimmarrjes së Trupit Gjykses.

17 Së dyti, Trupi Gjykses rikujton që ZPS-ja dhe Mbrojtja e
18 Krasniqit, Mbrojtja e Selimit, përkatësisht kanë kërkuar që
19 anëtarë të ekipeve të tyre të kenë të drejtën për audiencë për
20 qëllime të pjesëmarrjes në pjesë të deklaratave përmbyllëse.
21 Pra, në mënyrë të tillë që ata të mund të kenë mundësi që të
22 flasin në parashtrimet e tyre.

23 Përderisa palët dhe pjesëmarrësit nuk kanë shprehur
24 kundërshtime të tyre, Trupi Gjykses ju jep të drejtë këtyre
25 anëtarëve të ekipeve të Mbrojtjes, gjithashtu, znj. Lawson nga

1 ZPS-ja që të marrin fjalën kurdo që palët përkatëse e shikojnë
2 të arsyeshme.

3 Gjithashtu, përderisa, sikurse e dini ky proces gjyqësor
4 po përkthehet, do ju kërkonim që të flisnit zakonisht, pra si
5 zakonisht do ju kërkoja që të flisnit me ngadalë në mënyrë të
6 tillë që të kapeni në çdo gjë që thoni.

7 Këto janë komentet e Trupit Gjyqësor. Ndërkohë që fillojmë
8 me Zyrën e Prokurorit. Prokurori i Specializuar ka kërkuar
9 tetë orë në dispozicion, kështu që dëshiroj t'i jap fjalën
10 Prokurores për të vijuar me parashtimet e saj.

11 ZNJ. WEST: [Përkthim] Mirëmëngjes, Trupi Gjyqësor, znj.
12 Administratore, mirëmëngjes të gjithëve që na ndiqni brenda
13 Gjykatës dhe jashtë saj.

14 Është privilegj që t'ju drejtohem sot këtu në përmbylljen
15 e çështjes më të madhe që përfundojmë sot dhe që është
16 realizuar prej këtij institucioni të nderuar. Duke lënë pas më
17 tepër sesa pesë vite, Dhomat e Specializuara të Kosovës janë
18 bërë një gjykatë e rregullt dhe konvencionale, duke realizuar
19 seanca gjyqësore dhe gjykime, dhe duke i dëshmuar mbarë botës
20 se drejtësia ndërkombëtare dhe sundimi i ligjit është rutinë
21 dhe punë e zakonshme brenda këtyre katër mureve. Gjithashtu,
22 ne kemi dëshmuar se klima e frikësimit mund të menaxhohet në
23 një mënyrë që siguron që e vërteta do të dëgjohet. Me pak
24 fjalë, ne jemi bërë një Gjykatë funksionale e suksesshme në
25 një periudhë relativisht të shkurtër.

1 Falënderimet për këtë, sigurisht, i shkojnë gjyqësorit,
2 DHSK-së dhe ZPS-së dhe stafit të tyre, i takojnë gjithashtu
3 dhe ekipeve të Mbrojtjes që janë ulur përpara meje sot edhe
4 Mbrojtjes së Viktimave, të cilët kanë, të marra së bashku,
5 dekada përvojash ligjore, dhe të gjithë të cilët kanë ushtruar
6 detyrat e tyre me një profesionalizëm dhe ekspertizë të
7 admirueshme.

8 Çdo avokat i ri që ka qenë në këtë Gjykatë e ka dëshmuar
9 dhe e ka parë me sytë e veta dhe ka mësuar shumë prej kësaj
10 përvoje.

11 Megjithatë, falënderimet më të përzemërta i ruaj për ata
12 që e kanë merituar më tepër, për ata të cilët e kanë marrë
13 barrën në shpatullat e tyre për të siguruar që sundimi i
14 ligjit i ofrohet popullit të Kosovës. Dhe e kam fjalën
15 posaçërisht për viktimat dhe dëshmitarët të cilat kanë ardhur
16 përpara kësaj Gjykate për të dhënë dëshmitë e tyre.

17 Pavarësisht frikërave, kërcënimeve, stigmës dhe pavarësisht
18 këtyre situatave me të cilët janë përballur dëshmitarët dhe
19 familjet e tyre, nga një grup i kufizuar por me zë në Kosovë,
20 këta dëshmitarë e kanë dëshiruar kaq shumë të vërtetën që të
21 dalë në pah sa pavarësisht të gjitha pengesave kanë zgjedhur
22 që të bashkëpunojnë me zyrën time dhe të japin dëshmi përpara
23 kësaj Gjykate. Të gjitha i kanë bërë në përpjekje për të
24 ndihmuar për krijimin e një historiku të besueshëm dhe të
25 ndershëm të ngjarjeve nga 1998 dhe 1999 ku mbi 100 persona

1 janë vrarë dhe qindra të tjerë janë abuzuar në dhe përreth 50-
2 plus kampe ndalimi të UÇK-së.

3 Kjo çështje ka të bëjë me qëllimin e këtyre katër të
4 akuzuarve për të fituar dhe për të ushtruar kontroll në të
5 gjithë Kosovën. Kjo vendosmëri për kompetencë dhe për fuqi u
6 has me diçka, dhe kjo kishte të bënte me personat të cilët i
7 kishin dalë përpara dhe që konsideroheshin si oponentë,
8 persona të cilët ose ishin ose perceptoheshin që ishin
9 bashkëpunëtorë me forcat serbe ose zyrtarë serbë, ose
10 institucionet shtetërore ose që nuk mbështesnin synimet dhe
11 mjetet e UÇK-së dhe më pas të Qeverisë së Përkohshme të
12 Kosovës. Shpesh këtu përfshiheshin personat lidhur me LDK-në,
13 persona me etnicitete rome dhe serbe. Dhe në mënyrë të arrinin
14 qëllimin e tyre, të akuzuarit kanë kryer krime kundër
15 kundërshtarëve të tyre të perceptuar për të patur kontroll në
16 të gjithë Kosovën.

17 Të nderuar Gjykatës, ju keni dëgjuar dëshmi të
18 Prokurorisë, të dëshmitarëve të Prokurorisë të thërritur në
19 këtë çështje, përfshirë këtu dhe anëtarë të UÇK-së. Gjithashtu,
20 edhe kosovarë nga fusha të ndryshme të jetës, viktimat të
21 ndryshme me etnicitete të ndryshme dhe anëtarë të familjeve të
22 tyre si edhe disa ndërkombëtarë të cilët kanë qenë të
23 pranishëm në Kosovë në '98-n dhe '99-n. Dëshmitë e të gjithë
24 dëshmitarëve, si dhe të gjitha provat shkresore, video ose
25 forenzike tregojnë se këto krime janë kryer dhe se të

1 akuzuarit mbajnë përgjegjësi ligjore për to.

2 Gjykata gjithashtu ka dëgjuar dëshmi drejtpërsëdrejti nga
3 disa dëshmitarë të Mbrojtjes, nga shtatë dëshmitarë të
4 Mbrojtjes, të gjithë ndërkombëtarë, të cilët ishin të
5 përfshirë në përpjekje për të sjellë paqe dhe administrim të
6 Kosovë dhe që duhet të përgëzohen për përpjekjet e tyre. Por,
7 ndërkohë që përfshirja e tyre në këtë çështje dhe konstatimet
8 e kufizuara të tyre kanë vlerë për këtë Gjykatë, puna e kësaj
9 Gjykate është tërësisht e ndryshme. Për pjesën dërmuese,
10 shtatë dëshmitarët ndërkombëtarë janë hedhur në një situatë me
11 pak informacion lidhur me aktorët kryesorë të përfshirë, nuk e
12 kanë folur gjuhën në atë kohë, kanë ndërverpuar ballë për
13 ballë me aktorët kryesorë vetëm për pak herë dhe thujse nuk
14 kanë parë asnjëherë rregullore, urdhra dhe komunikata të UÇK-
15 së dhe nuk ishin fare të njohur me strukturën e UÇK-në.

16 Për kontekstin e punës së tyre konkrete kjo shtresë e
17 pakët informacioni mund të ketë qenë e mjaftueshme, por, është
18 absolutisht jo e përshtatshme për të nxjerrë fakte dhe për
19 gjetjen e fakteve të sakta nga kjo gjykatë.

20 Të nderuar Gjykatës, ne do tregojmë disa diapozitiva
21 gjatë ditës së sotme dhe dëshirojmë të them që të gjithë
22 diapozitivat e përdorura prej nesh mund të transmetohen për
23 publikun, me përjashtim të rasteve kur do të themi ndryshe.

24 Kjo mungesë informacioni është përshkruar më së mirë nga
25 një dëshmitar i vetë Mbrojtjes, zëvendësi i UNMMIK-ut i cili

1 ndërkohë që ofroi që të shpjegonte për Gjykatën rolin e një
2 diplomati dhe se si ata mbërrinin në gjykimet ose vlerësimet e
3 tyre, tha si më poshtë:

4 "Është detyrë, rol i Gjykatës që për aq sa është e mundur
5 të mbledhë prova empirike. Mbase mund të jetë pak e paqartë që
6 kjo është mënyra se si funksionon dhe si punojmë ne si
7 diplomatë dhe pagebërës për të mbërritur në përfundimet tona.
8 Diplomatët e dinë që prej fillimit që thuajse gjithmonë ato
9 nuk do ta dinë asnjëherë historinë të plotë. Atyre ju duhet që
10 të bëjmë gjykimet, të bëjnë strategji, të këshillojnë qeveritë
11 e tyre mbi bazën e informacionit domosdoshmërisht të paplotë."

12 Dhe ky informacion i paplotë, sigurisht, pa diskutim
13 lidhet me atë që është shumë e rëndësishme për këtë Gjykatë
14 dhe që duhet të përcaktohet si përparësi prej kësaj Gjykate,
15 që janë provat empirike.

16 Kjo është e vërtetë jo vetëm për zëvendësin e UNMIK-ut që
17 e tha shprehimisht atë në dëshmi, po është njësoj vërtetë edhe
18 për dëshmitarë të tjerë ndërkombëtarë të thirrur nga Mbrojtja
19 në këtë çështje gjyqësore.

20 Fatkeqësisht, ky gjykim nuk i ka shpëtuar klimës së
21 frikësimit të dëshmitarëve që ka qenë insistuese edhe e
22 shtrirë në kohë, dhe që ishte parashikuar prej nesh që prej
23 fillimit dhe deri në masën që Gjykata duhej të konsiderojë atë
24 për ta bërë një vlerësim të drejtë të besueshmërisë dhe
25 mbështetshmërisë së dëshmitarëve. E vërteta është që dëshmi

1 për këtë kanë qenë edhe disa prej përpjekjeve që kanë ndodhur
2 këtu në Hagë.

3 Pavarësisht kësaj, Gjykata ka prova të shumta, për
4 shembull, të akuzuarit janë anëtarë, kanë qenë anëtarë të
5 Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së përpara nëntorit të 1998-s,
6 dhe ka prova që komandantët e zonave kanë marrë urdhra nga të
7 akuzuarit dhe jo e kundërta. Janë bërë përpjekje të qarta për
8 të ndryshuar, për të zbutur, ose për të ndikuar ndryshe dëshmi
9 të caktuara, në veçanti për përfitime të të akuzuarit Hashim
10 Thaçi, të cilat kanë dalë në pah.

11 Ka disa shembuj domethënës dhe përfaqësues të këtyre
12 përpjekjeve që janë tanimë pjesë e procesit gjyqësor, si dhe
13 përpjekje për të shtrembëruar gjetjen e fakteve apo zbulimin e
14 fakteve nga kjo Gjykatë. Dhe si rezultat, pra, ky është një
15 element që do të duhet të merret parasysh me hollësi nga
16 Gjykata.

17 Pavarësisht këtyre përpjekjeve, shumë dëshmitarë nuk janë
18 penguar nga sigurimi i një dëshmie të besueshme të ngjarjeve
19 dhe kjo flet jo vetëm për kurajën e tyre por gjithashtu dhe
20 për fuqinë e kësaj Gjykate dhe transparencën e procesit.
21 Gjykata ka përfaqësuar mundësinë për sundimin e ligjit të jetë
22 kryesor dhe mbi të gjitha dhe për të vërtetën për të dalë në
23 pah.

24 Një dëshmitar, për shembull, që ka humbur të birin dhe
25 bashkëshortin e saj, nuk i ka gjetur asnjëherë trupat e tyre,

1 ka dëshmuar për ne. Dëshmitarja W00072 foli për rëndësinë e
2 ditjes dhe vlerësimit të së vërtetës në fjalë që mund të
3 thuhen nga një nënë dhe një bashkëshorte që ka vuajtur një
4 tragjedi që nuk përshkruhet dot me fjalë. Ajo tha:

5 "Do shkoj deri në fund të botës sa për të arritur të
6 vërtetë, për aq sa të mundem, nuk do jap -- nuk do të tërhiqem
7 asnjëherë derisa të mësoj të vërtetën dhe vetëm të vërtetën
8 dhe do të vazhdoj të shkoj kudo që kërkohem të shkoj. Nuk do
9 të ndaloj asnjëherë. Do vdes me dhimbje dhe me plagë në zemër.
10 Më duket sikur e kam parë përsëri djalin dhe bashkëshortin
11 tim."

12 Është e rëndësishme të vihet re që pas krimeve, pra
13 ngritjes së aktakuzës, kjo dëshmitare nuk është kthyer në
14 Kosovë dhe asnjëherë nuk shkoi në shtëpinë e saj në Kosovë.

15 Megjithatë, duhet të kemi parasysh që shumë prej
16 dëshmitarëve shqiptarë të Kosovës nuk e kanë pasur këtë
17 mundësi, duke e bërë gatishmërinë e tyre për të dëshmuar këtu
18 më në komplikuar. Megjithatë, pavarësisht të gjithave, ata
19 rrezikuan për të ardhur këtu, për të përshkuar trishtimin e
20 tyre, ndjenjat e mërzisë dhe të tragjedisë së humbjes së
21 personave të anëtarëve të tyre. Dëshmitari W04811 shpjegoi:

22 "25 vite dhe asnjë përgjigje, dhe ne nuk dimë çfarë ka
23 ndodhur dhe kjo është ajo çfarë të vret më shumë."

24 Dëshmitari, W04368 dha dëshmi që pasi një prej të
25 afërmeve të tij u mor nga UÇK-ja për t'u marrë në pyetje,

1 familja nuk e pa më asnjëherë më të afërmin e tyre. Familja në
2 mënyrë të vazhdueshme i ka kërkuar UÇK-së informacion por asaj
3 nuk iu dha asnjëherë asnjë lloj informacioni. Ai dëshmoi:

4 "Kjo ka qenë shumë e vështirë për mua dhe për gjithë
5 familjen time. Nuk di, unë nuk di, ne nuk e dimë se pse e
6 morën atë, për çfarë arsye, se ku e dërguan atë. Kur ti e merr
7 dikënd nga shtëpia e tij pa asnjë arsye, nuk mund të japësh
8 asnjë lloj shpjegimi për këtë."

9 Edhe sot e kësaj dite, kjo familje vazhdon që të vuajë në
10 mungesë të pasjes së një fundi.

11 Faktet e kësaj çështje dhe jurisprudenca e zbatueshme
12 mbështesin një afat të gjatë për burgimin e secilit prej të
13 akuzuarve. Ndërkohë që ne kemi dhënë një shpjegim faktual dhe
14 ligjor në dosjen përfundimtare të Prokurorisë, dhe si rezultat
15 nuk do të dua që t'i përmend të gjitha këto faktorët këtu.
16 Ndërkohë që kolegët tanë, kolegët e mi do të vazhdojnë me
17 prezantime e tyre dhe do të trajtojnë disa prej argumenteve të
18 Mbrojtjes, ne i qëndrojmë asaj çfarë kemi parashtruar në
19 dosjen tonë, që ne i qëndrojmë faktit që ne kërkojmë dënimin e
20 personave konkretë.

21 Pra ne nuk kemi, nuk kërkojmë një dënim për Shtabin e
22 Përgjithshëm por për persona konkretë. Ndërkohë ZPS-ja kërkon
23 vendim dënimi për gjitha pikat e aktakuzës dhe vendosjen e një
24 vendimi të vetëm prej 45 viteve, mbështetur në kontributet
25 individuale të krimeve të bëra ose të kryera nga secili prej

1 personave, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup
2 Krasniqi. Këto krime janë krime lufte dhe krime kundër
3 njerëzimit, janë të rënda në natyrë dhe këto akuza nuk e kanë
4 humbur vlerën e tyre me kalimin e kohës, vazhdojnë të mbeten
5 ende shumë të rënda. Për pjesën të kohës që kemi në
6 dispozicion ne si Prokurori, kolegët e mi do të vazhdojnë që
7 të diskutojnë për përgjegjësinë e të akuzuarve për krimet e
8 akuzuara në aktakuzë. Së pari z. Tieger dhe znj. Lawson do të
9 diskutojnë planin e të akuzuarve për të fituar dhe ushtruar
10 kontroll në të gjithë Kosovën, dhe hapat kriminalë të kryer
11 për të eliminuar oponentët dhe për të arritur qëllimin e tyre.
12 Z. Pace më pas do të bëjë një përmbledhje të modeleve të
13 krimeve, përfshirë këtu persekutimin, trajtimin mizor,
14 ndalimin arbitrar, torturën, vrasjen dhe zhdukjen me forcë të
15 cilat kanë ndodhur nën autoritetin e të akuzuarve në përputhje
16 me qëllimin e tyre të përbashkët kriminal. Z. Quick më pas do
17 të diskutojë për strukturën dhe funksionimin e Shtabit të
18 Përgjithshëm dhe të UÇK-së gjatë periudhës së aktakuzës. Z.
19 Quick më pas do të flasë rreth krimit të Qeverisë së
20 Përkohshme të Kosovës dhe se si kjo i dha të akuzuarve një
21 shtysë paralele dhe shtesë me të cilën do të ekzekutonin
22 qëllimin e tyre të përbashkët kriminal. Së fundi, z. Halling
23 do të diskutojë lidhur me elementët e përgjegjësisë
24 individuale kriminale.

25 Faleminderit shumë, i nderuar Gjykatës, për vëmendjen.

1 Z. TIEGER: [Përkthim] Do të flasim për qëllimin e
2 përbashkët për të fituar kontroll, për mjetet që përfshinin
3 frikësimin e paligjshëm, keqtrajtimin e personave që
4 gjykoheshin si kundërshtarë dhe për këtë kemi një gamë të
5 shumëllojshme provash, mes të cilave përfshihen: komunikatat,
6 deklaratat publike, rregulloret, urdhëresa, raporte të
7 zbulimit të policisë ushtarake, shënime, ditarë, mbledhje,
8 inspektive, emërime dhe rritje në detyrë, përpjekje për të
9 mohuar, shmangur dhe për të justifikuar krimet, pjesëmarrjen e
10 të akuzuarve në vepra penale, dhe sigurisht, kemi dëshmitë e
11 dëshmitarëve.

12 Qysh prej fillimit të periudhës së aktakuzës e deri në
13 fund, për gjatë fazave të ndryshme të konfliktit, qoftë kur të
14 akuzuarit pretendonin në mënyrë publike apo e justifikonin se
15 u përgjigjeshin shqetësimeve të komunitetit ndërkombëtar,
16 vijonte shënjestrimi i kundërshtarëve. Unë do të flas për
17 vitin 1998, ndërsa z. Lawson do të flasë për ngjarjet e '99-s.

18 Sidoqoftë, të kuptojmë siç duhet çka ndodhur prej marsit
19 1998 e në vijim, duhet të kuptojmë, ku ka qenë, kush kanë qenë
20 të akuzuarit asokohore dhe si mbërritën atje ku ishin, sepse,
21 ndryshe nga shumë prej atyre që ishin pjesë e UÇK-së në atë
22 kohë, të akuzuarit nuk u galvanizuan papritmas nga vrasja e
23 familjes së Jasharëve për të dalë vullnetarë, por ata ishin
24 pionierë të UÇK-së që e kishin çuar në atë pikë UÇK-në. Siç ka
25 thënë një anëtar i rëndësishëm i Shtabit të Përgjithshëm të

1 UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi kanë qenë
2 ndër pak protagonistët që kanë [qenë] pjesë e një "strukturë
3 të përbashkët" dhe "filluan dhe përfunduan luftën".

4 Jakup Krasniqi, një figurë publike e respektuar, iu
5 bashkua strukturës më pas por ama luajti një rol po aq të
6 rëndësishëm. Filloi, sikurse e ka shpjeguar Jakup Krasniqi në
7 paraqitjen e parë si zëdhënës i UÇK-së, filloi pra me LPK-në.

8 Dhe këtu kemi titra, nuk kam nevojë për përkthim, do të
9 ndjekim këtë video të shkurtër.

10 [Luhet videoincizimi]

11 Z. TIEGER: [Përkthim] LPK-ja ishte forca politike,
12 sikurse e ka shpjeguar z. Krasniqi, që meritonte meritën e vet
13 që kishte krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Sikurse e ka
14 thënë Azem Sylja në provën P1875, UÇK-ja mund të konsiderohet
15 si një krijim apo si një pjesë e krahut ushtarak të LPK-së.

16 Lëvizja Popullore e Kosovës, ose ndryshe, LPK-ja, ka qenë
17 një grup politik që vepronte në fshehtësi që vlerësonte se
18 çlirimi i tërë shqiptarëve nuk do të ndodhte pa pasur konflikt
19 të armatosur. Dhe në fillim të viteve '90, një grup anëtarësh
20 krijuan krahun ushtarak, dhe siç ka thënë Ilaz Kadolli P12,
21 "të fillonin sulme të armatosura kundër ushtrisë serbe,
22 policisë dhe kolaboracionistëve të okupatorit serb në Kosovë".

23 Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli, shokë që prej kohës kur
24 ishin studentë, kanë qenë aktorë kryesorë në këtë proces dhe
25 kanë qenë në vijën e parë të UÇK-së qysh prej fillimit. Këtë

1 mund ta gjeni në provën P4216. Sikurse e shpjegoi z. Thaçi në
2 intervistën që ka dhënë për ZPS-në, ku i bënte eko asaj që i
3 kishte thënë më përpara TPNJ-së:

4 "Kur filluam veprimtarinë tonë në 1992, 1993, ishim shumë
5 pak persona. Ishim patriotë. Ishim nga Drenica. Unë kam qenë
6 një prej personave që e themeloi, një prej themeluesve, dhe
7 këtë e dinë të gjithë."

8 Po ashtu, z. Veseli ka shpjeguar në dëshminë që ka dhënë
9 për SPRK-në:

10 "Kam qenë anëtar i UÇK-së që prej fillimit. Në fakt jam
11 një prej themeluesve. Kam qenë anëtar i Shtabit kryesor të
12 UÇK-së që prej fillimit."

13 Z. Thaçi ka pasur rol të rëndësishëm që prej fillimit, ka
14 drejtuar aktivitetet e organizuar dhe z. Veseli kujton se
15 gjatë periudhës deri në 1994 ai dhe z. Thaçi shkonin e vinin
16 nga Shqipëria. Në 1994, shkuan në Zvicër, dhe prej atëherë
17 deri në mars 1998 vinin çdo tre-katër muaj në Kosovë dhe çdo
18 herë që vinin qëndronin dy deri në katër javë. Mund ta gjeni
19 këtë në provën P739.4.

20 Thaçi dhe Veseli kanë pasur detyra të rëndësishme gjatë
21 asaj kohe, të mbanin kontakte, të organizonin, të sillnin
22 armë, përfshirë 7 prej 12 RPG-ve që u përdorën në sulmet e
23 sinkronizuar ndaj 12 stacioneve policore serbe në shtator
24 1997. Prova 4200 dhe prova 1883.

25 Z. Thaçi fitoi reputacionin se personi që lidhi

1 luftëtarët në Kosovë me planifikuesit që jetonin në mërgim,
2 sikurse e ka thënë dhe një biograf i UÇK-së pasi u konsultua
3 gjatë e gjerë me z. Thaçi dhe me drejtues të tjerë. Siç ka
4 thënë dhe z. Veseli, në provën P4216, "Z. Thaçi ishte një prej
5 personave që nuk drejtoi vetëm nga pikëpamja politike por
6 'vendosi veten në rrezik' dhe 'është luftëtar dhe në të
7 njëjtën kohën është drejtues politik'."

8 Rexhep Selimi, një themelues tjetër i Shtabit të
9 Përgjithshëm që njihej për lidhjen e ngushtë që kishte me z.
10 Adem Jashari, dhe rolin si një organizatorët më të hershëm dhe
11 pjesëmarrësit në fushëbetejë, përfshirë dhe organizimin dhe
12 pjesëmarrjen e tij në sulmet e sinkronizuara në shtator 1997,
13 dhe, sikurse vetë z. Selimi e ka thënë në provën P00761.4,
14 ishte dikush që gëzonte shumë respekt dhe besueshmëri nga
15 luftëtarët.

16 Ky historik dhe statut u është reflektuar në përshkrimet
17 nga një dëshmitar i rëndësishëm i Thaçit, Veselit dhe Selimit
18 si "burra, figura të forta të UÇK-së". Këtë mund ta gjeni në
19 provën P1097.09, dhe pse Ramush Haradinaj përfshiu Hashim
20 Thaçin dhe Rexhep Selimin ndër katër kandidatët që ai propozoi
21 si komandant të UÇK-së.

22 Një drejtues i UÇK-së, sikurse e bëri të qartë një
23 dëshmitar, ishte një qysh në gjenezë, ishte thelbi i idesë së
24 luftës dhe që kishte krijuar apo formuar UÇK-në më shumë se
25 kushdo tjetër. Mund ta gjeni këtë në provën P1136.4.

1 Sikurse ju thashë, z. Jakup Krasniqi gëzonte shumë
2 respekt, veçanërisht si ish i burgosur politik. Ndonëse ai ka
3 pasur një profil ligjor në LDK në vitet '90, ai kishte
4 kontakte me Adem Jasharin në 1991 dhe ishte përfshirë me UÇK-
5 në që prej 1993, dhe këtë mund ta gjeni në Provën P00186, pra,
6 dhe na ka shpjeguar se iu bashkua Shtabit të Përgjithshëm
7 rreth fillimit të 1997-s. Këtë mund ta gjeni sërish në provën
8 P00794. Dhe ja kështu u bënë bashkë të akuzuarit. Dhe gjatë të
9 gjithë kësaj kohe, ata kishin dhe vepronin në mënyrë
10 kolektive.

11 Sikurse ka thënë z. Kadri Veseli:

12 "Kemi pasur përgjegjësitë tona gjatë të gjithë ... kohës
13 në periudhën 1992 deri në 1998. Kishim shtabin tonë të
14 përgjithshëm, dhe shtabin operativ pranë UÇK-së. Nuk kishim
15 detyra të ndara, por punonim të gjithë së bashku me aq sa të
16 mundeshim."

17 Rexhep Selimi e nënvizoi pikërisht këtë në intervistën
18 për ZPS-në se vendimet merreshin në mënyrë kolektive. Se Sokol
19 Bashota theksoi në intervistën e tij për TPNJ-në se vendimet
20 kolektive vlenin për të gjitha vendimet që lidheshin dhe për
21 kolaboracionistët.

22 Periudha nga mesi i viteve '90 deri në mars të '98-s
23 njihet për organizimet dhe sulme të armatosura dhe përpjekjet
24 e pafundme për të garantuara që ta merrte vesh bota çfarë po
25 bënte UÇK-ja dhe të theksonin ndikimin frikësues që duhet të

1 kishin sulmet e armatosura për të gjithë ndërkombëtarët.

2 Komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm u shpërndanë dhe
3 kishin mesazh të përbashkët: Shtabi i Përgjithshëm kërkonte
4 pavarësinë e Kosovës edhe do të vazhdonin derisa të merrnin
5 fitoren e plotë; partitë politike që konsideronin autonominë
6 do të "ndëshkoheshin si tradhtarë"; ka qenë vetëm Shtabi i
7 Përgjithshëm i UÇK-së që kishte të drejtën të qeveriste dhe të
8 drejtonte në Kosovë dhe ata që ishin "nga ana tjetër" duhet të
9 mbështesnin dhe betejën e tyre përndryshe do të merrnin
10 "ndëshkimin e merituar"; kolaboracionistët me okupatorët do të
11 trajtoheshin në mënyrë të pamëshirshme; dhe njësitë e
12 armatosura do të kryenin sulme ndaj kolaboracionistëve.

13 Dhe, ju lutem, të nderuar Gjykatës, të shohim provat
14 P269-ET.1, .2, .5, .6, .8 dhe .9, .15; provën P274; P277;
15 P279; dhe P4290.

16 Komunikatat tregonin se këto sulme përfshinin serbët që
17 njiheshin si kolonizatorët, anëtarë të partisë socialiste
18 serbe që kishin dhënë fjalime në funeralin e dikujt që ishte
19 ekzekutuar nga anëtarët e UÇK-së, nga njësitë e UÇK-së,
20 rektori i universitetit serb në Prishtinë dhe vozitësi i tij
21 personal, persona që pretendoheshin se bashkëpunonin me organet e
22 okupatorit apo se merrnin pjesë në veprimtari të tjera të
23 paspecifikuara antikombëtare. Këto shënjestra ishin në
24 përputhje me fushëveprimin e gjerë të bashkëpunimit si
25 komunikoheshin nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, për shembull,

1 ata që "në mënyrë të verbër i shërbenin kolonizatorëve të huaj
2 dhe që rrezikonin lirinë e vendit". Mund ta shikoni këtë në
3 provën P269.15.

4 Ka raste kur z. Krasniqi apo të tjerët pretendonin se
5 bashkëpunëtorë ishin persona që i shërbenin policisë dhe
6 ushtarëve. Pikësëpari, edhe ky kufizim i rremë nuk shërben për
7 të justifikuar krimet siç do të flasë më vonë z. Pace. Së
8 dyti, provat duhen vlerësuar në tërësi e tyre dhe ka shumë e
9 më shumë komunikata dhe deklarata që e bëjnë të qartë se ndër
10 bashkëpunëtorët përfshiheshin ata që pretendohej se i
11 shërbenin apo përkuleshin përpara okupatorëve.

12 Për shembull, z. Krasniqi e ka bërë të qartë në
13 deklaratën që i ka dhënë për TPNJ-së, ju lutem është prova
14 P794, se bashkëpunëtorët ishin "vegla të regjimit serb që i
15 shërbenin këtij regjimi të dhunshëm, se ishin të shumtë në
16 sferën ekonomike, kulturore dhe politike", por edhe në fushën
17 e sigurisë, dhe ndër ta përfshiheshin edhe ata që kishin
18 dëmtuar veprimtaritë politike dhe ushtarake të UÇK-së. Ai
19 theksoi se aparati i regjimit serb nuk mund të funksiononte në
20 Kosovë vetëm me policinë dhe ushtarët e tij dhe shpjegoi se
21 "ky aparat i ka shtrirë tentakulat e veta në të gjitha organet
22 e administratës publike".

23 Mbrojtja është përpjekur të thotë që komunikatat ishin
24 thjeshtë "propagandë", një fjalë që e përdorin si eufemizëm,
25 që do të thotë që ishin të pavërteta. Edhe këto pretendime i

1 mbështesin provat e tyre. Sidoqoftë ju mund të gjeni shumë
2 shembuj në paragrafët 1473, 1480 të dosjes tonë përfundimtare
3 në lidhje me këtë. Sigurisht që komunikatat mund të kenë qenë
4 të ekzagjeruara sa i takon suksesit të UÇK-së apo vështirësive
5 të pakta, z. Krasniqi ka dhënë dëshmi se faktet bazë ishin të
6 sakta, dhe në fakt janë vleftësuar nga artikuj të tjerë në
7 media. Mund ta shikoni këtë në provën P800.

8 Në fakt, z. Krasniqi specifikisht ka konfirmuar në provën
9 P794 thelbin e disa komunikata, dhe nuk mund të mendonte se
10 një komunikatë e vetme mund të mos ishte lëshuar nga Shtabi i
11 Përgjithshëm, pra të gjitha ishin lëshuar nga Shtabi i
12 Përgjithshëm.

13 Sikurse u pajtua z. Krasniqi kur dha dëshmi përpara TPNJ-
14 së, në provën P795, faqja 3420, propaganda është "një program
15 organizativ i publicitetit apo informacion i përzgjedhur për
16 të propaganduar një doktrinë apo praktikë", dhe pikërisht këtë
17 bënë komunikatat.

18 Konfirmimi i mëtejshëm i komunikatave gjendet në dëshminë
19 e TPNJ-së të Sokol Bashotës me provën P1870.3, kur i bënë një
20 pyetje të thjeshtë si trajtoheshin bashkëpunëtorët, ai
21 shpjegoi se "me vendim të Shtabit të Përgjithshëm kundër tyre
22 merreshin masa", të cilat, "synonin të përcillnin mesazhin që
23 askush nuk duhet të sillet më në këtë formë".

24 Dhe vijon më tej, "dhe Shtabi i Përgjithshëm në
25 komunikatat e veta shpallte se persona të tjerë që ishin

1 trajtuar në të njëjtën mënyrë duhet të mos e bënin më këtë
2 gjë. Bashkëpunëtorët", shpjegonte ai, "paralajmëroheshin
3 fillimisht, dhe në qoftë se nuk ndalonin atëherë merreshin
4 masa ndëshkuese ndaj tyre".

5 Dhe kur e pyetën cilat ishin këto masa ndëshkuese, ai
6 tha:

7 "Në shumicën e rasteve merrej vendimi për t'i vrarë."

8 Pra, ju mund ta shikoni një shembull pikërisht të kësaj
9 në Komunikatën 28:

10 "Shtabi Qendror i UÇK-së mori vendimin për t'i ekzekutuar
11 pasi ishin paralajmëruar më herët që të hiqni dorë nga
12 bashkëpunimi me okupatorët dhe të respektonin vendimin e
13 publikuar në Komunikatën nr. 27 nga Shtabi Qendror i UÇK-së."

14 Një prej viktimave ka qenë deputet i Partisë Socialiste
15 të Serbisë.

16 Zëri i Kosovës, organ i LPK-së, del në përfundimin se
17 likuidimi i tij tregonte "se shqiptarët janë të vendosur në
18 udhën e tyre për të larë hesapet me të gjithë ata që pengojnë
19 diellin e lirisë".

20 Një shembull tjetër për të shpjeguar për këtë përkufizim
21 dhe se si ata donin që t'i frikësonin këta persona, mund ta
22 shikojmë në Komunikatën 28 ku shpallet se këto ekzekutime
23 duhet të shërbejnë si paralajmërim për të gjithë
24 bashkëpunëtorët dhe tradhtarët, "veçanërisht ndaj atyre që me
25 pretekstin se ishin nën trysni prej qendrave prej Serbisë,

1 duhet të bënin marrëveshje për të nënshkruar marrëveshje me
2 okupatorët çka ishin në kundërshtim me interesat kombëtare”.

3 Një shembull tjetër syresh gjendet në Komunikatën 29:

4 “Vrasja e parë u krye më 13 janar të këtij viti, ku
5 njësitë guerile ekzekutuan bashkëpunëtorin e policisë serbe
6 Fazlli Hasanin nga Braboniq, Mitrovica. Vendimi u mor pasi iu
7 ndoqën apo iu shqyrtuan për një kohë të gjatë veprimtaritë e
8 tij antikombëtare.”

9 Dhe sigurisht një paralajmërim i gjerë për një audiencë
10 të gjerë për bashkëpunëtorët e mundshëm:

11 “Kjo është hera e fundit që u bëjmë thirrje
12 bashkëpunëtorëve të okupatorëve të heqin dorë nga rruga e tyre
13 e turptë, përndryshe njerëzit do të marrin hak në mënyrë të
14 pamëshirshme ndaj tyre kudo që të jenë dhe me këdo që do
15 jenë.”

16 Mbrojtja ka theksuar se Bashota i tha kësaj Gjykate se ka
17 folur në mënyrë hipotetike, thjesht ka hamendësuar. Por mjaft
18 të lexosh dëshminë e tij që i ka dhënë TPNJ-së për ta kuptuar
19 që në fakt nuk ka qenë kështu.

20 E para, një herë, është njëqind për qind e qartë se ai iu
21 përgjigjej pyetjeve duke thënë thjesht çfarë ka ndodhur në
22 përgjigjen e tij. Edhe dhe pas momentit kur pika pretendonte
23 se ishte thjesht hipotetike ajo çka thënë ai, Bashota ka folur
24 qartë për bashkëpunëtorët që paralajmërohen dhe ka thënë, “dhe
25 disa prej këtyre personave respektonin paralajmërimin, por

1 disa jo". Këtë mund ta gjeni në faqen 19 të provës P1870.3

2 Mbrojtja po ashtu pretendon - këtë mund ta gjeni në
3 dosjen gjyqësore të z. Selimi, paragrafi 594 - se Bashota e ka
4 tërhequr dëshminë sa i takon vendimeve kolektive që merreshin
5 nga Shtabi i Përgjithshëm në lidhje me bashkëpunëtorët. Në
6 fakt, ai e konfirmoi pavarësisht përpjekjeve të pagabueshme
7 për të zbutur nivelet konkrete dhe detajet sa i takon
8 rëndësisë së dëshmisë së tij, Bashota sidoqoftë e pranoi se
9 atë që tha në mënyrë eufemistike si thirrje për të mos
10 bashkëpunuar me armikun, në fakt, ai tha me fjalët e tij që
11 ishin vendime kolektive të cilat shpreheshin përmes
12 komunikatave. Mund ta gjeni këtë në transkriptin 22986-87. Po
13 ashtu konfirmoi se komunikatat njiheshin nga i gjithë opinioni
14 publik edhe nga ushtarët e UÇK-së.

15 Pak kohë pasi u bë zëdhënësi zyrtar, Jakup Krasniqi tha
16 në një intervistë se konfirmonte për, pra, i konfirmoi TPNJ-së
17 saktësinë e asaj që kishte thënë, "bashkëpunëtorët
18 paralajmëron se do t'i vrasim në qoftë se vazhdojnë të ndjekin
19 rrugën e gabuar", dhe më pas tha se dhe shtoi, "sidoqoftë si
20 ushtri ne respektojmë rregullat ndërkombëtare të luftës". Këtë
21 mund ta gjeni në provën P809.

22 Në fakt, në momentet më të rëndësishme Shtabi i
23 Përgjithshëm konfirmoi, në fakt, shënjestrimin e
24 bashkëpunëtorëve. Për shembull, kur u bë publike UÇK-ja në
25 '97-n, në dhjetor të '97-s, Rexhep Selimi theksoi për turmat

1 se çfarë kishte bërë UÇK-ja, pra që: kishte kryer veprimtari
2 çlirimi kundër okupatorëve dhe "si dhe ndaj shqipfolësve,
3 bashkëpunëtorëve shqipfolës, kolaboracionistëve". Po ashtu
4 theksoi se ata që kishin qëndrime pacifiste "denigronin luftën
5 e shenjtë". Kjo mund të gjendet në provën P1878.

6 Dhe kur anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm dolën për herë
7 të parë në televizor në mars të '98-s e bënë të qartë se
8 autonominë nuk do ta pranonin dhe i lëshuan një paralajmërim
9 qeverisë së shqiptarëve të Kosovës të dorëzonin fondet për
10 ndryshe do të kishin përgjegjësi, do të mbanin përgjegjësi për
11 këtë dhe theksuan se të gjitha veprimet e UÇK-së ishin
12 drejtuar kundër okupatorit serb dhe "kundër kolaboracionistëve
13 të shtypësve". Kjo gjendet në provën P4217.

14 Ky ishte fillimi i marsit kur të akuzuarit ishin ende në
15 një grup të vogël që pretendonte se donte të çlironte Kosovën
16 me forca -- me anë të armëve kundër policisë, ushtrisë serbe,
17 bashkëpunëtorëve e tradhtarëve. Por fillimi i marsit njihet
18 fatkeqësisht dhe nga sulmi që i ndodhi familjes së Jasharëve
19 dhe vrasjes së Adem Jasharit dhe familjes së tij, një ngjarje
20 që nxiti atë për të cilat pajtohen të gjitha palët, fillimin e
21 zgjerimit eksploziv të UÇK-së nga origjina e vet guerile.

22 Z. Quick do të flasë me më shumë hollësi për krijimin dhe
23 konsolidimin e njësiveve nga Shtabi i Përgjithshëm gjatë kësaj
24 periudhe kohore. Por, unë po ju jap thjesht një panoramë të
25 përgjithshme.

1 Shtabi i Përgjithshëm, i cili për vite i kishte garantuar
2 ndjekësit e mundshëm dhe publikun se nuk do të ndaleshin edhe
3 nëse konflikti do të bëhej i madh dhe më gjakderdhës, filloi
4 të vepronte menjëherë.

5 Sikurse thuhet në dosjen tonë përfundimtare, paragrafët
6 25 dhe 27, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, dhe një grup i madh i
7 LPK-së, dhe aktivistë të besuar hynë në Kosovë kur këta
8 aktivistë filluan të udhëhiqnin, të krijonin njësitet
9 ekzistuese dhe të krijonin njësite të reja duke përdorur
10 vullnetarët të cilët donin të krijonin ushtrinë për të çliruar
11 Kosovën dhe ishin krenarë për të qenë ushtarë besnikë dhe të
12 ndëshkoheshin goftë dhe me vdekje në goftë se nuk e
13 respektonin këtë betim.

14 Në të njëjtën kohë, Shtabi i Përgjithshëm forcoi dhe
15 formalizoi marrëdhëniet ekzistuese në vende si Dukagjini dhe
16 Llapi, dhe rekrutoi ushtarë profesioniste për t'i ndihmuar për
17 të stërvitur dhe për të krijuar UÇK-në. Sikurse tha Jakup
18 Krasniqi në provën P796, UÇK-ja filloi të zgjerohej nga një
19 ushtri guerile, dhe ishte pikërisht, ishte Shtabi i
20 Përgjithshëm që "kishte përgjegjësinë për të organizuar këtë
21 ushtri".

22 Në fakt, kjo ishte një periudhë ku Shtabi i Përgjithshëm
23 ishte i përfshirë konkretisht në veprime. Siç e vërejti Bislim
24 Zyrapi në provën P605, përpara arritjes së profesionistëve
25 ushtarakë, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte kontroll mbi

1 të gjitha njësitet e tyre, por "mënyra se si deri në atë kohë
2 shtabi ushtronte kontrollin e tij, kishte qenë një barrë e
3 madhe për të".

4 Kjo pasqyronte natyrën dhe mënyrën se sa aktive, sa të
5 angazhuar dhe të zënë -- të akuzuarit dhe pjesëtarë, anëtarë
6 të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm ishin. Zyrapit vetë u
7 detyrua të priste në Shqipëri për një kohë të gjatë, edhe pasi
8 ishte pranuar dhe priste që Thaçi të mbërrinte në Kosovë dhe
9 ta sillte atë bashkë me të. Këtë mund ta shihni një pasqyrim
10 tjetër në provën P1265 që nuk duhet të shfaqet për publikun.

11 Kjo është një fletore me shënime që është sekuestruar nga
12 Rexhep Selimi. Për arsye të ndryshme, përfshirë edhe natyrën e
13 referenca -- përmendjeve të palëve të treta në të, dhe
14 dallimin në dorëshkrim nga shënimet që janë vlerësuar se janë
15 shkruar nga ai, ne nuk do ta vlerësojmë këtë fletore shënimesh
16 si e shkruar nga z. Selimi.

17 P1265, shënimet në këtë, pra, janë të ngjarjeve të
18 ndryshme të datës 12 maj në afërsi të Ujmirit dhe Likocit. Për
19 shembull, krijimi i stacionit të parë të policisë në Likoc me
20 18 mars 1998, apo një kërkesë se njësiti i policisë ushtarake
21 të krijohet në Ujmirë. Apo dy vende në Suharekë që mblidhen në
22 bazën Çeliku. Apo momenti kur Nuhi Bytyqi kërkon një raport
23 mbi furnizimin me ndihmat dhe jetën familjare. Kjo gjendet në
24 provën materiale 6542, 44, 45.

25 Dhe pasqyron vazhdimisht praninë e z. Selimi, përfshirjen

1 e tij, dhe rëndësinë e tij, përfshirë, në faqen 6541:

2 "Motivimi:

3 "Erdhi për trajnim, stërvitje

4 "Mbledhje me numrin '10' "

5 Pastaj 6542:

6 "Motivi:

7 "Arsyeja:

8 "Mbledhje apo takim me numrin '10' me 'Dhjetëshin' "

9 Dhe pastaj 6566:

10 "Motivi i ardhjes, arsyeja e ardhjes:

11 "Për t'u konsultuar me 'Dhjetëshin' lidhur me furnizimet
12 me armë me organizimin e pozicionit."

13 Dhe:

14 "- Bisedova me ta në Qabiq dhe më këshilluan që të flas
15 me 'Dhjetëshin'."

16 6607:

17 "Kërkesë për 'Dhjetëshin'

18 "- një snajper i është premtuar 'Hekurit' të Mrasorit. Ai
19 kërkon që ky premtim të mbahet, pra, të realizohet."

20 Dhe referenca të shumta të ngjashme

21 Dhe një pasqyrim tjetër, pra, i cili nga kjo fletore
22 lidhur me atë që Zyrapi -- asaj që Zyrapi i referohej duke
23 patur parasysh që do të dëgjojmë shumë më shumë lidhur me këtë
24 çështje nga z. Quick.

25 Mendoj për beteja apo ngjarje të rëndësishme të kësaj

1 periudhe, menjëherë pas sulmit të Gllogjanit në mars, Hashim
2 Thaçi dhe Kadri Veseli ishin aty; kjo është në paragrafin 672
3 të dosjes përfundimtare. Deçani në maj, Kadri Veseli dhe
4 Hashim Thaçi ishin aty; pra, prova P1355.1. Bellaqevc, në
5 minierën në Bellaqevc në qershor, Hashim Thaçi, Kadri Veseli
6 ishin aty; prova P1273. Në Rahovec në korrik, Hashim Thaçi,
7 Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi ishin aty; prova P1355.2. Gryka
8 e Llapushnikut, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli ishin aty; prova
9 P189, faqe 70.

10 Pra, në këtë mënyrë të ngarkuar, për të përdorur fjalët e
11 Zyrapit, Shtabi i Përgjithshëm po krijonte, po ndërtonte një
12 ushtri, përfshirë edhe njësitet të specializuara të armatosura
13 të ndërhyrjes së shpejtë për detyra të veçanta - polici
14 ushtarake, shërbime zbulimi, njësi speciale. Dhe siç e
15 biseduam, Shtabi i Përgjithshëm për vite me radhë kishte
16 siguruar rajonin dhe në veçanti mbështetësit e tyre të
17 mundshme përmes komunikimeve të tyre se kolaboracionistët,
18 bashkëpunëtorët do të ndiqeshin dhe do të trajtoheshin pa
19 mëshirë. Dhe kjo është saktësisht ajo që ka ndodhur.

20 Tani keni parasysh edhe një herë provën P1265, fletoren
21 me shënime të sekuestruar nga z. Selimi ku pasqyrohet prania
22 dhe përfshirja e tij. Në këtë fletore gjithashtu shihet
23 përqendrimi tek kolaboracionistët, bashkëpunëtorët dhe të
24 dyshuarit gjatë gjithë kohës, gjatë të gjithë periudhës,
25 përfshirë edhe kontaktet e shpeshta me baxhanakun, i cili

1 është polic serb; dhe për mbledhjen me tre bashkëfshatarë të
2 cilët ishin serbë; apo për fyerjen e UÇK-së duke iu referuar
3 atyre si majmunë apo rrugaçë; apo akuza për marrëdhëniet
4 intime me një polic serb dhe të pasurit e një fëmije me të;
5 apo blerjen, marrjen e kohëve të fundit të një telefoni. Prova
6 6591, -92, 6605, dhe 6609.

7 Në fakt, fletoret, pra, të asaj kohe dhe shënimet janë të
8 mbushura me përmbajtje ku shënjestrohen bashkëpunëtorët nga
9 policia, shërbimet e zbulimit, njësitet speciale, për të
10 përmendur vetëm disa shembuj: prova P75, P74, P2455, P2623,
11 P651, P2638, P1265, P1644.

12 Mbrojtja ju thotë juve që të mos i merrni parasysh këto
13 shënime, duke u përqendruar në atë që, faktin, pra,
14 pretendimin që nuk dihet për këto fletore dhe duke spekuluar
15 se ato mund të jenë të fabrikuara.

16 Duke lënë mënjanë shtrirjen apo shkallën në të cilën këto
17 fletore janë të mbushura me aspekte të jetës së përditshme dhe
18 hollësi që janë pa pasoja dhe të parëndësishme apo për të
19 cilat, apo informacionet që kërkojnë më shumë kontest për
20 domethënien e tyre se si duhet të kuptohen, edhe më e
21 rëndësishme se fletoret, duhen të vlerësohen në kontekstin e
22 tërësisë së provave ato konfirmohen në mënyrë të gjerë dhe në
23 mënyrë konkrete.

24 Dokumentacioni i çështjes në këtë gjykim, përmban
25 parashtime të gjera lidhur me konfirmimin e këtyre materiale,

1 përfshirë përmes shpjegimeve individuale për secilin material
2 në debate për pranueshmërinë e tyre dhe këto gjenden në dosjen
3 tonë përfundimtare.

4 Po ju jap dy shembuj, nuk dua të shfaqet për publikun.

5 Kemi një fletore që ka të bëjë me zonën e Pashtrikut, që
6 është marrë nga TPNJ-ja. Dhe kur kalon faqen, pra, kur shihen
7 faqet, mund të shohim shënime të përsëritura që janë
8 konfirmuar.

9 Dhe, edhe këtu, duke -- shohim slajdet që paraqiten që
10 nuk duhet të shfaqen për publikun derisa sa të them unë se
11 cili është dokumenti që mund të shfaqet për publikun. Faqja
12 9244 përmendet një referencë aty e shënuar që është konfirmuar
13 nga Dëshmitari 3873 në transkriptin T22578 deri në 79, 9253
14 dhe 9256, janë pjesë të nënvizuara të konfirmuara nga
15 Dëshmitari W04771 [Sipas përkthimit] në faqen e transkriptit
16 1525 [Sipas përkthimit] dhe 254, dhe 258 deri në 259. 9254,
17 konfirmuar, pra, nga Dëshmitari AF467. Në faqen 9279, pjesa e
18 nënvizuar konfirmohet nga prova P1381, që është sekuestruar
19 nga Jakup Krasniqi dhe konfirmuar nga Dëshmitari W4752, në
20 T1355 [Sipas përkthimit]. Dhe pastaj kemi 9274, pjesët e
21 nënvizuara të konfirmuara nga Dëshmitari W4371 në pjesët e
22 transkriptit 9278 [Sipas përkthimit]. Pjesët e nënvizuara janë
23 konfirmuar nga 4271 [Sipas përkthimit] në T15257 deri në 58.

24 9291, tani, pjesët e nënvizuara, të theksuara të
25 konfirmuara në P1417, të cilat janë sekuestruar nga Rexhep

1 Selimi, dhe P3837, të cilat janë sekuestruar nga Jakup
2 Krasniqi, të dyja këto janë konfirmuar nga shënimet me numra
3 për pjesën e Pashtrikut. 9295, pjesët e nënvizuara të
4 konfirmuara nga Dëshmitari W495 në 2116 deri në 619. 9298, e
5 konfirmuar nga 4371 në transkriptin 15257; 9249, pjesët e
6 nënvizuara të konfirmuara nga Dëshmitari 3873 në T22577 deri
7 në 579; pastaj kemi 931, kodi i zonës së Dukagjinit që është
8 konfirmuar në P1417 dhe P419 të sekuestruara nga z. Krasniqi
9 dhe z. Selimi.

10 Edhe një tjetër, 9269. Këtu shohim një viktimë në Drenoc,
11 e konfirmuar kjo, pra, nga W4489 në faqen e transkriptit 11772
12 deri në 774. Kjo viktimë paraqitet gjithashtu në provën P74,
13 shënimesh edhe kjo. Dhe këtu duket nën pjesën "shënime për
14 informacionet e Arditit", dhe ne e dimë, pra, e cila konfirmon
15 disa dyshime, persona të dyshuar dhe bashkëpunëtorë. Dhe ne e
16 dimë nga provat se Arditi ishte anëtar i shërbimit të
17 inteligjencës së Kosovës dhe identifikimi pra, i
18 bashkëpunëtorëve të dyshuar. Dhe këtu shohim emrin e
19 nënvizuara të një tjetër bashkëpunëtori të dyshuar që është në
20 mes të faqes në anën e majtë.

21 Tani do të shohim P1112, dhe shohim dy po këta të dy
22 emra. Dhe jemi faqen -- në provën P1112, dhe shohim këto dy
23 emra. P1112 është sekuestruar nga Jakup Krasniqi.

24 Apo ndoshta është një bllok shënimesh, pra fletore, në
25 mes të faqes -- i sekuestruar nga Jakup Krasniqi, apo të

1 shohim shënimet e mbledhura aty, dhe këto nuk duhet të shfaqen
2 për publikun.

3 Prova P1644, janë shënime të marra, të sekuestruara të
4 gjitha në Likoc, Llaushë, Aqarevë gjatë operacioneve të MUP-it
5 serb, në javën e parë të gushtit gjatë ofensivës që zmbrapsi
6 shtabin e UÇK-së pas sulmit në Rahovec. Edhe siç e ka thënë
7 Sokol Bashota përpara TPNJ-së, UÇK-ja kishte materiale me
8 shkrim dhe "kishte shumë ofensiva dhe shumë gjëra gjatë
9 ofensivës shumë gjëra u humbën".

10 Dhe siç e shohim në 098615 dhe 098619, kjo është
11 konfirmuar nga Dëshmitari W4337 në T5310, 5319 dhe nga prova
12 P289. 098618, tani Dëshmitari W4290 konfirmoi nënshkrimin e
13 tij në T25005, 25007. Dhe konfirmimi për referencën, pra, ku i
14 kërkohet Dajës dhe Hakit i kërkohen armë, mund të gjendet në
15 paragrafët 462, 463 të dosjes përfundimtare.

16 Në faqen 098621, gjashtë emrat e nënvizuar këtu mund të
17 gjenden gjithashtu në provën P2459, ku renditen të njëjtë
18 gjashtë emrat e njëjtë që janë "personat që po kërkoheshin".

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mikrofon i po bën pak
20 zhurmë.

21 Z. TIEGER: [Përkthim] Akoma problem, keni vështirësi të
22 më dëgjoni?

23 Kalojmë tek faqja 098619, shohim marrjen në pyetje të një
24 të ndaluarit i cili është marrë në pyetje nga disa persona,
25 përfshirë dhe emrin e nënvizuar. Dhe ky person shfaqet

1 gjithashtu në provën P709 dhe P1445, që janë sekuestruar nga
2 UNMIK-u te, pra, marrë te Halil Qadraku, të cilin siç ju
3 kujtohet ka qenë shefi i G-2, shërbimit të inteligjencës në
4 zonën e Pashtrikut.

5 Këto prova materiale kanë të bëjnë me mënyrën se si një
6 ushtar i UÇK-së ka marrë detyrën në prill '98 nga eprorët e
7 tij, Fehmi Lladrovci, Musa Jashari dhe Jahir Demaku, si kusht
8 për t'u bërë pjesë e UÇK-së. Detyra ishte të likujdohej një
9 shqipfolës, term i përdorur për të përcaktuar bashkëpunëtorët,
10 i përdorur dhe nga Rexhep Selimi në fjalimin e tij të nëntorit
11 1997. Dhe ky shqipfolës ishte një person i cili, emri i të
12 cilit është në provën P1644. Detyra u zbatua por viktima
13 shpëtoi.

14 Kur iu tha në gusht të '99-s se ajo do të transferohej në
15 Drenicë, ushtarja u shqetësuar sepse aty ishte vendi ku
16 viktima e cila -- viktima, pra, e dinte se kush kishte qenë
17 personi që e kishte sulmuar, aty jetonte viktima. Ushtarja
18 pastaj kërkoi ndihmën e Qadrakut i cili i shkruajti Tahir
19 Sinanit në komandën e zonës së Pashtrikut duke i kërkuar atij
20 që ushtarja të mbrohej duke patur parasysh shërbimet dhe punën
21 që kishte bërë. Sinani u përgjigj se ajo do të merrte detyrat
22 "vetëm pas marrjes së urdhrit me shkrim nga shef Luli".

23 Tani prova 098623, 25, tre faqe, do të shikoni emrat e
24 tre meshkujve të rrëmbyer në tre ditë të ndryshme në tre vende
25 të ndryshme, siç përshkruhet në paragrafin 314 të dosjes

1 përfundimtare. Dhe në 098620, këtu kemi një listë pyetjesh:

2 "Kur keni dëgjuar për UÇK-në?

3 "Kush është në UÇK?

4 "Ça keni dëgjuar për popullin shqiptar?

5 E kështu me radhë.

6 Në provën P1499, një video që të fut frikën, shohim po
7 këto pyetje që u bëhen atyre meshkujve dhe një mashkulli të
8 katërt. Kjo video ju jep një pamje qartë nga brenda të
9 dëshpërimit dhe braktisjes, ndjenjës së braktisjes së të
10 ndaluarve dhe frikën apo dhe më keq, që i pret ata dhe këtu
11 mund të shohim një prej këtyre burrave që thotë, "Jam i
12 shkatërruar, jam një njeri i gjallë i shkatërruar. Thjesht
13 mendimi se fëmijët e vegjël po ju presin nuk mund të -- dhe që
14 nuk mund të rris fëmijët e mi nesër, pra në jetë".

15 Në faqen 098615, shohim këtë mashkullin, personin e
16 katër, 58-vjeçar, llogaritar në pension. Ishte sjellur aty nga
17 Pëllumbi, i cili udhëhiqej nga Ferat Shala dhe që i raportonte
18 drejtpërdrejtë Shtabit të Përgjithshëm, dhe të cilit Rexhep
19 Selimi i kishte caktuar kode. U pranua nga Sahit Jashari, të
20 cilin ju e dëgjuat që deklaronte në videon e majit 1998, se
21 "policia ushtarake e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është
22 përgatitur profesionalisht dhe gjithmonë e gatshme të zbatojë
23 urdhrat që jepen nga Shtabi i Përgjithshëm i Kosovës". Këto
24 katër meshkuj nuk janë gjetur më kurrë, nuk janë parë më kurrë
25 të gjallë.

1 Këto prova të shumta që përsëriten dhe konfirmojnë njëra-
2 tjetrën, mes shumë të tjerave, pasqyrojnë jo vetëm sasinë e
3 jashtëzakonshme të provave që janë paraqitur, por edhe mënyrat
4 e shumta të qëllimit të përbashkët dhe ata që ishin prapa
5 kësaj që shfaqen deri në mënyrë të përsëritur, pra, dhe të
6 vazhdueshme. Dhe gjatë kësaj kohe mesazhi nga Shtabi i
7 Përgjithshëm lidhur me bashkëpunëtorët ishte i njëjti dhe
8 mbetet i njëjti: shënjestrojmë bashkëpunëtorët.

9 Komunikata 47 e lëshuar me 12 maj, deklaroi se gjatë
10 muajve të marsit, prillit, majit, sipas -- bazuar në urdhrat e
11 Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
12 "një numër sulmesh janë realizuar kundër disa
13 kolaboracionistëve shqiptarë të cilët pavarësisht
14 paralajmërimit të mëparshme nuk kishin hequr dorë nga rruga e
15 tyre antikombëtare". Mes gjërave të tjera, kjo ishte periudhë
16 e sulmit të orkestruar nga Demaku, Lladrovci dhe Jashari që u
17 diskutua pak më lart.

18 Komunikata numër 48, e lëshuar më 19 qershor 1998, në të
19 deklarohet se bazuar në urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm,
20 formacionet ushtarake zbatuan, realizuan sulme të armatosura
21 kundër forcave armike dhe "ndërmorën masa ndëshkuese ndaj
22 kolaboracionistëve, elementëve kolaboracionistë të
23 pakorrigjueshëm".

24 Zëdhënësi i Shtabit të Përgjithshëm, Jakup Krasniqi, i
25 cili sipas fjalëve që vetë ka përdorur, "Përfaqëson dhe

1 komunikonte publikisht politikën e Shtabit të Përgjithshëm të
2 UÇK-së në atë kohë", P799, konfirmoi se Shtabi i Përgjithshëm
3 shënjestronte bashkëpunëtorët në një intervistë të 11
4 korrikut, të cilën ai e konfirmoi në dëshminë e dhënë para
5 TPNJ-së se ishte e saktë, ai u pyet lidhur me kritikën ndaj
6 UÇK-së të bëra nga bashkësia ndërkombëtare lidhur me shkeljet
7 e të drejtave të njeriut të serbëve dhe të civilëve serbë dhe
8 malazezë. Ai u përgjigj me një kombinim që kujtohet,
9 mbresëlënës, pra, të pranimit dhe përpjekjes për të shmangur
10 atë, duke u përgjigjur, "Ne nuk shkojmë atje për të rrëmbyer,
11 edhe pse disa njerëz kanë vuajtur, këta janë më shumë
12 bashkëpunëtorë shqiptarë sesa civilë serbë". Kjo është në
13 provën P00793.

14 Kjo ishte e njëjta kohë kur Shtabi i Përgjithshëm
15 përgatitej, përgatiste dhe publikonte rregullore që
16 kodifikonin shënjestrimin dhe "trajtimin e pamëshirshëm" të
17 kundërshtarëve.

18 Mbrojtja, gjithashtu, parashtroi se ajo që quhej UÇK
19 ishte thjesht një kombinim pjesësh të ndryshme dhe njësisish të
20 ndryshme dhe autonome dhe për rrjedhojë ndalimet eventuale apo
21 krimet kundër kundërshtarëve nuk mund t'ju atribuohen të
22 akuzuarve. Por UÇK-ja dhe Shtabi i Përgjithshëm nga krijimi i
23 tij përbëheshin nga një grup i afërt, dhe i ngjeshur me pika
24 të fuqishme të vendosura për një kohë të gjatë. Askush nuk
25 sugjeron se shtrirja e tij dhe sjellja e gjithë njësive të

1 fshatit nën autoritetin e tyre ka ndodhur në mënyrë të
2 menjëhershme. Në fakt, në të kundërt, kjo ka qenë më shumë një
3 proces, proces në të cilin -- ndaj të cilit -- për të cilin të
4 akuzuarit ishin të përkushtuar dhe që ka qenë -- ka patur
5 sukses të jashtëzakonshëm në një periudhë të shkurtë kohore
6 për fat, dhe falë lidërshtipit, pra.

7 Por shohim vendet ku kundërshtarët janë shënjestruar dhe
8 kjo ka qenë gjë që është zbatuar në mënyrë brutale dhe të
9 pagabueshme dhe shohim tani lidhjen mes këtyre vendeve dhe
10 Shtabit të Përgjithshëm.

11 Likoci ka qenë shtabi i zonës së Drenicës dhe shtabi i
12 policisë ushtarake të zonës. Këtë e shohim në faqen 636 të
13 dosjes përfundimtare të Prokurorisë. Një pikë mbledhje apo
14 takimi nga ku rekrutët shpërndareshin pastaj në zonat, dhe, në
15 fakt, Shtabi i Përgjithshëm ishte i bazuar aty nga marsi deri
16 në fund të majit 1998. Kjo është në P776, në faqe 44, 48.

17 Gjithashtu, kishin një vend ndalimi që ishte i njohur
18 shumë mirë dhe që krijonte ndjenjë frike tek popullsia vendore
19 ku mbaheshin të ndaluar civilë, përfshirë bujq, mësues,
20 persona të moshuar, të cilët akuzoheshin për gjëra të tilla si
21 bashkëpunëtorë, mbështetës të LDK-së, spiunë, tradhtarë, sepse
22 mbështesnin Rugovën dhe kjo është në dosjen përfundimtare të
23 ZPS-së, në faqen 652, dhe akuzoheshin se nuk kishin lënë punën
24 e tyre, dosja përfundimtare në faqen 659, apo kanë treguar, i
25 janë nënshtruar pushtuesit duke shpërndarë certifikata lindje.

1 Kjo është në faqen 644, 652, 659 të dosjes përfundimtare. Të
2 burgosurit janë keqtrajtuar në mënyrë brutale dhe disa janë
3 edhe vrarë.

4 Komandanti i Likocit ishte Sylejman Selimi, i afërt i
5 Rexhep Selimit i cili e kishte prezantuar atë me Adem Jashari.
6 Në maj '98 Sylejman Selimi u zgjodh komandant i zonës
7 operative të Drenicës gjatë një mbledhje ku mori pjesë Rexhep
8 Selimi dhe caktimi i tij u miratua nga Shtabi i Përgjithshëm.
9 Sylejman Selimi shpjegoi se përveç vizitave të shumta nga
10 Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Sokol Bashota, Rexhep Selimi
11 ishte gjithmonë i pranishëm në zonë.

12 Në një intervistë në fund të korrikut 1998, Sylejman
13 Selimi u pyet: "Kush merrej me ekzekutimin e dënimit kundër
14 bashkëpunëtorëve dhe serbëve dhe kriminelëve serbë të
15 rrëmbyer?". Pyetje e cila në vetvete shfaq sekretin që nuk
16 është sekret se kundërshtarët shënjestroheshin. Ai pranoi se
17 ndalimet, por duke vazhduar më tej -- duke marrë përgjegjësitë
18 nga Jakup Krasniqi deklaroi se gjithçka është bërë në
19 përputhje me ligjin ushtarak.

20 Zëvendëskomandanti ishte Sami Lushtaku, një mik i vjetër,
21 një shok i vjetër i Rexhep Selimit, i cili ishte kthyer në
22 Kosovë me Thaçin dhe Veselin menjëherë pas Prekazit. Kjo është
23 në provën 1771 dhe 773. Ai personalisht informoi një të
24 ndaluar të rrahur se ai dhe babai i tij ishin ndaluar për
25 shkak të pretendimit se ishin spiunë. Dha një intervistë në

1 maj të '98-s që u sekuestrua nga shtëpia e Rexhep Selimi, në
2 të cilën pranoi se "kemi vrarë oficerë të policisë, ushtarët
3 dhe bashkëpunëtorët e tyre". P1266.

4 Sahit Jashari komandanti i policisë ushtarake ishte një
5 tjetër shok i vjetër nga ditët e para të UÇK-së. Dhe ne e kemi
6 përmendur përkushtimin e tij për Shtabin e Përgjithshëm.

7 Dhe Sabit Geci i cili ishte udhëheqës i një njësi në
8 Drenicë, në zonën operative të Drenicës e përfshirë në Likoc,
9 dhe i jepte llogari Shtabit të Përgjithshëm, në veçanti Kadri
10 Veselit. Ishte në shtëpinë e Gecit, Rexhep Selimi shkoi në
11 shtëpinë e Gecit për të bërë fjalimin e tij lidhur me
12 paraqitjen e parë publike të UÇK-së të cilin, Selimin, pastaj
13 e takoi shumë shpesh në pranverë dhe verë të '98-s. Kjo është
14 në dosjen përfundimtare faqja 315.

15 Të gjithë morën pjesë në keqtrajtimin e të ndaluarve.

16 Tani shohim Jabllanicën, e cila ishte -- dhe kjo është në
17 faqen 676 në vijim të dosjes përfundimtare të ZPS-së,
18 Jabllanica ishte një vend ku të ndaluarit u mbajtën nën kushte
19 çnjerëzore, u keqtrajtuuan brutalisht sepse akuzoheshin se
20 ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë, dhe aty komandanti ishte Lahi
21 Brahimaj, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm me lidhje të gjata
22 me të akuzuarit. Veseli është fshehur në shtëpinë e Brahimajt
23 në Jabllanicë në fillim të viteve '90, dhe Brahimaj propozoi
24 një pseudonim të Veselit. Nga mesi i viteve '90, Selimi në
25 mënyrë të shpeshtë u takua -- u takua shpesh me Brahimaj dhe

1 ka qëndruar në shtëpinë e tij në Jabllanicë duke organizuar
2 transferimin apo përcjelljen e armëve, planifikimin e
3 aktiviteteve ushtarake. Midis '95-s dhe marsit të '98-s Thaçi
4 dhe Brahimaj, njëri prej pikave të kontaktit kryesor dhe
5 Thaçit në Kosovë u takua një herë dhe dy herë në vit. Shohim,
6 pra, në faqen 671 të dosjes paraprake. Brahimaj ishte
7 gjithashtu i pranishëm në një takim të komandës të Dukagjinit
8 ku miratuan rregullat që parashihehin për ekzekutimin e
9 bashkëpunëtorëve me enemikun.

10 Kur u refuzua kërkesa e një grupi të pleqve të vjetër të
11 fshatit për lirin e një të burgosuri, Brahimaj i kërkoi
12 grupit pse nuk po luftonin dhe deklaroi Rugovën tradhtar dhe
13 mbështetës të autoriteteve serbe. Në një rast tjetër ai e
14 akuzoi të ndaluarin dhe të tjerë nga fshati se ishin
15 mbështetës të UÇK-së dhe tradhtarë sepse ishin larguar kur
16 ishte bërë një sulm nga forcat serbe. Brahimaj vetë mori pjesë
17 në arrestimin dhe keqtrajtimin e të ndaluarve.

18 Ndoshta dhe një vend tjetër, dhe ndoshta kjo është koha
19 për të bërë pushim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Do të bëjmë një gjysëm ore pushim.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, thjesht desha të them
23 se disa anëtarë të ekipit tonë mund të hyjnë dhe të dalin
24 gjatë seancës dhe doja të informoja Trupin Gjykses që të mos
25 kemi probleme lidhur me këtë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni në
2 mënyrë të qetë që mos bëjë zhurmë kur mbyllet dera.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Thjesht gjatë pushimit dhe jo
4 gjatë kohës kur palët po flasin. Faleminderit.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
6 kthehem në orën 11.00. Faleminderit.

7 --- Pauza fillon në orën 10.28

8 --- Seanca rifillon në orën 10.59

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tieger,
10 mund të vazhdoni.

11 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit.

12 Sa për Sekretarinë, të gjithë diapozitivat që mbetën do
13 të shfaqen në publik vetëm në qoftë se unë them të kundërtën,
14 përndryshe nuk duhet të transmetohen.

15 Të nderuar Gjykatës, edhe nga vende të tjera të ndalimit
16 për këtë periudhë që nga pranvera deri në verë, Llapushnik.
17 Siç është paraqitur në paragrafin 698 e më tutje të dosjes
18 sonë përfundimtare, mbi 100 civilë janë mbajtur dhe i janë
19 nënshtruar trajtimit brutal tmerrues për shkak se ishin
20 etiketuar si spiunë dhe kolaboracionistë, ndoshta përfshirë
21 edhe se ishin anëtarë të LDK-së.

22 Njësia Çeliku 3 e operonte këtë dhe komandant ishte
23 caktuar dhe raportonte Fatmir Limajt, që ishte edhe
24 personalisht i përfshirë në këtë vend të paraburgimit.

25 Limaj u anëtarësua në UÇK në vitin 1996, përmes mikut të

1 tij apo shokut të tij Rexhep Selimit, me të cilin kishte
2 bashkëjetuar gjatë studimeve në Prishtinë. Pas largimit nga
3 Kosova në vitin 1997, Limaj u kthye bashkë me Hashim Thaçin,
4 Kadri Veselin menjëherë pas Prekazit dhe mori komandën duke
5 operuar nën autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm duke i
6 dërguar, duke përçuar urdhra dhe duke i raportuar Shtabit të
7 Përgjithshëm, që është prova materiale 8812.

8 Limaj deklaro publikisht se njësitë e kësaj zone ishin
9 nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm, i tha televizionit të
10 Tiranës se ishte "detyra e tij për të përsëritur qëndrimin e
11 UÇK-së, qëndrimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së që nuk
12 mund të ketë bisedime për Kosovën pa UÇK-në" dhe më pas u bë
13 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm si shef i drejtorisë së
14 policisë ushtarake që ndodhet në P24146, në faqen 838 dhe në
15 paragrafin 281 të dosjes përfundimtare.

16 Në Llapushnik, Limaj i tha një të paraburguari që është
17 arrestuar për shkak se i kishte shitur dru serbëve dhe romave,
18 që është në T220422-23. Një fletore shënimesh që ishte
19 sekuestruar nga apartamenti i Limajt, kishte shënime lidhur me
20 të ashtuquajturin bashkëpunëtor, përfshirë edhe një druvar i
21 cili ishte ndaluar në Llapushnik dhe ekzekutuar në Malet e
22 Berishës në fund, nga fundi i qershorit 1998, që është në
23 provën 2018-2018.

24 Limaj kishte kontakte me Shtabin e Përgjithshëm. Dhe
25 shpeshtësia e këtyre komunikimeve dhe kontakteve ishte e tillë

1 sa që Rexhep Selimi i tregoi TPNJ-së në mbrojtje të Limajt se
2 nuk mund të kishte patur ndonjë vend paraburgimi që të mos
3 kishte ekzistuar pa njohurinë e tij, që është paragrafi 599 të
4 dosjes përfundimtare.

5 I nderuar Gjykatës, ajo që ka ndodhur në vendet të cilat
6 nuk ishin nën autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm gjatë
7 kësaj periudhe të zgjerimit të përgjithshëm, synimi i
8 përgjithshëm ishte zbatuar në të gjitha këto zona të drejtuara
9 dhe të instaluar nga ata të cilët e kishin bërë të qartë se
10 ndiqnin Shtabin e Përgjithshëm dhe të cilin e kishin njohur
11 dhe bashkëpunonin për vitesh dhe duke njohur dhe bashkëpunonin
12 prej vitesh.

13 Dhe duke folur, siç e citova Rexhep Selimim para pak
14 çastesh, bëhet fjalë për vende të paraburgimit të cilat mund
15 të kenë ndaluar pa njohurinë e tij, siç e kam theksuar edhe
16 përfshirjen e jashtëzakonshme organizative të të akuzuarve, të
17 cilët në përgjithësi i kishin caktuar në këto vende. Le të
18 shikojmë disa.

19 Siç qesh me thënë, Thaçi, Veseli dhe kryesisht Selimi
20 ishin rregullisht në rregullisht në Likoc në atë kohë, në atë
21 periudhë. Shtabi i Përgjithshëm kishte gjatë majit, ai kishte
22 shtabin e kishte selinë e tij në atë vend ku katër të
23 burgosurit u ndaluan në katër ditë të caktuara, u morën në
24 pyetje për shkak për arsye propagande dhe u përgatitën sipas
25 një modeli të caktuar.

1 Në Bellagevc, në minierën e Bellagevcit kur ajo u mor në
2 qershor të 1998-s, ishte mbuluar kjo çështje nga media dhe
3 dokumentuar në raportet ndërkombëtare dhe ishte e njohur.
4 Ndodhet kjo në dosjen tonë në 1097. Thaçi dhe Veseli shkuan
5 atje pasi ishte marrë dhe kjo mund të shihet në fotografinë që
6 reflekton pikërisht kontrollin e UÇK-së në një video dhe
7 armën. Nëntë minatorë janë rrëmbyer nga UÇK-ja, nuk ishte
8 sekret. Negociatat janë mbajtur në përpjekje të kotë për të
9 siguruar edhe lirimin e tyre. Ata nuk u liruan dhe nuk janë
10 parë më, që ndodhet në paragrafin 377-78 të dosjes sonë.

11 Pas një muaji, Rahoveci është marrë nën kontroll
12 shkurtimisht nga UÇK-ja. Pavarësisht se Shtabi i Përgjithshëm
13 kishte deklaruar, se kishte përfunduar, se nuk ishte gati për
14 ta marrë Rahovecin, dikush nxitoi dhe ndodhi një
15 kundërofensivë shumë e rëndësishme. Dhe Shtabi i Përgjithshëm
16 i UÇK-së, përfshirë Thaçin, Veselin dhe Selimin, ju përgjigjën
17 menjëherë duke caktuar Agim Çelajn që të komandonte dhe të
18 merrte pjesë në mënyrë personale. Dhe kjo ndodhet në faqen 232
19 dhe 792 të dosjes sonë.

20 Janë rrëmbyer mbi 50 civilë në Rahovec, Opterushë dhe në
21 Reti. Raportet me shkrim gjatë kësaj periudhe tregojnë sesi
22 janë marrë civilët, për shembull, thuhet "22 individë janë
23 marrë. Dhe janë burgosur 7 gra, të cilat do të liroheshin", që
24 ndodhet në provën 67.

25 Shtabi i Përgjithshëm, në fakt, më vonë edhe shprehte

1 krenari publike lidhur me lirimin e grave të parandaluar dhe
2 këtë ndaj Kryqit të Kuq, në provën 4155.

3 Mburra për lirimin e grave në fakt tregon apo ngre
4 pyetje për atë që i kanë ndodhur burrave. Dhe siç mund të
5 shihet, përgjegjësia e Shtabit të Përgjithshëm lidhur me këtë
6 tregohet në mënyrë të frikshme në paragrafin 892, 817 të
7 dosjes sonë.

8 Mbrojtja ka argumentuar se provat e një dëshmitari nuk
9 mund t'i besohet atij dhe sugjerojnë një motivacion i cili
10 është i vështirë që të jetë në përputhjet me angazhimin e një
11 personi të caktuar, siç është provuar dhe në mënyra të tjera
12 nga provat nga Dëshmitari W04098 apo nga rreziqe që
13 parashtrohen në këtë drejtim. Dhe hollësitë dhe konteksti i
14 informacionit të këtij dëshmitari është bindës në mënyrë të
15 plotë, kryesisht për sa ka të bëjë me provat që kanë treguar
16 dhe viktimat, numrin e njësive që kanë marrë pjesë në këtë
17 sipas urdhrave të Shtabit të Përgjithshëm, dy raporte të UÇK-
18 së të veçanta - P67 dhe P1329 - tregojnë në mënyrë faktike
19 sesi janë marrë dhe të burgosurit civilë. Mes dy ekzekutimeve
20 kryesore dhe hedhjen e trupave në këtë zonë, një person që
21 punonte për organizatën ndërkombëtare kishte dëgjuar nga Kryqi
22 i Kuq në Malishevë lidhur me rrëmbimet dhe e ngriti këtë
23 çështje të ndalimeve dhe të qasjes së Kryqit të Kuq me Thaçin
24 dhe me Veselin dhe për sa i përket të burgosurve të cilët
25 jetonin dhe mbaheshin në stacionin e policisë aty afër. Thaçi

1 dhe Veseli nuk thanë për çfarë ndalimesh bëhej fjalë, për
2 çfarë po flisni, por, në fakt, ata në fakt u dhanë sigurime
3 dhe pretime se UÇK-ja do të respektonte Konventën e Gjenevës.
4 Dhe më pas, siç u përmend, ata, në fakt, mburreshin se si
5 kishin liruar gratë.

6 Gjatë kësaj periudhe që kam diskutuar, që nga pranvera
7 dhe vera e 1998-s, shënjestrimi dhe keqtrajtimi i
8 kundërshtarëve ishte dhe shenja dalluese e përpjekjeve të
9 Shtabit të Përgjithshëm edhe përpara marsit të 1998-s dhe kjo
10 ishte e dukshme kudo ku kanë shkuar dhe kudo ku kanë caktuar
11 vartësit e tyre. Dhe kjo është e dukshme dhe në deklaratat e
12 tyre në komunikatat e tyre dhe në rregulloret që kanë nxjerrë.

13 Sulmi në Rahovec, në fakt, shkaktoi edhe një përgjigje të
14 ashpër nga ana e forcave serbe, të cilat, në fakt, i
15 shkatërruan selitë e UÇK-së dhe me forcë i nxorën civilët nga
16 këto zona. Dhe përballuar me pyetjet dhe me pikëpyetjet që u
17 ngritën lidhur me vuajtjen e panevojshme dhe efekshmërinë e
18 UÇK-së dhe strategjinë e saj apo të asaj që mund të ndodhte më
19 vonë, Shtabi i Përgjithshëm e shikoi, e perceptoi rrezikun dhe
20 kundërshtimin dhe e përmendi në këtë rast dogmat e Shtabit të
21 Përgjithshëm si, për shembull, të një "lufte të posaçme".

22 Lufta e posaçme kishte, mendohej se kishte të bënte me
23 çështje si spekulimi lidhur me institucionet të cilat do të
24 përfaqësojnë Kosovën, merrnin informacione apo keqinformacione
25 që shpërndahej për të krijuar panik, difitizmin apo duke u

1 kërkuar njerëzve që të dorëzonin armët apo të kërkonin një
2 zgjidhje të përkohshme të statusit të Kosovës dhe të gjithë
3 ata që do bënin këtë gjë do të trajtoheshin në mënyrë të
4 pamëshirshme. UÇK-ja dhe populli shqiptar deklaroi Shtabi i
5 Përgjithshëm "po thereshin në shtëpi nga kolaboracionistët dhe
6 pacifistët". Prova 270.

7 Në gusht të 1998, për shembull, Shtabi i Përgjithshëm,
8 drejtoria e saj politike paralajmëruan se do të ishte një
9 grusht "i pamëshirshëm" ndaj të gjithë atyre të cilët i bënin
10 luftës speciale përmes "spekulimit" apo ndërtimit të
11 institucioneve, një projekt i cili Shtabi i Përgjithshëm e
12 kishte filluar në përgjigje ndaj interesit ndërkombëtar me një
13 bashkëpunëtor të vetëm.

14 Në 18 shtator, Shtabi i Përgjithshëm në Komunikatën 53,
15 tha që "janë marrë masa ndëshkuese ndaj kolaboracionistëve të
16 cilët vazhdojnë që t'i shërbejnë pushtuesit" dhe më 21 shtator
17 në Komunikatën 54 deklaroi, "të gjithë emisarët apo të
18 ashtuquajturit emisarë të cilët janë vendosur në shpinë të
19 armikut duke bërë luftë speciale ndaj luftës sonë çlirimtare
20 ... të cilët janë kolaboracionistë dhe aktivistë politikë të
21 cilët vetëm sa mbjellin ndjesinë e humbjes".

22 Këto dy komunikata të Qirezit. Më 20 shtator, në Qirez
23 dhe në Baicë, në të cilat Thaçi, Selimi dhe Sabit Geci çuan në
24 arrestimin, ndalimin dhe në rrahjen e deputetëve të cilët
25 ishin, po bënin vizita humanitare në pjesë të ndryshme të

1 Kosovës me miratim të Ibrahim Rugovës. Siç u shpjegua në
2 njoftimin për shtyp të ministrisë së policisë ushtarake të
3 UÇK-së, citoj:

4 "Bazuar në informacionin e inteligjencës, të shërbimit të
5 inteligjencës së UÇK-së më 20 shtator 1998, në orën 12.15
6 policia ushtarake arrestoi 13 sindikalistë dhe përfaqësues të
7 partisë institucionaliste në fshatin Qirez, në Drenicë, për
8 shkak të propagandës së tyre partizane, skizmatike,
9 institucionaliste edhe kundër luftës çlirimtare dhe për
10 dorëzimin e armëve për zgjidhjen e përgjithshme të statusit të
11 Kosovës ..."

12 Dhe vërejte në këtë drejtim se do të vazhdonin kundër tre
13 personave këto hetime.

14 Ndalimet dhe rrahjet nuk e dërguan këtë mesazh dhe as nuk
15 kishin përçuar këtë mesazh, menjëherë pas largimit, Geci
16 kërcënoi që të vriste Agim Krasniqin në praninë e Thaçit. Dhe
17 Thaçi vetë kërcënoi W02325 që ka refuzuar që të hiqte dorë nga
18 pozita e tij politike duke i thënë atij "Dhe në qoftë se tani
19 je i lirë, ne mund të vrasim në Prishtinë për shkak se kemi
20 njerëzit tanë". Dhe kjo ndodhet në paragrafin 940 të dosjes
21 sonë.

22 Shtabi i Përgjithshëm vazhdoi luftën kundër
23 kundërshtarëve të cilët shiheshin se po bënë luftën speciale.
24 Në javën e parë të tetorit, Jakup Krasniqi nënvijëzoi në një
25 intervistë se "lufta speciale" dhe përpjekjet e tyre për të

1 justifikuar luftën, pjesën "paqësore" apo ndjekjen e rrugës
2 paqësore dhe që flisnin për humbjet e UÇK-së në këtë mënyrë
3 donin që të "shkatërronin" UÇK-në dhe kjo ndodhet në 3713.

4 Më 30 tetor u arrestuan zyrtarët e UÇK-së, Jakup Kastrati
5 dhe Cen Desku, që ndodhen në dosjen tonë në paragrafin 956,
6 969, përshkruan në hollësi se çfarë u ka ndodhur atyre.

7 Njoftimi për shtyp i policisë ushtarake të UÇK-së numër 4
8 shpjegoi se, ato thuhej se "kishin shpërndarë propagandë për
9 dorëzimin e armëve në bashkëpunim me bashkëpunëtorët", Selman
10 Binishi nga fshati Banjë dhe Ramiz Hoxha nga Bellanica, të
11 cilët ishin ekzekutuar para pak kohësh nga UÇK-ja.

12 Siç i tha trupit diplomatik, përfaqësuesit diplomatik
13 Larry Rossin, Bardhyl Mahmuti në përgjigje ndaj shqetësimeve
14 të shprehura nga Shtetet e Bashkuara lidhur me këto dy zyrtarë
15 të UÇK-së, citoj "në këtë rast kemi të bëjmë me dy spiunë
16 kolaboracionistë të regjimit represiv serb. Ata janë arrestuar
17 për shkak se i kanë shkaktuar dëm kauzës sonë", dhe tha se
18 "Shtabi i Përgjithshëm kishte autoritetin për të lejuar qasjen
19 ndaj tyre për të gjithë". Kjo ndodhet në provën 1090.

20 Walker, në të njëjtën mënyrë, iu tha se përfaqësuesit të
21 Shtabit të Përgjithshëm gjatë procesit të lirimit të tyre që
22 "Këta ishin tradhtarë të cilët ishin përpjekur, të cilët i
23 kemi marrë në gjyq dhe nuk do ta bëjmë edhe herë tjetër", që
24 ndodhet në transkriptin T2312-13.

25 Trupit Gjykses do t'i kujtohet se si Binishi dhe Hoxha u

1 ekzekutuan dhe u lanë në anë të rrugës. Një "urdhër
2 ekzekutimi" i shkruar me dorë dhe i lëshuar nga policia
3 sekrete në trupin e Hoxhës lexonte:

4 "Për bashkëpunim me okupatorin dhe për shpërndarjen e
5 propagandës antishqiptare duke krijuar frikë, panik dhe
6 urrejtje në emër të popullit shqiptar dhe në emër të luftës
7 sonë, Ramiz Hoxha nga Bellanica dënohet me vdekje si tradhtar
8 i kombit. Ky fat i pret edhe tradhtarët e tjerë", që ndodhet
9 në dosjen tonë 8889.

10 I njëjti njoftim i policisë ushtarake tha se Desku dhe
11 Kastrati "bashkëpunojnë me Agim Krasniqin, anëtar i
12 presidencës së UÇK-së, i cili njihet, është i njohur nga
13 shërbimi i inteligjencës së UÇK-së si një frymëzues i luftës
14 speciale kundër UÇK-së dhe i një policie, iniciatori i një
15 policie autonome të Kosovës".

16 Lufta, justifikimi për luftë në emër të luftës speciale
17 për arrestimin e Deskut dhe të Kastratit është dhe në provën
18 12510, një vendim i "gjykatësit hetues të gjykatës ushtarake
19 të UÇK-së, në bazë të informacioneve të shërbimit të
20 inteligjencës së UÇK-së" ku thuhej që Kastrati dhe Desku që
21 nga fillimi i ofensivës së armikut "kishin bërë luftë speciale
22 kundër UÇK-së dhe popullit tonë dhe lirisë dhe pavarësisë".

23 Si ata e mbrojtën këtë qëndrim?

24 "Ata kishin mbrojtur qëndrimin e mjerueshëm të partisë së
25 cilës i takojnë i cili gjithmonë kishte penguar angazhimin e

1 popullit tonë në luftën për liri, kanë shprehur pasiguri dhe
2 defetizëm. Dhe ata nuk kanë ndihmuar Ushtrinë Çlirimtare të
3 Kosovës dhe në të kundër e kanë penguar, sabotuar luftën e
4 saj".

5 Shtabi i Përgjithshëm, po kështu, ka bërë, ka shprehur
6 mendimin se lufta speciale ishte e përgjithshme. Për shembull,
7 në fund të dhjetorit në një takim të Shtabit të Përgjithshëm
8 me komandantë të zonave, Zyrap i nxori një raport të bazuar në
9 një raport të shkruar që kishin marrë nga zonat lidhur me
10 çështje të ndryshme. Sa i përket Mbrojtjes dhe sigurisë,
11 Zyrap i tha, citoj "njësitë speciale dhe policia ushtarake
12 japin ndihmë të veçantë duke u përballur me luftën speciale të
13 armikut dhe dorës së shtrirë të tij". Prova 228.

14 Intensifikimi i luftës kundër kundërshtarëve përkoi me
15 angazhimin në rritje të UÇK-së me komunitetin ndërkombëtar nga
16 pjesa e dytë e 1998-s. Kjo ishte një periudhë tek e cila, në
17 fakt, solli edhe një kontroll të pakëndshëm të aktiviteteve të
18 tyre dhe statusit të tyre të siguruar. Për shembull, në
19 korrik të 1998-s, siç u tha më herët, W02144 i ngriti
20 pretendimet e paraburgimit dhe të rrëmbimit dhe të qasjes së
21 Kryqit të Kuq ndaj personave të ndaluar me Thaçin dhe me
22 Veselin.

23 Në shtator të 1998, reporteri i posaçëm i Komisionit të
24 të Drejtave të Njeriut, Jiri Dienstbier, shprehu alarm lidhur
25 me raportet e rrëmbimeve të bëra nga UÇK-ja kundër civilëve

1 serbë dhe shqiptarë kryesisht, duke i denoncuar në mes të
2 korrikut rrëmbimin e 51 civilëve nga Rahoveci. Në Deklaratën
3 Politike numër 16 të tetorit 1998, Shtabi i Përgjithshëm i
4 cili "ndiqte nga afër zhvillimet politike dhe diplomatike që
5 kishin të bënin me Kosovën" e karakterizoi përfaqësimin e
6 Dienstbier si "të papërgjegjshëm" dhe si "një sulm ndaj luftës
7 sonë çlirimtare". Prova 159.

8 Në fillim të nëntorit, përfaqësues të The Human Right
9 Watch takuan Thaçin dhe Limajn për të diskutuar mbi arrestimin
10 e dy gazetarëve serbë dhe në përgjithësi shqetësimet lidhur me
11 pretendimin për shkelje nga ana e UÇK-së, përfshirë edhe
12 ngacmimin, frikësimin dhe vrasjet, që ndodhen në dosjen tonë
13 në 591.

14 Një nga përgjigjet ndaj kësaj analize të hollësishme nga
15 ana e ndërkombëtarëve erdhi përmes urdhrit të Bislím Zyrapit
16 të 28 nëntorit 1998, që ndodhet në transkriptin 17640.

17 Ky urdhër kishte të bënte në mënyrë të drejtpërdrejtë
18 lidhur me kontrollin e centralizuar ndaj arrestimeve dhe
19 ndalimeve dhe mund të shihet, duhet kuptuar në kontekstin e
20 plotë përfshirë edhe kontrollin e centralizuar që kishte të
21 bënte me shenjëstrimin e kolaboracionistëve apo
22 bashkëpunëtorëve dhe ky ishte problemi dhe jo zgjidhja, dhe
23 Shtabi i Përgjithshëm me komunikatën e tij e kishte bërë të
24 qartë se nuk i konsideronte bashkëpunëtorët si persona të
25 cilët gëzonin mbrojtjen që u jepej civilëve dhe në këtë mënyrë

1 vazhdoi shenjëstrimi dhe keqtrajtimi i kundërshtarëve.

2 Kam folur lidhur me periudhën mars-korrik dhe për tre
3 vende të paraburgimit. Të shohim edhe një numër tjetër,
4 Bajgorën dhe Llapashticën.

5 Bajgora është vendi i selisë së zonës së Llapit apo
6 shërbeu si vendi i selisë së zonës në Llapit nga korriku deri
7 në mes të shtatorit 1998. Gjatë kësaj periudhe janë ndaluar
8 atje të paktën 16 persona. Nga fillimi i tetorit, në
9 Llapashticë ishte edhe vendi ku janë mbajtur të ndaluar në një
10 stallë një numër personash të zonës së Llapit, më shumë se 20
11 të parandaluar janë mbajtur atje, janë marrë në pyetje, janë
12 rrahur dhe shpesh dhe disa herë janë vrarë për shkak se ata
13 quheshin bashkëpunëtorë për arsye të ndryshme, përfshirë se
14 ishin shumë të afërt me disa serbë, shisnin dru, nuk ishin
15 mbyllur në një degë të UÇK-së apo se ishin druvarë, që ndodhet
16 në dosjen 880, 910.

17 Komandanti i zonës së Llapit ishte Rustem Mustafa, Remi,
18 një bashkëpunëtor i ngushtë i Rexhep Selimit, i cili ishte me
19 Selimin dhe Jasharin përpara sulmit fatal në shtëpinë e
20 Jasharëve. Latif Gashi, shefi i seksionit të inteligjencës së
21 zonës së Llapit, ishte i pranishëm rregullisht në këtë zonë
22 duke drejtuar rrahjen e të paraburgosurve edhe duke marrë
23 pjesë edhe personalisht.

24 Këto ishin rrahje të llahtarshme për të cilat do të
25 dëgjoni nga z. Pace më vonë.

1 Do të shohim edhe provat e filozofisë së marrjes në
2 pyetje nga z. Gashi, të cilat reflektohen edhe kur ai i dha
3 udhëzime një bashkëpunëtori në mars të 1999-s që i cili duhej
4 dhe citoj që "këto marrje në pyetje të ishin në seanca nga tre
5 dhe katër orëshe duke e rrahur gjatë gjithë kohës, ngadalë dhe
6 në mënyrë të plotë". Prova P3551.

7 Këto vrasje janë bërë përmes autorizimit të Shtabit të
8 Përgjithshëm. Remi e krijoi Bajgorën mbi bazën e komunikatave,
9 duke iu referuar asaj që përndryshe është e dukshme për të
10 gjithë ata që veprojnë në mënyrë të verbër - që Shtabi i
11 Përgjithshëm i dënonte bashkëpunëtorët dhe kundërshtarët dhe
12 kishte kërkuar edhe masat më të ashpra kundër tyre. Remi
13 shpjegoi më tutje, se edhe pasi kishte marrë urdhër nga Shtabi
14 i Përgjithshëm për të paraburgosur bashkëpunëtorët i cili
15 ishte, ky ishte rezultat i nevojave të posaçme edhe të
16 ofensivës së verës. Citoj, "Dhënia e një urdhri është bërë në
17 një kohë kur ka patur nevoja specifike pas ofensivave të
18 shtatorit", që ndodhet në provën 693.5.

19 Dhe siç e kemi parë, Shtabi i Përgjithshëm në fakt i
20 është përgjigjur në mënyrë të ashpër ndaj rrezikut të humbjes
21 së mbështetjes në fund të ofensivës së verës duke etiketuar të
22 gjitha alternativat ndaj pozitive të Shtabit të Përgjithshëm
23 si luftë speciale apo një vepër penale tradhtare.

24 Ky mesazh është dhënë në mënyrë personale në Llap. Pas
25 diskutimit nga Shtabi i Përgjithshëm të luftës speciale në

1 takimin e 16 gushtit, Thaçi, Krasniqi, Selimi dhe Zyrapi
2 shkuan në zonat e Shalës dhe të Llapit dhe ngritën këtë
3 çështje dhe mënyrën sesi ta trajtonin atë.

4 Pas këtyre përgjigjeve, zona e Llapit krijoi një broshurë
5 mbi luftën speciale dhe në fund të nëntorit ku u shpjegua se
6 lufta speciale, mes të tjerave, "kërkonte dialog dhe zgjidhje
7 politike" dhe, në fakt, "çdo përforsim i pacifizmit", pasi dhe
8 citoj, "mund të rezultojë në faktorin e UÇK-së që të injorohet
9 nga komuniteti ndërkombëtar". Prova P164.

10 Pas vizitës së Llapit në gusht, anëtarët e Shtabit të
11 Përgjithshëm u kthyen nga fundi i tetorit, përfshirë Hashim
12 Thaçin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimi mes të tjerëve.
13 Prova 189.

14 Shënimet që janë sekuestruar nga shtëpia e Rexhep Selimit
15 dhe që janë pranuar si provë materiale 181 tregojnë se çfarë
16 është diskutuar në atë çast edhe në atë rast. Edhe këtë herë
17 bëhet fjalë për diskutimin e luftës speciale për të cilën Remi
18 siguron se ishte nën kontroll - "propaganda dhe lufta speciale
19 nuk janë të pranishëm". Shënimet më pas pasqyrojnë diskutimin
20 me Latif Gashin, i cili u referua një të paraburgosuri ku i
21 cili ishte liruar pas diskutimit me Thaçin dhe kryesisht me
22 Selimin dhe një të ndaluar tjetër, i cili ishte rrahur dhe
23 kishte vdekur dhe trupi i të cilit ishte hedhur në një gropë
24 jo shumë të thellë afër vendit të paraburgimit ku kishte
25 mbetur deri pas luftës kur Remi dhe ushtarët e tjerë i treguan

1 familjes se ku ndodhej ky vend. Dhe siç e tregojnë këto
2 shënime, aty tregohet se si është mbuluar kjo çështje dhe nuk
3 është shpjeguar vdekja e këtij të paraburgosuri në të cilin
4 është thënë që ai është ekzekutuar nga forcat serbe, që është
5 paragrafi 867 i dosjes sonë.

6 Për arsye të ndryshme, ne vlerësojmë se këto shënime të
7 cilat janë mbajtur nga zoti -- ne i vlerësojmë këto shënime të
8 mbajtura nga z. Selimi. Dhe kjo është prova 181. Është e qartë
9 se inspektimet e këtij lloji i ka bërë në mënyrë të rregullt
10 në një kohë kur dihet që ka bërë këto vizita. Dhe Remi në
11 mënyrë të pagabueshme i bisedon me një anëtar të Shtabit të
12 Përgjithshëm kur bëhet fjalë për këtë çështje. Latif Gashi
13 pyet se kishte dyshime gjatë kësaj kohe që ju "keni
14 bashkëpunuar me një bashkëpunuar i cili ishte liruar" dhe që
15 kjo pasqyronte pranimin nga ana e Selimit që, në fakt, ai
16 ishte i pari nga ana e UÇK-së që e kishte trajtuar çështjen e
17 Sulevic që ndodhet në provën 53.6 dhe në provën 19. Edhe stili
18 dhe shkrimi i këtyre shënimeve është i ngjashëm me atë të
19 tjerat dhe konteksti e bën të qartë që është shkrimi i tij.

20 Edhe një tjetër që ka të bëjë lidhur me qëllimin e
21 përbashkët dhe përpara se znj. Lawson të flasë për 1999.

22 Do t'ju kujtohet deklarata e 1 nëntorit e policisë
23 ushtarake që kishte dënuar Kastratin dhe Deskun për
24 bashkëpunimin me Agim Krasniqin që ishte anëtar i presidencës
25 së LDK-së i cili quhej si "frymëzuesi i luftës speciale kundër

1 UÇK-së dhe nismëtari i një lloj policie autonome të Kosovës".
2 Në të njëjtën kohë, udhëheqësit e UÇK-së janë përshkruar si
3 Thaçi "dhe kolegët e tij", u thanë Shteteve të Bashkuara se
4 nuk do ta mbështesnin një zgjidhje e cila në mënyrë të hapur
5 nuk siguronte pavarësinë, se të gjitha forcat serbe duhet të
6 liroheshin, duhet të largoheshin dhe "insistonte se UÇK-ja, jo
7 Rugova dhe askush tjetër, do të vendosnin se cila do të ishte
8 forca policore e shqiptarëve etnikë të së ardhmes ..."

9 Thaçi dhe Krasniqi takuan përfaqësuesit e Shteteve të
10 Bashkuara përsëri më 6 nëntor, kur drafti i Hill për një
11 zgjidhje të përkohshme të krizës, siç dhe u paraqit dhe e
12 hodhën poshtë konceptin e një force lokale policore të re e
13 cila nuk ishte përfaqësuese e ekuilibrit etnik në provincë,
14 duke insistuar se "kishte vetëm një forcë policore të Kosovës
15 dhe ajo ishte forca e UÇK-së", duke theksuar se çdo anëtar i
16 një force të re policore shqiptare do të konsiderohej si një
17 "polic serb".

18 Ky qëndrim është mbështetur edhe në vlerësimin e
19 ambasadorit të Shtabit të Përgjithshëm për draftin e
20 ambasadorit Hill lidhur me këtë zgjidhje, dokument i cili
21 është sekuestruar nga shtëpia e Krasniqit, ku thuhet, theksoj
22 "Asnjë forcë policore nuk do të krijohet në Kosovë e cila nuk
23 është pjesë e policisë ushtarake të UÇK-së".

24 Në 2 dhjetor, Krasniqi dha një urdhër i cili pasqyronte
25 pozitën e Thaçit dhe të Krasniqit siç i kishin thënë

1 përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara se forcat lokale
2 policore do të konsideroheshin serbe dhe se çdo akt i tillë do
3 të ishte akt tradhtie. Komandat e zonave ushtarake të Ushtrisë
4 Çlirimtare të Kosovës janë udhëzuar që të lëshojnë urdhra
5 policisë ushtarake që të arrestonte të gjithë këta që duke
6 treguar besnikëri pushtuesit, vishnin edhe uniformat e
7 policisë serbe, theksoj, "duke bërë në këtë mënyrë një akt
8 tradhtie ndaj popullit shqiptar".

9 Mbrojtja e Krasniqit argumenton në paragrafët 542, 548 të
10 dosjes së tyre se ky urdhër nuk kishte të bënte me propozimin
11 e Hillit për shkak se ai nuk mund të kujtonte asnjë aspekt të
12 këtij plani lidhur me policinë ushtarake dhe se propozimi i
13 Hillit në fakt nuk është zbatuar asnjëherë për shkak se është
14 tejkaluar nga Rambujeja dhe se urdhri i Krasniqit i 2
15 dhjetorit, në fakt, "ka të bëjë thjesht me luftëtarët të cilët
16 kanë marrë pjesë në këto luftime".

17 Plani i Hillit kishte të bënte me -- është irelevant për
18 sa i përket përpjekjeve të bëra për ta mbajtur atë për t'i
19 dhënë vëmendjen e duhur. Më e rëndësishmja është se Hilli dha
20 dëshmi se pavarësisht se nuk i kujtohej një element i këtij
21 plani, ai ishte "i sigurtë" se policia ishte pjesë e tij, i
22 kujtohej atij se bëhej fjalë për një "Kosovë autonome" dhe se
23 kishte shqetësim kur ne folëm "lidhur me policinë ushtarake
24 dhe organizimin dhe kontrollin e ushtrisë së Kosovë". Duke
25 theksuar se "këta njerëz nuk besonin në pavarësinë e plotë".

1 Dhe dëshmia e Hillit konfirmon edhe se asaj që kemi thënë
2 më herët dhe e kemi bërë të qartë se ishte shqetësimi i UÇK-së
3 lidhur me policinë ushtarake dhe e cila përbënte edhe një
4 kërcënim ndaj pavarësisë në favor të autonomisë.

5 Është absolutisht e qartë që mungesa e mbështetjes, dhe
6 është e nevojshme gjithashtu që të theksohet kjo edhe për
7 komandantët e zonave është që policia lokale janë njerëz të
8 cilët janë zgjedhur që të bëhen pjesë e "një zgjedhjeje dhe që
9 jo domosdoshmërisht parashikon pavarësinë".

10 Urdhri i 2 dhjetorit i z. Krasniqi është zbatuar në
11 mënyrë agresive.

12 Dua t'i them Sekretarit këtu se dy diapozitivat e radhës
13 nuk janë për transmetim për publikun.

14 Të nderuar Gjykatës, sot po flitet për një raport me datë
15 9 mars të vitit 1999 nga sektori i zbulim-kundërzbulimit i
16 zonës operative të Dukagjinit. Këtu renditen mbi 200
17 bashkëpunëtorë të dyshuar të pretenduar, përfshi këtu edhe 40
18 "oficerë policie lokale". Njëri prej tyre është ky personi të
19 cilin mund ta shikoni në ekran, emri jepet në ekran.

20 Dhe gjithashtu mos e transmetoni as këtë, ju lutem.

21 Në një operacion të 25 marsit ku përfshiheshin përpjekje
22 të koordinuara të zbulim-kundërzbulimit dhe policisë, i njëjti
23 person u arrestua në orën 3.00 të mëngjesit dhe dha dëshmi për
24 të gjitha llojet e gjërave, përfshi këtu edhe "informacion
25 lidhur me pesë policë të tjerë lokale". Tani duke iu referuar

1 raportit të shkruar të sektorit të zbulim-kundërzbulimit ai
2 thotë, dhe këtu citoj, që ai "ka në posedim regjistrin e
3 oficerit të policisë. Personi në fjalë u ekzekutua nga Brigada
4 132 më 25 mars 1999. Ndërkohë trupi i tij është varrosur në
5 ..."

6 Në orën 3.00 të mëngjesit ka ndodhur një varrim shumë i
7 shpejtë i personit në fjalë.

8 Ndërkohë mund të shikoni gjithashtu edhe një raport
9 tjetër të zbulim-kundërzbulimit në atë kohë për të reflektuar
10 më tej lidhur me vëmendjen kryesore të policisë lokale, që
11 është një raport i zbulim-kundërzbulimit i marsit që shpreh
12 shqetësime lidhur me rrjedhjen e informacionit sa i takon
13 arrestimeve dhe ekzekutimeve të UÇK-së. E kam fjalën
14 konkretisht për provën P03195.

15 Shënimet e z. Selimi tregojnë një takim të organizuar më
16 herët atë muaj në komandën e zonës së Dukagjinit gjatë të
17 cilit u diskutuan zhvillimet kryesore si dhe situata politike.
18 Gjithashtu, u diskutua për statusin e policisë ushtarake dhe
19 të sektorit të zbulim-kundërzbulimit, si dhe pjesëmarrësit
20 ishin të vendosur që "niveli i inteligjencës dhe zbulim-
21 kundërzbulimit funksionin në nivel të kënaqshëm". Në veçanti,
22 u diskutua për "të dhënat e policëve lokalë". Kjo jepet më
23 konkretisht në provën P3206.

24 Ne përpara një çasti pamë provën, që ishte raporti i
25 zbulim-kundërzbulimit i Dukagjinit që kishte të bënte me

1 bashkëpunëtorët dhe ku përmendeshin rreth 40 persona të
2 ndryshëm që konsideroheshin si bashkëpunëtorë të policisë
3 lokale në zona të ndryshme. Ky është një dokument i cili është
4 sekuestruar nga shtëpia e z. Selimi.

5 Të nderuar Gjykatës, ju mund të shikoni dhe dokumente të
6 tjera si, për shembull, zbatimi i urdhrit të 2 dhjetorit në
7 Bob në fillim që marsit të vitit 1999, ku të ndaluarit ishin
8 arrestuar dhe ishin keqtrajtuar sepse mendohej që të ishin
9 policë lokale. Këtë mund ta gjeni konkretisht në paragrafin
10 1018 të dosjes tonë.

11 Sikurse u shpjegua gjatë fjalës time, të nderuar
12 Gjykatës, qëllimi i përbashkët edhe angazhimi i të akuzuarve
13 lidhur me këtë qëllim të përbashkët është bërë i qartë herë
14 pas here gjatë gjithë 1998-s.

15 Tani dëshiroj që t'i jap fjalën znj. Lawson që të
16 vazhdojë me manifestimet e këtij qëllimi të përbashkët gjatë
17 vitit 1999.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
19 z. Tieger.

20 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sapo dëgjuat lidhur me zhvillimet
21 e politikës së oponentëve e artikuluar haptazi dhe e zbatuar
22 gjerësisht, politikë kjo e ndjekur nga anëtarët e NKP-së.

23 Në tetor të 1998-s, kontaktet me aktorët ndërkombëtarë
24 ishin rritur, KVM po vendosej në terren dhe mundësia e
25 negociatave të mundësuar nga ndërkombëtarët po bëhej

gjithmonë e më tepër e prekshme. Sikurse u aludua edhe nga z. Tieger, kjo çoi në shqyrtim më të thelluar. Nuk ka pikë dyshimi se si rezultat lidershipi i UÇK-së u mundua që ta paraqiste veten në një dritë më të favorshme ndaj komunitetit ndërkombëtar, pasi po përpiquej që të njihej si faktori vendimtar në Kosovë dhe të udhëhiqte negociatat të gjitha në qoftë se do ishte e mundur. Megjithatë, kur flitet për shenjëstrimin e vazhduar të oponentëve dhe krimet pasuese nuk ka pikë dyshimi se kjo ishte një lustër e hollë pretendimi pasi anëtarët e NKP-së thjesht po përpiqeshin që të fshihnin dhe të linin pa parë atë çfarë po bënin. Kjo demonstrohet në mënyrë të shumtë në të gjitha provat, megjithatë ne mund të fillojmë me sjelljen dhe me vetë fjalët e z. Thaçi.

Për këtë dua që të mbështetem në provat që janë cituar në paragrafët 951 deri në 953 të dosjes tonë.

Më datën 8 nëntor 1998, Thaçi, i shoqëruar nga Limaj, u takua me përfaqësues të *The Human Right Watch* dhe pretendoi që dy të ndaluar, arrestimi i të cilëve kishte tërhequr shumë vëmendje të publikut ishin gjykuar - në mungesë dhe pa përfaqësim ligjor, pra, pa avokatë - dhe tani po vuanin një vendim dënimi me burg. Kur u këshilluan që të ndaluarit duhej të liroheshin edhe kur u tha që masa duhet të merreshin, *The Human Right Watch* nuk mund të ndërhynte me procesin gjyqësor, domethënë, kjo është ajo çfarë tha Thaçi dhe nuk ishte e mundur që "autoritetet civile gjyqësore" të mund të

1 ndikoheshin prej tyre. Kjo pasqyrohet në transkript në faqen
2 7323.

3 Ky është një takim i cili u pasua më pas nga një njoftim
4 për shtyp nga drejtoria e policisë ushtarake e UÇK-së që
5 konfirmoi arrestimin nga një drejtori e drejtësisë e UÇK-së që
6 përmbante vendimet e synuara të fajësisë së gjykatës ushtarake
7 të UÇK-së. Në fund kur këta të ndaluar u liruan në pajtim me
8 një "amnistie" të supozuar që koïncidonte me Ditën e Flamurit,
9 kjo jepet në Komunikatën numër 63 të Shtabit të Përgjithshëm e
10 cila po ashtu njoftoi lirimën e këtyre personave, UÇK-ja tha
11 që i njihte konventat ndërkombëtare edhe që e respektonte
12 komunitetin ndërkombëtar.

13 Përpjekjet e Mbrojtja për të hedhur dyshim mbi
14 autenticitetin e deklaratave publike të lëshuar në emër të
15 policisë ushtarake dhe drejtorive të drejtësisë - veçanërisht
16 mbi bazën që nuk ka pasur drejtori të tilla formale - nuk janë
17 bindëse. Por e kundërta është e vërtetë sepse këto janë
18 deklarata për shtyp të cilat në atë kohë kanë trajtuar njohuri
19 faktike përfshirë këtu dhe të akuzuar të caktuar, njohurinë e
20 këtyre të akuzuarve sa i takon ngjarjeve që po ndodhnin,
21 përfshirë këtu edhe një delegacion parlamentar të nivelit të
22 lartë në Qirez dhe ndalimin e individëve të mbajtur në
23 Sedllarë.

24 Dhe, për shembull, duke marrë parasysh njoftimin për
25 shtyp të policisë ushtarake, që është prova P00270.10, që u

1 botua në Kohën Ditore në të njëjtën faqe me Deklaratën
2 Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së numër 16, gjë e
3 cila ka ndodhur me koincidencë, jepet një version me shkrim
4 dore i njoftimit për shtyp i të njëjtës drejtorie të policisë
5 ushtarake që është sekuestruar nga shtëpia e Jakup Krasniqit,
6 që është prova P00586.

7 Gjithashtu, sa i takon njoftimit për shtyp së drejtorisë
8 së drejtësisë, që është P00378, jo vetëm që Fatmir Limaj, një
9 i diplomuar në juridik, në atë kohë është prezantuar si
10 drejtor ose si udhëheqës i drejtorisë gjyqësore të UÇK-së, i
11 është prezantuar kështu *The Human Right Watch*, në të njëjtën
12 kohë nga shtëpia e Jakup Krasniqit është sekuestruar një
13 vendim i drejtorisë gjyqësore që ka të bëjë me këta dy persona
14 të ndaluar në të njëjtin vend. Më konkretisht mund t'i
15 referoheni provës P01250.

16 Ndërkohë, sikurse është përshkruar, gjykimi i synuar i dy
17 të ndaluarve në këtë takim nuk i përmbushi standardet
18 ndërkombëtare të zbatueshme, ideja që nuk ka pasur -- që ka
19 pasur një gjykim përpara një gjykate të tillë, e thënë troç,
20 është thjesht një gënjeshtër.

21 Siç ka thënë dhe Thaçi vetë përpara TPNJ-së në vitin
22 2004, ai e dinte që në realitet të ndaluarit nuk ishin dënuar
23 nga një gjykatë. Dhe në intervistën që i ka dhënë më pas ZPS-
24 së, një pjesë të së cilës mund ta shikoni dhe në ekran tani,
25 kur është pyetur konkretisht lidhur me këtë incident, Thaçi ka

1 konfirmuar që UÇK-ja nuk ka pasur as proces juridik as
2 mekanizëm juridik e as gjyq dhe ka theksuar që "ky është
3 trillim". Deklaratat e dhëna nga Thaçi dhe nga Limaj në atë
4 takim me *The Human Right Watch* ishin gënjeshtër të pastra, gjë
5 e cila mbështetet nga shumë dëshmi të tjera të cilat në të
6 njëjtën mënyrë konfirmojnë që në atë kohë nuk ka ekzistuar
7 asnjë gjykatë e UÇK-së. Kjo, mund të gjendet në paragrafët 66,
8 246 dhe 953 të dosjes tonë.

9 Gjithashtu, në zonën e Llapit kur anëtarë të OSBE-së janë
10 takuar me të ndaluar në fillim të shkurtit të 1999-s ose më
11 saktë kur kërkuan që të takoheshin me të ndaluar, ata u takuan
12 vetëm me një numër të vogël të personave që ishin zgjedhur
13 paraprakisht dhe që dukeshin të shëndetshëm dhe që ishin
14 lejuar të pastroheshin para sesa të takoheshin me OSBE-në dhe
15 ishin udhëzuar se çfarë të thonin. Komandanti i policisë
16 ushtarake shpjegoi mbështetjen e procesit të gjykimit për të
17 ndaluarit dhe këtë ua shpjegoi përfaqësuesve të OSBE-së në
18 hollësi. Edhe kësaj here bëhet fjalë për një shpjegim fals të
19 realitetit për të qetësuar ose për të kënaqur komunitetin
20 ndërkombëtar. Një komandant zone, z. Rustem Mustafa ka dhënë
21 dëshmi përpara Trupit Gjykses dhe ai i tha Trupit Gjykses,
22 "nuk ka pasur asnjë lloj procesi" për të ndaluarit e personave
23 në zonën e Llapit. Ata thjesht janë ndaluar. Pra, kjo është
24 dhënë në transkript në faqen 5572 deri 5573.

25 Një gënjeshtër e tillë jo vetëm synim dhe njohuri po

1 gjithashtu demonstroi edhe hapa aktivë të ndërmarra në mënyrë
2 të tillë që të çorientoheshin aktorët ndërkombëtarë, diçka të
3 cilën edhe ekipet e Mbrojtjes e kishin të vështirë që ta
4 thonin dhe ta vërtetonin ndryshe. Ajo çfarë është e
5 rëndësishme është që të theksohet që kjo pasqyron miratimin e
6 krimeve duke dhënë mbulim për vazhdimin e tyre.

7 Dhe sikurse përshkruhet në paragrafin 66 të dosjes tonë,
8 në fund të vitit 1998, u themelua sektori ligjor dhe gjykata
9 ushtarake, gjë e cila u motivua kryesisht nga nevoja për
10 lidhshmërinë e UÇK për të legjitimuar veten përpara komunitetit
11 ndërkombëtar. Gjykata nuk kishte burimet e nevojshme dhe ishte
12 joefektive, një pikë e cila duket sikur ka pajtueshmëri
13 ndërmjet palëve. Megjithatë, gjykata dhe Dobruna vetë janë
14 marginalizuar dhe janë minuar. Anëtarë të Shtabit të
15 Përgjithshëm, përfshirë Selimin dhe Limajn, kanë ndërhyrë në
16 mënyrë të drejtpërdrejtë duke liruar ose duke fshehur të
17 ndaluar ose ndryshe duke anashkaluar tërësisht punën e
18 gjykatës. Ato procese gjyqësore të cilët kanë ndodhur kanë
19 qenë të shkurtuar dhe arbitrare, gjykata ka vendosur vendime
20 për vdekje edhe këto janë vendime të cilat ose janë mbështetur
21 në marrëdhëniet personale dhe aktgjykimet në vetvete janë
22 nënshkruar nga persona të cilët nuk ishin pjesë e gjykatës,
23 përfshirë këtu persona që ishin pjesë e Shtabit të
24 Përgjithshëm.

25 Megjithatë, duke marrë parasysh burimet e kufizuara që

1 kishte gjykata, ajo nuk ka bërë asnjë hetim për sa i takon
2 rrëmbimeve dhe keqtrajttimeve, si dhe vrasjeve që kanë ndodhur
3 deri në atë pikë. Në vend të kësaj, një ndër çështjet e sjella
4 përpara gjykatës në janar të 1999-s dhe që mund të thuhet
5 lirisht që ishte një prej çështjeve më të rëndësishme dhe të
6 pakta të cilat janë sjellë përpara kësaj gjykate ishte çështje
7 e Blerim Kuqit, i cili u arrestua në selinë e Shtabit të
8 Përgjithshëm në prani të Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe
9 Fatmir Limajt. Gjatë një bisede një ditë më pas, Krasniqi e
10 pranoi që Kuqi ishte arrestuar dhe po ashtu kërcënoi që
11 gjithkush që nuk respektonte programin e UÇK-së do të
12 ndëshkohej duke paralajmëruar se dhe këtu citoj, "të gjitha
13 tendencat, sabotazhet e pacifizmit dhe korrupsioni i
14 kompetencës dhe cenimi i kompetencës ose i fuqisë së UÇK-së do
15 t'i ndërpritej korda". Kjo jepet në provën P02094.

16 Një dokument i sekuestruar nga shtëpia e z. Krasniqi që
17 ka titullin "Lëvizjet pacifiste dhe farkiste për minimin e
18 UÇK-së dhe objektivat e saj për sigurimin e çlirimit e përmend
19 Kuqin në këtë mënyrë, citoj:

20 "Grushti më i rëndë që i është dhënë luftës tonë është
21 dhënë, pikësëpari, përmes bllokimit të mjeteve monetare,
22 parave të gatshme që ne na nevojiten dhe së dyti përmes futjes
23 së oficerëve farkistëve që janë bërë pjesë jo për të
24 profesionalizuar dhe për të ndihmuar UÇK-në po për të minuar
25 luftën tonë për liri. Dhe poshtë do të jap prova të kësaj:

1 Tahir Zemaj në Dukagjin, Blerim Kuqi në zonën e Pashtrikut dhe
2 në zonën e Drenicës Kemajl Shaqiri dhe Gani Geci po ashtu".

3 Dhe këto jepen në provën P01111.

4 Pas një gjoja gjykimi në një proces që e përfshinte
5 Mbrojtja e pretendimeve UÇK-ja dhe qeveria duhet të jenë të
6 bashkuar, ndërkohë që Kuqi mori vendimin me vdekje nga
7 gjykata. Sikurse reflektohet në dokumentet e asaj kohe, fate
8 të njëjta ishin planifikuar edhe për oponentë të tjerë, këta
9 ishin oponentë të cilët synoheshin që të silleshin përpara
10 pseudogjykatës me akuza për tradhti, këto janë referenca të
11 cilat ju mund t'i gjeni në poshtëshënimin 244 të dosjes tonë.
12 Si e tillë, gjykata në të njëjtën kohë shërbeu si një fshehës
13 për të vendosur një shtresë false për të fshehur
14 legjitimitetin dhe nga ana tjetër është përdorur nga anëtarët
15 e NKP-së si një instrument i mëtejshëm për t'u përdorur kundër
16 oponentëve.

17 Gjykata është mbështetur gjithashtu te referimi i
18 çështjeve përpara saj, në veçanti nga policia ushtarake ose
19 nga sektori i zbulim-kundërzbulimit, paragrafët 251 dhe 264 të
20 dosjes tonë. Absurditeti me të cilin është aplikuar kjo jepet
21 ose mund të shpjegohet, të ilustruhet nga çështja e vëllezërve
22 Salevic, rrëmbimi i të cilëve tërhoqi vëmendjen e
23 ndërkombëtarëve. Të dy vëllezërit u rrahën nga UÇK-ja në
24 vendin e ndalimit dhe njëri prej tyre vdiq. Sokol Dobruna
25 shkoi personalisht në vendin e ndalimit dhe e diskutoi rastin

1 me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm, po pavarësisht
2 kësaj nuk siguroi fillimin e hetimit për këtë aspekt dhe
3 thjesht injoroi provat e drejtpërdrejta që kishte përpara mbi
4 bazën që përpara tij nuk ishte dërguar asnjë pretendim penal.

5 Si Blerim Kuqi dhe vëllezërit Savelic u ndaluan në një
6 vend në mes të fshatit të Kleçkës dhe fshatit të Divjakës ku e
7 kishte selinë Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Nga fundi i
8 1998-s deri në 22 qershor 1999, ky vend shërbeu si objekti i
9 ndalimit i caktuar nga Shtabi i Përgjithshëm dhe menaxhohej
10 nga policia ushtarake. Të ndaluarit, që përfshinin si serbë
11 dhe shqiptarë, janë mbajtur për periudha të ndryshme nga disa
12 ditë deri në disa javë. Sikurse përshkruhet në paragrafët 974
13 të dosjes tonë, të ndaluarit janë rrahur brutalisht, duke
14 përfshirë këtu edhe nga Rexhep Selimi. Ndërkohë që 11 të
15 ndaluar janë vrarë.

16 Një prej këtyre viktimave ishte Ymer Xhafiqi. Ai punonte
17 për zyrën e dokumenteve dhe perceptohej që ishte bashkëpunëtor
18 i armikut dhe ai u rrëmbye nga persona me uniforma të zeza më
19 9 mars. Duke pasur parasysh funksionet aktuale të Xhafiqit si
20 dhe duke marrë parasysh edhe rrethanat e arrestimit të tij dhe
21 arsyet e dhëna për këtë, është e qartë që personi ishte vetëm
22 thjesht një punonjës civil i cili nuk kishte asnjëfarë
23 përfshirje në luftime dhe pavarësisht kësaj ai u mor apo u
24 perceptua si bashkëpunëtor. Megjithëse nuk ka asnjë indikacion
25 që ndalimi i tij ishte i nevojshëm absolutisht për arsye

1 sigurie.

2 Douglas Young, përfaqësuesi i KVM-së, u informua për
3 arrestimin e Xhafiqit atë ditë që ndodhi arrestimi dhe mori
4 hapa të menjëhershëm për të gjetur se ku ishte ai. Sikurse
5 thuhet në dëshminë e tij dhe sikurse pasqyrohet prej tij, ai
6 mori informacion që Xhafiqi mbahej nga UÇK-ja, pasi iu treguan
7 dokumentet e Xhafiqit dhe pasi u informua nga një person që u
8 prezantua si "Dhjetëshi", me nofkën e Rexhep Selimit, Xhafiqi
9 u identifikua që ishte nën kontrollin e një "formacioni të
10 lartë". Në fakt, Young ishte një prej dy dëshmitarëve që kanë
11 dhënë dëshmi përpara kësaj Gjykate lidhur me njohurinë e
12 Selimit për rrëmbimin e tij.

13 Sikurse jepet në hollësi në pjesë të tjera të dosjes
14 sonë, përveç Krasniqit, Selimit dhe Dobrunës, kishte dhe
15 persona të tjerë të cilët kishin njohuri të drejtpërdrejtë
16 dhe/ose ishin të përfshirë në vendin e ndalimit në Kleçkë dhe
17 këta persona përfshinin Veselin dhe Limajn si dhe të paktën
18 pesë anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm.

19 Krijimi i gjykatës, sikurse është përmendur më herët, ka
20 shërbyer edhe si funksion shtesë i UÇK-së dhe kjo ishte pjesë
21 e rritjes dhe ngritjes së kapaciteteve të cilat do të rrisnin
22 më shumë autoritetin dhe kontrollin e saj. Në Deklaratën
23 Politike 17 që ju e keni në ekran tani - dhe në qoftë se nuk e
24 kam thënë më përpara dua të them që të gjitha diapozitivat që
25 do të tregoj mund të tregohen për publikun - pra, kjo është

1 një deklaratë e cila është lëshuar në nëntor të 1998-s. Në të
2 nënvijëzoheshin tema të njohura, duke përfshirë që asnjë
3 vendim në Kosovë nuk mund të bëhej pa UÇK-në, se UÇK-ja nuk
4 njihte asnjë marrëveshje që do të merrej pa pjesëmarrjen e saj
5 aktive dhe se të tjerët që ishin të gatshëm që të
6 përfshiheshin në negociata do të dënoheshin dhe, citoj,
7 "mbështetësit e autonomisë dhe institucionalistët" janë
8 përshkruar si dhe prapë citoj, "ish-anëtarë të UDB-së të
9 caktuar për poste ministeriale".

10 Dhe se deklarata bëri këtë deklaratë sa i takon
11 autoritetit:

12 "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së dëshiron që t'i kujtojë
13 të gjithëve që Kosova ka institucionet e veta, ka udhëheqësinë
14 e saj politike, ka organet e veta të drejtësisë, ka ushtrinë e
15 saj dhe forcat e policisë të cilët kanë fituar legjitimitetin
16 e tyre organeve kombëtare dhe ndërkombëtare."

17 Më 18 janar 1999, u lëshua një deklaratë publike, tani
18 mund të shikoni një fragment të kësaj deklarate publike në
19 ekran dhe kjo është një deklaratë e cila është lëshuar
20 specifikisht në emrin e z. Thaçi si shefi i drejtorisë
21 politike dhe konfirmoi që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së po
22 ndërtonte institucionet shtetërore. Në deklaratë vazhdohej që
23 të flitej keq për Bukoshin në përpjekje për të minuar
24 institucionet paralele të lidhura me LDK-në. Siç mund të
25 shikohet nga dokumenti, Bukoshi akuzohet dhe Thaçi thotë dhe

1 këtui citoj, "Bukoshi ka financuar vrasjen dhe orvatjet për
2 vrasje të komandantëve të UÇK-së. Në dosjen e tij përfshihen
3 plane për likuidimin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe
4 disa personaliteteve të njohura në Kosovë".

5 Ndërkohë që marrëveshja për krijimin e Qeverisë së
6 Përkohshme të Kosovës, e nënshkruar në Rambuje më 23 shkurt
7 1999, në të vërtetë parashikonte pjesëmarrjen e LDK-së, që një
8 gjë e tillë ndodhi në pretendimet dhe në klimën e përshkruar
9 më sipër.

10 Kishte dhe prova të tjera të cilat kontestualizonin
11 kushtet e pjesëmarrjes së UÇK-së dhe kushteve që i vendoste
12 UÇK-ja dhe kjo në vetvete regjistrohet shumë qartë me fjalët e
13 vetë Krasniqit, që mund ta shikoni në ekran tani. Në negociata
14 me përfaqësues të qeverisë Bukoshi, që ka ndodhur diku nga
15 fundi i marsit 1999, Krasniqi i kishte bërë të qarta kushtet
16 për pjesëmarrje, ai përshkruan si më poshtë:

17 "Në fund unë i dorëzoja atij disa kërkesa dhe ai më tha
18 që këto kërkesa do i vlerësonte me kujdes. Këto kërkesa janë
19 si më poshtë:

20 "a) të njihet programi i UÇK-së,

21 "b) të njihet Qeveria e Përkohshme e Kosovës dhe të
22 respektohet komanda e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së,

23 "c) të respektohen rregulloret e UÇK-së,

24 "d) të futemi në Kosovë, dhe

25 "e) selia e tij në Tiranë t'i dorëzohej ministrisë së

1 mbrojtjes së Qeverisë së Përkohshme të Kosovës".

2 Sa i takon seksionit II.A.1.a.ii të dosjes, përpara
3 marrëveshjes së krijimit për Qeverinë e Përkohshme të Kosovës,
4 pra, përpara sesa të nënshkruhej kjo marrëveshje, lidershipi i
5 UÇK-së kishte marrë hapa për të krijuar institucione
6 qeveritare dhe administrative me synimin e shprehur që ato të
7 përbënin ose "të hidhnin themelin e shtetit të ardhshëm". Kjo
8 jepet në P811.32.

9 Duke qenë kështu, Thaçi në mënyrë efektive përdori
10 marrëveshjen e 23 shkurtit si një element në të cilin të
11 manifestonte institucionet e kompetencës dhe lidershipit të
12 UÇK-së dhe për të thënë që këto institucione dhe lidershipi i
13 UÇK-së po ndiqeshin. Në deklaratën 34 të botuar në 30 mars
14 1999, deklarohet si më poshtë:

15 "Të nderuar bashkatdhetarë, në Kosovë ekzistojnë dy
16 institucione: Qeveria e Përkohshme me Hashim Thaçin si
17 kryeministër dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës që drejtohet nga
18 shtabi i vet i përgjithshëm. Të tjerët, Bukoshi dhe Bicaç, që
19 janë jashtë vendit dhe dalin në emër të këtyre institucioneve,
20 janë mashtrues dhe kriminelë lufte."

21 Këtë mund ta gjeni në provën 575.

22 Disa ditë më pas, Thaçi vijoi më tej dhe bëri të ditur
23 përbërjen e Qeverisë së Përkohshme. Kjo shpallje publike
24 tregonte se kishte një vend vakant për LDK-në, kishte emëruar
25 katër anëtarë të LBD-së, kishte lënë një post të lirë për LBD-

1 në dhe i kishte caktuar të gjitha postet e tjera për
2 udhëheqjen e UÇK-së, përfshirë mes të cilëve anëtarë e NKP-së
3 në pozicione kyçe ministrore. Selimi u bë ministër i rendit
4 publik edhe kontrollonte policinë, Veseli u bë kreu i SHIK-ut
5 që do të thotë se vazhdonte me funksionin e zbulimit, Azem
6 Syla ministër i mbrojtjes, ndërsa Krasniqi vazhdoi të
7 përcillte mesazhe në cilësinë e zëdhënësit të qeverisë.

8 Me tërheqjen e forcave serbe pas Marrëveshjes së
9 Kumanovës, të akuzuarit u përpoqën të aktivizonin
10 infrastrukturën institucionale që kishin krijuar për shumë
11 muaj paraprakisht dhe të vendosnin autoritetin e tyre *de facto*
12 në terren. Sikurse përshkruhet në paragrafin 40 të dosjes
13 sonë, njësitet e UÇK-së menjëherë morën në kontroll
14 infrastrukturën më kryesore shtetërore. Në të njëjtën kohë,
15 Thaçi emëroi kryekomunarët e Qeverisë së Përkohshme në të
16 gjithë Kosovën.

17 Që prej takimit të parë me UNMIK-un në qershor të 1999-s,
18 synimet e qeverisë Thaçi ishin të qarta. Siç përshkruhet në
19 paragrafin 41 të dosjes sonë, Thaçi shoqëruar nga Selimi u
20 prezantoi zyrtarëve të UNMIK-ut organigramën e Qeverisë së
21 Përkohshme. Kur informoi se UNMIK-u kishte autoritet ekzekutiv
22 ekskluziv sipas Rezolutës së Sigurisë 1244, përfaqësuesit e
23 UÇK-së iu përgjigjën dhe iu thanë: "Faleminderit për ndihmën
24 tuaj, por tani jemi vetë përgjegjës. Ne kemi krijuar Qeverinë
25 e Përkohshme dhe e drejtojmë ne vetë vendin".

1 Pavarësisht se në mënyrë të vazhdueshme dhe qartazi u
2 paralajmëruan se masat e Qeverisë së Përkohshme mbivendoseshin
3 me mandatin e UNMIK-ut, Thaçi vijoi i vendosur dhe filloi të
4 lëshonte ligje, dekrete me Qeverinë e Përkohshme ku mbulonin
5 qeverisjen civile dhe përpiqej të ekzekutonte kompetenca që
6 nuk i kishte. Në fund të korrikut 1999, Thaçi shpalli se
7 Qeveria Përkohshme kishte arritur "shpërndarje horizontale dhe
8 vertikale të qeverisë" në të gjitha komunat. Këtë mund ta
9 gjeni në provën P4189. Po ashtu Veseli kishte bërë të qartë
10 synimin e vet që do të vazhdonte të operonte si shef i
11 zbulimit edhe pas demilitarizimit.

12 Edhe dëshmitar i Mbrojtjes, James Covey e pranoi se Thaçi
13 i kishte synimet të qarta sa i takon Qeverisë së Përkohshme të
14 Kosovës për administrimin e Kosovës çka ishte në kundërshtim
15 me mandatin e Këshillit të Sigurisë. Këtë mund ta gjeni në
16 transkriptin 27618-27621. Po ashtu bëri të ditur se antipatia
17 kundrejt Kosovës ishte në mospërputhje me procesin tërësisht
18 demokratik dhe pranoi se dhe ai nuk ishte i qartë nëse synimet
19 e vërteta të Thaçit ishin për të pastruar rrugën sa i takon
20 partisë politike që do të drejtonte vendin. Këtë mund ta gjeni
21 në dokumentin, transkriptin 27362-27363.

22 Në fakt, aso kohe z. Covey ka dhënë një përshkrim më të
23 qartë të ngjarjeve ku ka shkruar më konkretisht në vitin 2005
24 se:

25 "Me kalimin e kohës u bë gjithnjë e më e qartë se ky nuk

1 ishte thjesht një argument i acaruar politik. Ekstremistët e
2 UÇK-së do të përdornin çdo mjet në dispozicion për të
3 zëvendësuar Rugovën dhe aparatin e partisë së LDK-së dhe të
4 njiheshin si heronj dhe garantorë të pavarësisë së ardhshme të
5 Kosovës. Luftëtarët e UÇK-së e shihnin krahun ushtarak të LDK-
6 së, FARK-un, thuajse si një forcë armike sikurse dhe forcat e
7 policisë serbe. Edhe gjatë luftës, UÇK-ja e kishte sulmuar
8 FARK-un. Në vakumin që vijoi më pas, fushata e egër e UÇK-së
9 kundër LDK-së vijoi edhe më tej.”

10 Këtë mund ta gjeni në provën P4496.

11 Sqarimi që bëri Covey në dëshminë e tij ku përshkroi çka
12 kishte bërë personeli që shoqëronte lëvizjen e UÇK-së në fakt
13 nuk funksionoi, nuk ishte në favor të të akuzuarve.

14 Provat tregojnë se gjatë gjithë kësaj kohe shenjëstrimi
15 oponentëve vijoi. Edhe pas Kumanovës, policia ushtarake dhe
16 zbulimi vazhduan të bashkëpunonin e të ndalonin e të merrnin
17 në pyetje civilët për pretendime për bashkëpunim. Këtë mund ta
18 gjeni në provën 1097.9, në faqen 18 deri në 20.

19 Në fakt, u lëshua një komunikatë nga Agim Çeku për
20 llogari të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së më 23 qershor
21 1999, ku thuhej se ishin evidentuar tre bashkëpunëtorë të
22 pretenduar bazuar në informatat që kishin marrë prej
23 shërbimeve të zbulimit, dhe dy prej tyre u vranë më pas prej
24 policisë ushtarake dhe thuhej se personi i tretë, i cili ishte
25 arratisur, ishte në kërkim. Këtë mund ta gjeni në provën

1 P1752.

2 Ndonëse në komunikata pretendohej se këto vdekje ishin si
3 rezultat se personat i rezistuan arrestimit, provat tregojnë
4 se një prej viktimave, në fakt, u vra në spital ku e kishin
5 çuar pasi ishte plagosur në sulmin fillestar. Kjo përshkruhet
6 në paragrafin 324 të dosjes sonë. Kjo komunikatë është botuar
7 më pak se 48 orë pasi udhëheqja e UÇK-së e qeverisë, përfshirë
8 Thaçin, Krasniqin dhe Çekun, kishin marrë pjesë në nënshkrimin
9 e marrëveshjes në bazë të së cilës UÇK-ja ndër të tjera ra
10 dakord "të mos sulmonte, ndalonte apo të frikësonte civilët në
11 Kosovë". Këtë mund ta gjeni në provën 1444, paragrafi 10(d).

12 Në fakt, kur mbërriti KFOR-i në qershor të 1999-s,
13 hapësirat për ndalime legjitime nga UÇK-ja, Qeveria e
14 Përkohshme ishin dhe më të kufizuara se më parë. Gjatë kësaj
15 periudhe kohore, vetëm ndalimet për një kohëzgjatje shumë të
16 kufizuar për shkak të kërcënimeve të drejtpërdrejta që nuk
17 mund të trajtoheshin nga KFOR-i lejoheshin në kushte
18 absolutisht të domosdoshme. Provat tregojnë se asnjë nga
19 ndalimet për të cilat ngrenë akuza në këtë periudhë kohore nuk
20 i përmbushin këto kritere dhe ishin të paligjshme.

21 Pavarësisht kësaj, pavarësisht marrëdhënies me
22 ndërkombëtarët, Thaçi vazhdonte kërkonte konsolidim pushteti
23 dhe kontrolli për të dhe strukturat e qeverisë së tij dhe në
24 të njëjtën kohë shmangte, anulonte apo mohonte krimet që
25 kishin ndodhur oponentëve.

1 Për të parë disa shembuj të kësaj që sapo thashë, një
2 kabllogram ku përshkruhet "takim i vështirë" më 29 korrik të
3 1999-s, ku Thaçi e ka mohuar të ketë pasur vepra penale dhe ka
4 thënë që thjesht "po testonin se sa mund të nxiste UNMIK-un
5 dhe KFOR-in të pranonin *fait accompli* të UÇK-së, pra,
6 qeverisjen e UÇK-së", kjo theksohet në paragrafin 45 të dosjes
7 sonë.

8 Një kabllogram i mëpasshëm i 7 gushtit 1999 thekson se
9 "Thaçi ende përpiqet të konsolidojë pushtetin e vet dhe rolin
10 ekzekutiv të UÇK-së në terren". Kjo është në provën 1977.

11 Edhe në nëntor, goxha kohë pas periudhës për të cilën
12 ngrihen akuza, Thaçi përpiqej po ashtu të ushtronte pushtet.
13 Më 15 nëntor 1999, Bernard Kouchner dha këshilla dhe tha se
14 Thaçi i kishte bërë të qarta synimet e veta për të bojkotuar
15 UNMIK-un dhe KFOR-in derisa "të respektonin dëshirat e tij".
16 Të nesërmen Gjenerali Reinhardt, i cili kishte marrë detyrën
17 nga Gjenerali Jackson si komandant i KFOR-it në Kosovë, ka
18 thënë si në vijim, mund ta shihni dhe në ekran teksa po e
19 lexoj:

20 "Thaçi po bojkoton takimin e komitetit sot. Ai nuk pranon
21 të bashkëpunojë dhe kjo tregon që ai nuk respekton
22 institucionet dhe anëtarët e tjerë të komisionit. Po sillet si
23 një fëmijë që nuk është i kënaqur dhe nuk i japin lodrën e
24 preferuar. Lodra që do ai është presidenca e Kosovës dhe
25 udhëheqje të vetme politike nën ombrellën e administratës

1 Kouchner."

2 Në përmbyllje, do të flas për disa nga argumentet më
3 specifike shtesë që lidhen me qëllimin e përbashkët kriminal
4 të cilin e kanë trajtuar Mbrojtja në dosjet e tyre.

5 Së pari, Mbrojtja e Selimit argumenton se objektiva e
6 NKP-së dhe jo vetëm mjetet duhet të jetë qëllim i qartë
7 kriminal. Sidoqoftë, burimet ligjore që kanë cituar në dosjen
8 e tyre janë pikësëpari e kundërta e asaj që duhet të kishte
9 thënë Mbrojtja e Selimit. Për shembull, paragrafi që citohet
10 në rastin prima shpjegon qartë që kriteret për planin e
11 përbashkët të jetë kriminal se "duhet të ketë si objektiv
12 krimin sipas statutit ose pretendimin e krimeve brenda
13 statutit si mjet për të arritur atë objektiv apo qëllim".
14 Sikur është shpjeguar në poshtëshënimin 4 të dosjes tonë, kjo
15 është një pasqyrim fjalë për fjalë i çështjes Tadic.

16 Së dyti, ka pasur objektiv UÇK-ja për pavarësinë në
17 Kosovë por kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë pasur
18 përgjegjësi si anëtarë të NKP-së për të përfituar dhe ushtruar
19 kontroll në Kosovë në mënyrën se si e kemi paraqitur ne në
20 dosjen tonë. Logjika e bën të qartë se pavarësia do të ishte
21 një parakusht për ta pikësëpari që të merrnin kontrollin që
22 dëshironin. Kjo është thjesht logjike dhe është jurisprudenca
23 e mirëvendosur tashmë që një person mund të ketë disa
24 objektiva njëkohësisht. Për shembull, merrni rastin Karadzic,
25 i cili ka marrë pjesë në katër NKP të ndara po që lidheshin me

1 njëra-tjetrën po me objektiva të ndryshme. Dosjet e Mbrojtjes
2 jo vetëm që shpërfillin këtë realitet por në mënyrë të
3 vazhdueshme përpigën të bëjnë dhe dallim mes tyre dhe
4 përfshirë përmes referencave motivimin e të tjerëve.
5 Sidoqoftë, motivimi i ushtarëve të thjeshtë për t'u kyçur në
6 UÇK, sigurisht, nuk përputhet me synimin e të akuzuarve.
7 Dëshmitari W03165, për shembull, është një nga dëshmitarët që
8 është mbështetur për këtë qëllim si nga Mbrojtja e Thaçit dhe
9 e Krasniqit. Se ai personalisht është kyçur në UÇK në mënyrë
10 që të mbronte vendin e tij, megjithatë ai nuk lidhet me akuzën
11 në këtë çështje gjyqësore. Ajo që është me vlerë provuese edhe
12 më e rëndësishme nën dritën e shërbimit të tij, është se më
13 pak se tre muaj më pas babai i tij është marrë nga ushtarë të
14 UÇK-së me veshje të zeza, është vrarë dhe në mënyrë të
15 padrejtë është quajtur tradhtar i vendit.

16 Së treti, në dosjet e Mbrojtjes thuhet që nuk ka prova të
17 drejtpërdrejta për qëllimin e përbashkët kriminal dhe nuk
18 është paraqitur dhe më pas paraqesin shumë argumente se pse
19 nuk duhen marrë parasysh ato që janë thënë. Ne kemi
20 përmbledhur në dosjen tonë edhe sot, gamën e gjerë të
21 rrethanave, të provave rrethanore të drejtpërdrejta që
22 vërtetojnë ekzistencën e një plani të përbashkët. Një kontratë
23 e nënshkruar mes anëtarëve të NKP-së nuk nevojitet
24 domosdoshmërisht për këtë qëllim. Por, në komunikata të shumta
25 publike të asokohe të Shtabit të Përgjithshëm të cilat i kemi

1 përshkruar në pjesën II.A.1 të dosjes tonë janë pranuar për
2 atë që ishin në vetvete edhe janë provë e drejtpërdrejtë e
3 qëllimit të përbashkët kriminal. Nëse deklaratat publike të
4 asaj kohe të zëdhënësit zyrtar të Shtabit të Përgjithshëm
5 pranohen për atë që janë në pamje të parë, atëherë ato janë
6 provë e drejtpërdrejtë e qëllimit të përbashkët kriminal. Nëse
7 dëshmitarët okularë me fjalët e tyre që tregojnë veprimet e të
8 akuzuarve dhe anëtarë të NKP-së për vende të ndryshme të
9 ndalimit pranohen për atë që janë thënë, atëherë këto janë
10 prova të drejtpërdrejta të qëllimit të përbashkët kriminal.
11 Kjo gamë provash konfirmohet me dokumente të tjera të asaj
12 kohe, sa i takon mënyrës se si ishin krijuar strukturat dhe
13 organizatat dhe si ishin përdorur prej të akuzuarve, korniza
14 rregullatore e asaj kohe, mosdëshkimi i krimeve prej
15 anëtarëve të NKP-së edhe praktikës së krimeve për të cilat
16 ngrihen akuza, parashtrimet që janë bërë nuk mund të mohojnë
17 vëllimin e madh të provave që në fakt vërtetojnë ekzistencën e
18 qëllimit të përbashkët penal përtej dyshimit të arsyeshëm.

19 Sa i takon motiveve personale ose kryesve të
20 drejtpërdrejtë, po, ky mund të jetë një element që mund të
21 merret parasysh në mungesë të provave të tjera që lidhin një
22 krim të caktuar me qëllimin e përbashkët. Por ekzistenca
23 thjesht e këtyre motiveve nuk mohon në vetvete qëllimin e
24 përbashkët apo nuk mund të heqë kryerjen e një veprë penale në
25 vetvete. Në fakt, një kryes i drejtpërdrejtë mund të mos e

1 ketë ditur fare qëllimin e përbashkët edhe në fakt duhet bërë
2 një kontrollim përkatës në qoftë se ka një lidhje të
3 mjaftueshme mes kryesit në fjalë dhe anëtarëve të NKP-së. Një
4 listë joshteruese e faktorëve, në fakt, mund të përcaktojë
5 këto lidhje, më konkretisht, ju lutem, shikoni çështjen
6 Krajisnik ku e kemi përshkruar në dosjen tonë në paragrafët
7 1081, 1082.

8 Në fakt, sa i takon këtyre motivimeve personale sidomos
9 dëshmitarëve ndërkombëtarë, sa i takon atmosferës së
10 hakmarrjes në verën e 1999, Mbrojtja përpiqet të kërkojë një
11 argument dhe të thotë që nuk ekzistojnë akuzat për të cilat
12 ngrihen në aktakuzën tonë. Të akuzuarit këtu nuk janë, nuk po
13 gjykohen për vepra penale rutinë që kanë ndodhur gjatë asaj
14 kohe apo për dhunën e përgjithshme apo djegien e shtëpive që
15 ndodhi asaj kohe kundër civilëve serbë. Krimet për të cilat
16 akuzohen janë krimet që i kanë kryer vartësit e të akuzuarve
17 dhe i kanë kryer në vende të ndryshme ndalimi dhe janë në
18 përputhje me politikat që kishin ata ndaj oponentëve.

19 Një nga shembujt që ka përdorur Mbrojtja e Thaçit duke u
20 përpjekur të argumentojë se kryesit nuk ishin vërtetë të UÇK-
21 së është pikërisht rasti i Dëshmitarit W02951 kur thatë se ai
22 hezitonte të thoshte se "UÇK-ja vërtetë luftonte për lirinë",
23 sepse po të ishin vërtetë luftëtarë nuk do t'i kishin bërë
24 atij atë që i bënë. Pra, jo vetëm që ata përpiqen të bëjnë
25 dallim mes luftës së UÇK-së për çlirim dhe dhunës së

1 paligjshme që ka ndodhur ndaj individëve brenda UÇK-së, por
2 nuk ka asnjë lloj peshe në qoftë se i vendosim në kontekstin
3 dhe vendndodhje konkrete ku është keqtrajtuar ky dëshmitar.
4 Siç e kemi thënë në dosjen tonë ka shumë prova, përfshirë
5 evidenca me video të asaj kohe që tregojnë që në fakt kryesit
6 në fakt ishin pikërisht anëtarë të vërtetë të UÇK-së.

7 Po ashtu, të marrim dëshminë e Dëshmitarit W02652 për ta
8 argumentuar se nuk ka ekzistuar praktikë e përgjithshme për të
9 shënjestruar anëtarë të LDK-së, por kjo tregon shtrembërim të
10 provave dhe mospranim të pikave, parashtrimeve që janë bërë.
11 Ftojme Trupin Gjykses të lexojë transkriptin përkatës.
12 Dëshmitari është shumë i qartë kur ka thënë, "UÇK-ja në
13 vetvete" probleme anëtarët e UÇK-së -- por kishte persona
14 brenda UÇK-së që ishin kundër LDK-së dhe janë sjellë keq dhe
15 nuk pranonin se ishin përgjegjës. Dhe kur ju është dhënë
16 mundësia për pyetjet plotësuese të bënin të qartë kush ishin
17 personat në fjalë, dëshmitari ka specifikuar se ishte
18 udhëheqja e UÇK-së në shtabin kryesor që kishte këtë praktikë
19 kundër LDK-së.

20 Gjithashtu, në kundërshtim me teorisë spekuluese që kanë
21 Mbrojtja në dosjet e tyre, për shembull, shikoni dosjen e
22 Thaçit paragrafët 41, 51, dosjen e Krasniqit paragrafët 165,
23 169, pikat faktike dhe juridike përpara Trupit Gjykses nuk
24 kërkojnë një ndarje të incentivave, nxitësve të ndryshëm nga
25 ana e të akuzuarve për të marrë pjesë në qëllimin e përbashkët

1 kriminal. Por, në fakt, faktet dhe sjellja janë të qarta.

2 Sikurse do të flasë më vonë një nga kolegët e mi më me
3 hollësi në prezantimin e vet, të akuzuarit në fakt kanë
4 kontribuar dhe kishin synim të qartë.

5 A ka qenë zgjedhje racionale, a ka qenë në interesin e
6 tyre për ta bërë këtë është diçka që nuk na takon ta vendosim
7 ne.

8 Së fundi, sa i takon lidhur me argumentet për praktikën.
9 Së pari, siç kemi theksuar, praktika e krimeve është një prej
10 shumë faktorëve në këtë çështje gjyqësore që të çon në
11 përfundimin e pashmangshëm që krimet janë kryer për një qëllim
12 të përbashkët. Nuk është baza e vetme apo kryesore për të dalë
13 në këtë përfundim. Sidoqoftë, analiza që i është bërë
14 praktikës nga Mbrojtja e Krasniqit është tërë mangësi si në
15 koncept dhe në interpretim, formon bazën për të dalë në
16 përfundimin që krimet e kryera kanë qenë "masa spontane nga
17 aktorë, individë të pastërvitur", duke shpërfillur tërësisht
18 të gjitha provat më të forta që kemi ne për të vërtetuar
19 pikësëpari të kundërtën. Për shembull, thjesht, për shembull,
20 fakti që krimet nuk kanë ndodhur vetë në vende rastësore por
21 afër ambienteve të ndalimit të UÇK-së që drejtonte UÇK-ja se
22 shumë prej këtyre vendeve kanë qenë zona kryesore dhe shtabe
23 rajonale edhe vetë ka qenë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm
24 i këtyre qendrave të ndalimit se të ndaluarit janë transferuar
25 mes këtyre objekteve në mënyrë të organizuar ku kërkohet

1 pjesëmarrja e një personeli të konsiderueshëm, çfarë kishte të
2 përbashkët ky personel - veçanërisht policia ushtarake dhe
3 anëtarët e zbulimit të përfshirë në këto vepra penale,
4 përfshirja e personelit që ishte i lartë, niveli i lartë
5 komandues edhe të përbashkët kanë po ashtu bazën e ndalimin
6 dhe akuzat që ju janë bërë këtyre personave gjatë marrjeve në
7 pyetje të cilat janë në përputhje me qëllimin e përbashkët për
8 të cilin ne kemi ngritur akuza.

9 Z. Pace do të flasë më vonë për praktikën e përbashkët të
10 krimeve për të cilat ngrihen akuzat.

11 Sidoqoftë, Mbrojtja pretendon se kjo praktikë tregon që,
12 në fakt, Shtabi i Përgjithshëm nuk ka qenë i përfshirë në
13 vepra penale që mbulojnë periudhën mars-tetor 1998. Kjo do të
14 thotë që ata kanë shpërfillur, ndër të tjera, provat që
15 tregojnë përfshirje të drejtpërdrejtë të Shtabit të
16 Përgjithshëm, përfshirë disa nga të akuzuarit edhe kryerjen
17 fizike të këtyre veprave penale.

18 Në fakt, të flasim për Mbrojtjen e Krasniqit e cila
19 mbështetet shumë në çështjen Gbagbo dhe thotë që duhet marrë
20 parasysh. Atje, për dallim nga kjo çështje, krimet ishin kryer
21 kryesisht gjatë demonstratave ose sulmeve që kishin ndodhur në
22 lagje të caktuara, të cilat shpesh e bënë të vështirë për të
23 treguar rrethanat se si kishte ndodhur dhuna dhe gjithashtu
24 janë vepra penale të ndryshme që janë kryer nga grupe dhe
25 persona të shpërndarë.

1 Mbroytja e Thaçit në mënyrë selektive mbështetet në
2 rastin Blagojevic që po ashtu tregon se nuk e ka kuptuar
3 çështjen dhe shpërfill treguesit e shumtë që kemi ne për të
4 vërtetuar se ka pasur qëllim të përbashkët dhe thonë se ka
5 pasur krime, praktikë krimesh, po këto janë krime që nuk janë
6 kryer në mënyrë të orkestruar edhe nuk janë pikërisht krimet
7 për të cilat ngrihen akuzat në këtë çështje gjyqësore dhe nuk
8 ka ndodhur në ambientet e ndalimit, elementët rrethanor të
9 përbashkët të krimeve, për të cilat do të flasë edhe Pace pak
10 më pas, përdorimi i negociatave diplomatike për të rigrupuar
11 forcat, që kjo korrespondon me riorganizimin që ka ndodhur në
12 këto çështje, në çështjen tonë në tetor në rastin e
13 armëpushimit në tetorin e 1998-s, zëvendësimi i anëtarëve të
14 cilët nuk donin të zbatonin planin e përbashkët, që ishin
15 persona me gjykim të pavarur dhe të merrnin persona që u
16 bindeshin për të zbatuar synimet e tyre dhe për t'i rritur ë
17 pas në detyrë këta persona, këtë mund ta gjeni më në hollësi
18 në paragrafin 617 të dosjes sonë, koordinimi mes njësive të
19 tjera të përfshira në arrestime, ndalime dhe marrje në pyetje
20 me mbështetjen e vendimeve, urdhëresave administrative që
21 shërbenin si kornizë ligjore, politike dhe sociale për NKP-në,
22 këtë mund ta gjejme më në hollësi në Pjesën III të dosjes
23 sonë, përfshirë eshë policinë ushtarake, shërbimin e zbulimit
24 dhe transferimin e të ndaluarve nga një vend tek tjetri,
25 deklaratat e anëtarëve të NKP-së që u korrespondojnë sulmeve

1 të mëpasshme apo krimeve që kanë ndodhur në terren, siç
2 përshkruhen në këtë rast, mund t'i gjeni në seksionin II.A.1
3 të dosjes sonë dhe, operacionet klandestine për të fshehur
4 krimet nga vëzhguesit ndërkombëtarë, përfshirë edhe
5 përfshirjen e drejtpërdrejtë të anëtarëve të NKP-së, siç janë
6 rastet kur mohonin trajtimin çnjerëzore në qendra të ndalimit,
7 siç e kemi përshkruar ne në dosjen tonë, po dhe siç fola dhe
8 unë më herët në prezantimin tim.

9 Dhe për këta faktorë unë jam mbështetur në rastin e
10 aktgjykimit Sainovic, Simic, aktgjykim Martic, Krajisnik.

11 Tani do ia jap fjalën z. Pace, i cili do të përshkruajë
12 më tej praktikën e krimeve që kanë ndodhur. Ju faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. PACE: [Përkthim] Mirëdita.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, mund
16 të vazhdoni.

17 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

18 Më parë kolegët e mi sqaruan, përshkruan mënyrën se si të
19 akuzuarit kanë formuluar dhe kanë ndarë qëllimin e përbashkët
20 për të marrë dhe për të ushtruar kontroll në të gjithë Kosovën
21 përmes mjeteve që përfshini frikësimin, keqtrajtimin, kryerjen
22 e dhunës të paligjshme dhe heqjen, largimin e atyre që
23 konsideroheshin kundërshtarë.

24 Do t'i trajtoj manifestimet dhe shfaqjen e këtyre
25 mjeteve, krijimet për të cilat janë ngritur akuzat që kanë

1 ndodhet në/dhe rreth qendrave të ndalimit në Kosovë dhe në
2 pjesë të veriut të Shqipërisë.

3 Secila prej këtyre vendeve të ndalimit përfaqësohet nga
4 një pikë e zezë në hartën që paraqitet në ekran. Këto
5 diapozitiva janë për t'u shfaqur për publikun, përveçse në
6 qoftë se them ndryshe.

7 Vendet që paraqiten në ekran janë vendet ku viktimat në
8 këtë çështje janë persekutuar, burgosur arrestuar në mënyrë
9 ilegale, të paligjshme dhe arbitrare dhe të mbajtur të
10 ndaluar, janë nënshtruar akteve çnjerëzore, trajtimit mizor,
11 torturës, janë zhdukur dhe janë vrarë.

12 Imazhi që kemi ne përpara tani pasqyron dhe përshkruan
13 437 incidente për të cilat janë ngritur akuza të ndalimit të
14 cilat kanë ndodhur midis prillit 1998 dhe gushtit 1999. Secili
15 incident përfaqësohet nga një pikë e ngjyrës blu në afërsi të
16 vendit të ndalimit. Ndërsa numri që kam vënë përfshinë persona
17 të ndaluar ë vende të ndryshme, siç e kemi shënuar në Pjesën A
18 të aktakuzës, ky është numri minimum për sa i takon
19 incidenteve.

20 Pjesa më e madhe e viktimave ishin civilë që nuk merrnin
21 pjesë në konfliktin e armatosur në kohën e arrestimit të tyre.
22 Siç ishte e qartë nga formulimi i qartë i termave të përdorur,
23 neni 14(1)(c) i Ligjit i cili pasqyron nenin e përbashkët 3(1)
24 të Konventës së Gjenevës, zbatohet ndaj të gjithë personave që
25 nuk marrin pjesë aktive në konfliktin e armatosur në të gjitha

1 rrethanat dhe pa asnjë dallim me ndikim negativ. Kjo, për
2 rrjedhje, përfshin anëtarët e ndaluar të forcave kundërshtare
3 dhe anëtarët e vet grupit në fjalë. Lidhur me këtë ju referoj,
4 për shembull, tek paragrafi 711 dhe 722 të aktgjykimit në
5 çështjen Mustafa dhe paragrafi 547 Komitetit të Kryqit të Kuq
6 Ndërkombëtar ndaj Konventës së Parë të Gjenevës.

7 Pikat ngjyrë blu në ekran përfaqësojnë bujq, mësues,
8 biznesmenë, pensionistë. Ata që rrinin me serbët. Ata që
9 kishin punuar apo vazhdonin të punonin në organet, ndërmarrje
10 shtetërore me qëllim që të fitoni lekë, të jetonin në kohë të
11 vështira. Ata që nuk u bashkuan me UÇK-në apo që nuk
12 kontribuan në mënyrë aktive për UÇK-në. Ata që mbështesnin
13 LDK-në. Ata që akuzoheshin si spiunë apo bashkëpunëtorë,
14 shpesh akuzë e bazuar në thashethemet e pabazuar dhe të
15 përgjithshme dhe spekulime. Shqiptarët e Kosovës, serbë, romë,
16 malazezë, boshnjakë, maqedonas. Burra, gra dhe fëmijë.

17 Në fakt, individët, liria e të cilëve iu hoq përmes
18 sjelljes së të akuzuarve vinin nga profesione të ndryshme, por
19 siç e keni lexuar në dosjen tonë. Padyshim, të nderuar
20 Gjykatës dhe siç e keni pranuar dhe i keni vlerësuar provat
21 gjatë gjykimit, ju keni bërë dallimin dhe keni parë se
22 shenjëstrimi dhe keqtrajtimi i këtyre viktimave nga pjesëtarë
23 dhe anëtarë të UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e të
24 akuzuarve bëhej sipas praktikave të ngjashme.

25 Dhe, siç e dëgjuat më herët, kundërshtarët u identifikuan

1 nga pjesëtarë të UÇK-së, përfshirë shërbimet e zbulimit dhe
2 policia ushtarake. Emrat e shumë prej atyre që u arrestuan u
3 mbajtën të ndaluar, u morën në pyetje, u rrahën, u vranë, u
4 zhdukën, mund të gjenden në shënime që janë marrë nga anëtarë
5 të UÇK-së. Këto shënime përmbajnë shpesh hollësi siç janë
6 viktimat e mundshme, lëvizjet e viktimave të mundshme dhe
7 shënime mbi ta, fletë-arrestimet për ta dhe arrestimet e
8 tyre. Për shembull, ju referoj tek prova 75, faqja e cila
9 është në ekran tani që nuk duhet të shfaqet për publikun.

10 Ju do të identifikoni këtu emrat që janë nënvijëzuar dhe
11 vënë në pah nga provat e shumta dhe të gjëra që janë
12 parashtruar në këtë çështje lidhur me shënjestrimin dhe
13 zhdukjen e tyre.

14 Një shembull tjetër është prova 651, faqet e të cilave
15 janë tani në ekran, nuk duhet të shfaqen për publikun. Këtu
16 kemi një shembull, një fletarrestimi për një kundërshtar i
17 cili është ndaluar dhe keqtrajtuar në Jeshkovë. Gjithashtu
18 shënime tregojnë mbikëqyrjen që është bërë lidhur me të
19 njëjtin individ.

20 Disa prej viktimave janë arrestuar në shtëpitë e tyre ose
21 në pika kontrolli, postblloqe nga persona të maskuar dhe të
22 armatosur. Në shumë raste, anëtarë të UÇK-së nuk iu kanë dhënë
23 të ndaluarve ndonjë arsye për arrestimin e tyre, përveç
24 pohimeve të përgjithshme apo akuzave të përgjithshme. Disa u
25 arrestuan pasi u urdhëruan apo u thirrën që të paraqiteshin në

1 shtabet e UÇK-së. Për shembull, siç mund ta shihni urdhrin që
2 është në ekranin tuaj nga prova P1105, që mund të shfaqet
3 publikisht, Jakup Krasniqi, në cilësinë e tij si
4 zëvendëskomandant i Shtabit të Përgjithshëm, urdhëroi anëtarin
5 e UÇK-së, Blerim Kuqi që të paraqitej në Shtab të Përgjithshëm
6 më 16 janar 1999. Në datën që mban ky urdhër, Kuqi u arrestua
7 në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në prani të Krasniqit,
8 Rexhep Selimi dhe Fatmir Limajt. Në paraqitje të mëparshme
9 dëgjuat hollësi lidhur me këtë incident.

10 Siç u përmend më parë, lidhur me raste të ngjashme me
11 këtë ku viktimat ishin anëtarë të forcave të armatosura,
12 përfshirë UÇK-në, ata mbroheshin gjithsesi, pavarësisht kësaj,
13 sipas nenit 14(1) të Ligjit.

14 Si shënim lidhur me këtë, kur bëhet fjalë për vlerësimin
15 nëse një viktimë mbrohej, është aktiviteti i tyre në kohën e
16 kryerjes së krimit që është relevant siç përcaktohet në
17 paragrafin 602 të Komentarit të Konventës IV të Gjenevës i
18 2025-s:

19 "Nuk ka vend për hakmarrje bazuar në ligjin, në të
20 drejtën humanitare ndërkombëtare."

21 Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me statusin e
22 disa viktimave tregojnë një fokusim të gabuar në pozicionet e
23 pozitive të tyre të mëparshme që mund të kenë patur dhe jo në
24 atë që ata kishin dhe mbanin në momentin e arrestimit dhe
25 ndalimit. Disa prej këtyre parashtrimeve ishin thjesht të

1 pasakta dhe keqorientuese.

2 Për shembull, ndërsa Mbrojtja e Thaçit përmend se
3 Dëshmitari W01338 ka punuar për policinë kur ishte -- punonte
4 për policinë kur u rrëmbye, nuk përmendet asgjë lidhur me
5 pozicionin e tij konkret që ishte elektrikist që është
6 vlerësim relevant. Dhe ju ftoj të shikoni për këtë paragrafin
7 1121 në dosjen tonë. Ndërsa Dëshmitari W01605 kishte punuar si
8 oficer policie, ai nuk punonte më në kohën e arrestimit të
9 tij.

10 Pas arrestimit të tyre viktimat u transferuan dhe u
11 mbajtën të ndaluar në vende që përdoreshin nga anëtarë të UÇK-
12 së në shumë raste si shtabe të UÇK-së, zyra, kazerma apo në
13 vende të afërta me to.

14 Në Jabllanicë, të ndaluarit u mbajtën të ndaluar në
15 kazermat dhe tani shihet imazhi i kësaj në ekran. Ky vend
16 ishte, gjendej në afërsi të shtabit të UÇK-së në shtëpinë e
17 Lahi Brahimajt.

18 Të ndaluarit u mbajtën të ndaluar në dhomën që është në
19 anën e majtë të ekranit, të ndaluarit u mbajtën të ndaluar në
20 dy dhoma në shtëpinë që është në anën e djathtë të ekranit që
21 është po ashtu vendi ku Lahi Brahimaj dhe Nazmi Brahimaj morën
22 në pyetje dhe i keqtrajtuuan të ndaluarit.

23 Viktimat në vende të ndryshme u mbajtën të ndaluar për
24 periudha kohore të ndryshme, pra, nga orë, ditë, javë apo muaj
25 të shumtë.

1 Provat shkresore konfirmojnë dëshmitë e dëshmitarëve
2 lidhur me krimet për të cilat janë ngritur akuza, përfshirë
3 edhe kujtimi i tyre i qendrave të ndalimit në bardh e zi.

4 P00738, që është në ekran tani dhe nuk duhet të shfaqet
5 për publikun, është një bllok shënimesh që përmban regjistrin
6 e ndalimeve ku tregohen datat për 52 personave që janë mbajtur
7 të ndaluar në Llapashticë. Siç mund ta shihni në këtë faqe,
8 disa ndalime kanë zgjatur me javë apo muaj. Për shembull,
9 personi nën numrin 9 është mbajtur më shumë se pesë javë i
10 ndaluar. Ndërsa personi i renditur në numrin 8 është mbajtur i
11 ndaluar katër muaj.

12 Të nderuar Gjykatës, ju keni pranuar prova se shumë të
13 ndaluar ishin të kufizuar në lëvizjen e tyre, të lidhur, dhe
14 sytë ju ishin lidhur ndërsa transferoheshin apo mbaheshin të
15 ndaluar. Shumë viktimë janë mbajtur në dhoma të mbyllura me
16 çelës, me roje dhe nuk iu është dhënë ushqim, ujë, qasje në
17 kushte higjiene të përshtatshme apo trajtim mjekësor.

18 Në Barë, një viktimë ka kaluar 20 ditë nga ndalimi i tij
19 56 ditë në një dhomë 2 metër me 2 e errët, pa dritare. Duke
20 përdorur një kuti të vogël si tualet. Ndërsa po kjo viktimë
21 është mbajtur e ndaluar në një vend tjetër, pjesëtarë të UÇK-
22 së i kanë thënë atij që do ta vrisnin atë ndërsa ai ishte i
23 dobët si gishti. Atij iu dha shumë pak ujë apo ushqim gjatë
24 kohës që u mbajt i ndaluar dhe humbi 38 kilogram gjatë kohës
25 së dy muajve të ndalimit të tij.

1 Në Llapushnik, të ndaluarit u mbajten në kushte
2 çnjerëzore, përfshirë në një magazinë dhe në një stallë. Një
3 prej të ndaluarve përshkruan kushtet e ndalimit kaq të ashpra
4 saqë mendoi se vdekja do të kishte qenë opsion më i mirë. Një
5 tjetër i ndaluar vari veten ndërsa mbahej i ndaluar.

6 Në kushtet e vështira në vendet e ndalimit të tyre, të
7 ndaluarit u morën në pyetje shpesh përpara, gjatë dhe pas
8 rrahjes. Ata pyeteshin nëse kishin njohuri apo marrëdhënie me
9 individë të tjerë, përfshirë serbë. Disa prej tyre u udhëzuan
10 që të pranonin krime që nuk kishin kryer. Shumë u akuzuan se
11 ishin spiunë, bashkëpunëtorë apo tradhtarë. Shumë u morën në
12 pyetje apo u kërcënuan lidhur me mbështetjen e tyre apo rolin
13 e tyre në LDK.

14 Rreth datës 24 qershor 1998, në shtabin e UÇK-së në
15 Breshanc, Hashim Thaçi u bëri thirrje deputetëve të Kuvendit
16 të Kosovës Avdyl Ramës dhe Ukë Bytyqit që të jepnin dorëheqjen
17 publikisht nga udhëheqja e LDK-së, nga pozicionet e tyre të
18 udhëheqëse në udhëheqje të LDK-së dhe të jepnin një deklaratë
19 të regjistruar ku mbështesnin UÇK-në. Nën presion Bytyqi
20 pranoi. Rama u kërcënuar dhe u keqtrajtua nga Thaçi kur nuk
21 pranoi kërkesat e Thaçit.

22 Karakterizimi i Mbrojtjes së Thaçit i provave që kanë të
23 bëjnë me rolin e z. Thaçi në këtë incident nuk cenon provat
24 konfirmuese relevante, përfshirë ato mbi të cilat mbështetemi
25 në paragrafët 394, 395 të dosjes tonë.

1 Parashtrimet e Mbrojtjesh së Thaçit lidhur me këtë
2 incident shpërfillin në veçanti fragmentet relevante nga
3 marrja në pyetje e Dëshmitarit W03832, i përmendur, për
4 shembull, në paragrafët 350, 351 të dosjes tonë.

5 Parashtrimet e Mbrojtjes së Thaçit shpërfillin gjithashtu
6 kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të qartë të provave relevante,
7 siç janë ato apo dëshmime siç janë ato të Dëshmitarit W04410,
8 të librit të tij, ku, siç mund ta shihni në ekran ai ka
9 shkruar, për shembull:

10 "Hashim Thaçi këmbënguli që Uka jo vetëm duhej të jepte
11 qëndrime apo mendime të fuqishme dhe vendimtare lidhur me UÇK-
12 në, por ai kishte rezervat e veta. Ai donte të thoshte atë në
13 një mënyrë që të mos imponohej nga dikush tjetër."

14 Rreth dy muaj pas këtij incidenti, Rexhep Selimi ishte i
15 pranishëm dhe mori shënime, ndërsa i ndaluari merrej në pyetje
16 në Likoc. Në përputhje me shembuj të tjerë të ndalimit nga
17 pjesëtarë të UÇK-së, në këtë rast, në prani të Selimit, ky i
18 ndaluar u morr në pyetje lidhur me bashkëpunimin e pretenduar
19 të tij me zyrtarë serbë. I njëjti person i ndaluar u rrah në
20 mënyrë të ashpër dhe të përsëritur në të njëjtin vend ndalimi.

21 Në kohën e ndalimit, e këtij ndalimi në Likoc, Likoci
22 ishte tashmë, përdorej si shtab i Shtabit të Përgjithshëm, si
23 seli e shtabit të përgjithshëm dhe aty mbaheshin, ishin
24 mbajtur dhe mbaheshin takime, mbledhje të Shtabit të
25 Përgjithshëm, të akuzuarit do vizitojnë atë vend dhe do

1 mbaheshin takime ndërkombëtare.

2 Në muajin vijues, në shtator të 1998-s, të dy, Rexhep
3 Selimi dhe Thaçi u përfshinë në një tjetër incident gjatë të
4 cilit të ndaluarit u morën në pyetje dhe u keqtrajtuan. Thaçi
5 dhe Selimi arritën në një zyrë lokale vendore të LDK-së në
6 Qirez ku një delegacion parlamentar i shqiptarëve të Kosovës
7 mbahej i ndaluar nga pjesëtarët e UÇK-së. Selimi dhe të tjerë
8 transferuan 13 anëtarë të delegacionit në një ndërtesë të
9 shkollës e përdorur nga UÇK-ja në Baicë, ku një grup i
10 anëtarëve të maskuar të UÇK-së i rrahën ata në mënyrë të
11 ashpër gjatë të paktën gjashtë prej të ndaluarve.

12 Thaçi pastaj mori në pyetjet të ndaluarit me Sabit Gecin.
13 Thaçi u referua të ndaluarve si rugovistë dhe
14 institucionalistë dhe kërkoi që ata të jepnin dorëheqjen nga
15 pozitat e tyre parlamentare dhe të bënin deklaratë me shkrim
16 ku mohonin Ibrahim Rugovën të cilin do donin ta trajtonin si
17 tradhtar. Thaçit iu tha se të ndaluarit ishin keqtrajtuar dhe
18 ai pa lëndimet e tyre vetë. Thaçi dhe Sabit Geci morën,
19 transferuan të ndaluarit në Krasmirofc ku Geci, në prani të
20 Thaçit kërcënoi që të vriste një viktimë. Dhe Thaçi vetë
21 kërcënoi një tjetër.

22 Përpjekja e Mbrojtjes së Thaçit për të bërë të vlefshme
23 në mënyrë ligjore mbajtjen në ndalim apo ndalimin e
24 delegacionit duke iu referuar kompetencave të ZPS-së për të
25 ndaluar sipas ligjit që rregullon funksionimin e kësaj Gjykate

1 është simptomatike e natyrës jo logjike dhe të palogjikshme të
2 parashtrimeve të Mbrojtjes lidhur me këtë incident. Siç është
3 përcaktuar, për shembull, në vendimin e konfirmimit privimi
4 nga liria i bërë nga pjesëtarët e UÇK-së duhet të justifikohet
5 nga një procedurë penale apo arsye, bazë e arsyeshme për të
6 besuar se ka shqetësime të sigurisë që e bëjnë atë
7 "absolutisht të domosdoshme".

8 Në çështjen Shala, Paneli i Gjykatës, i Dhomës së
9 Gjykatës së Apelit vuri në dukje se në mënyrë që një ndalim të
10 cilësohet apo të pranohet si absolutisht i domosdoshëm duhet
11 të ekzistojnë arsye serioze dhe legjitime për të menduar se
12 një personi në fjalë përmes aktiviteteve, veprimeve të tij,
13 njohurisë apo aftësive të tij përbën një rrezik, kërcënim real
14 të sigurisë së tanishme apo të ardhshme.

15 Përpyjekjet e Mbrojtjes së Thaçit për të interpretuar apo
16 karakterizuar synimet e delegacionit të ndaluar si diçka,
17 ndonjë tjetër sesa ato që ishin humanitare, shpërfill provat e
18 qarta edhe në asnjë mënyrë nuk jep tregues që ndalimi ishte
19 absolutisht i domosdoshëm.

20 Përpyjekjet e Mbrojtjes së Thaçit janë të gabuara pasi
21 pikëpamja e z. Thaçi e pohuar gjatë intervistës me ZPS-në
22 lidhur me statusin e pjesëtarëve të delegacionit bazuar në
23 atë.

24 Kjo është nga prova P00739.8. Për kundër asaj që z. Thaçi
25 pohon këtu, ata që përbënin delegacionin parlamentar të

1 ndaluar në Qirez ish-in civilë. Shtrembërimi nga z. Thaçi i
2 nocionit të luftëtarit është përpjekje e qartë për të
3 justifikuar aktivitetin e tij kriminal.

4 Përkundër qasjeve selektive të Mbrojtjes së Thaçit dhe
5 të Selimit ndaj provave lidhur me incidentin e Qirezit, Trupi
6 Gjykues duhet të marrë parasysh të gjitha provat në tërësi,
7 përfshirë provat shkresore siç janë komunikimi për shtyp i
8 drejtorisë së policisë ushtarake të UÇK-së në P0158.

9 Lidhur me këtë dhe incidente të tjera, Trupi Gjykues mund
10 dhe duhet të mbështetet në tregimet e hollësishme të besueshme
11 dhe që përputhen, të konfirmuara të dëshmitarëve relevantë që
12 kanë dhënë dëshmi në këtë sallë gjyqi.

13 Trupi Gjykues duhet po ashtu në të njëjtën mënyrë dhe të
14 ngjashme të mbështetet në provat e mëhershme të vetë z. Thaçi
15 lidhur me këtë incident dhe jo në përpjekjet e mëvonshme për
16 t'u tërhequr nga e vërteta.

17 Imazhet që paraqitet në ekran tani janë nga intervista e
18 z. Thaçi dhënë ZPS-së në janar të vitit 2020 lidhur me këtë
19 incident. Dhe po lexojmë:

20 "Në atë kohë në Baicë a keni qenë dëshmitar, a keni parë
21 ndonjë plagë, lëndim në z. Dedaj?

22 "Nuk kam parë, por kam dëgjuar që ai kishte, sepse ishte
23 i veshur por nuk kam parë asgjë në fytyrën e tij.

24 "Në atë kohë a e dinit a ishte rrahur ai apo ishte
25 keqtrajtuar?

1 "Po.

2 "Lidhur me z. Dedaj apo me z. Bardhi, si e dinit që ata
3 ishin rrahur apo keqtrajtuar në qoftë se nuk e keni parë këtë
4 gjë?

5 "E kam dëgjuar këtë nga ushtarët e tjerë që ishin të
6 pranishëm aty.

7 "Në atë kohë?

8 "Po, përpara se të shkoja në shkollë në Baicë.

9 "Juve ishit informuar nga ushtarë përpara se të shkonit
10 në Baicë që z. Dedaj dhe z. Bardhi ishin keqtrajtuar?

11 "Po.

12 "Kush thanë ata e kishte bërë këtë rrahje?

13 "Ata më thanë, por unë e verifikova këtë kur shkova aty.
14 Do të flasim për këtë në intervistën e ardhshme."

15 Megjithatë, në intervistën e ardhshme, gjashtë muaj më
16 vonë, versioni i ngjarjeve që dha z. Thaçi ishte në
17 mospërputhje dhe i palogjikshëm, duke pretenduar se lëndimet
18 të cilat kishte përmendur gjashtë muaj më parë ishin morale
19 dhe jo fizike dhe këtu po i referohem provës P00742.3.

20 Përveç nëse ai e kishte fjalën për lëndime fizike nuk
21 asnjë arsye të mundshme pse z. Thaçi në janar të vitit 2020 do
22 t'i ishte referuar një viktime se ishte i veshur, si arsye për
23 të cilën ai nuk kishte parë lëndimet e viktimës. Dhe në të
24 njëjtën mënyrë z. Thaçi nuk do të ishte përgjigjur duke thënë
25 "më thanë ata" kur ai u pyet "kush thanë ata që e kishin bërë

1 rrahjen?".

2 Rreth një muaj pas incidentit të Qirezit, Hashim Thaçi me
3 Fatmir Limajn morën në pyetje dy gazetarë serbë ndërkohë që
4 ishin mbajtur të ndaluar në Sedllarë. Fakti se vetë viktimat
5 nuk ishin në gjendje të identifikonin Thaçin si njëri prej
6 atyre që i mori në pyetje, nuk minon, nuk cenon provat e
7 W04839 i cili interpretoi, përktheu për z. Thaçi gjatë marrjes
8 në pyetje.

9 Në argumentin e saj lidhur me këtë incident, Mbrojtja e
10 Thaçit pohon se W04839 nuk ishte në gjendje të identifikonte
11 natyrën e rolit të Thaçit. Megjithatë, provat që vetë ata
12 citojnë në mbështetje të këtij pohimi tregojnë se dëshmitari e
13 njihte, e dinte se z. Thaçi ishte në departamentin politik.
14 Pavarësisht kësaj, njohuritë konkrete lidhur me rolin e z.
15 Thaçi në UÇK në atë kohë, në kohën e marrjes në pyetje, kjo
16 nuk është relevante sa i takon çështjes nëse ai mori pjesë në
17 këtë marrje në pyetje apo jo.

18 Lidhur me pretendimet e pambështetura e të pabazuara të
19 Mbrojtjes së Thaçit, sa i takon Dëshmitarit W04839,
20 mbështetshmërisë së tij, përfshirë lidhur me këtë incident, ju
21 referoj, të nderuar Gjykatës, tek paragrafi 1441 deri në 1447
22 të dosjes tonë.

23 Kërcënimet dhe marrja në pyetje e të ndaluarve nga
24 anëtarë e UÇK-së ishte në vazhden e kërcënimeve të shprehura
25 përmes komunikatave dhe deklaratave të tjera publike të bëra

1 nga Shtabi i Përgjithshëm dhe anëtarët e tij.

2 Gjatë transferimit të dy viktimave në një qendër ndalimi
3 ku ata do të mbaheshin pastaj të ndaluar pothuajse për një
4 muaj, pjesëtarë të UÇK-së që u prezantuan si nga Shtabi i
5 Përgjithshëm rrahën dy viktima. Dhe ata u thanë atyre që do të
6 dënoheshin me vdekje pasi Ibrahim Rugova ishte tradhtar dhe
7 LDK-ja ishte UDB.

8 Ngjashëm me këtë, gjatë arrestimit dy viktima të tjera,
9 të cilët pastaj do të mbahen të ndaluar në Likoc, ushtarët e
10 UÇK-së iu thanë atyre se ata do të i likuidonin ata sepse
11 ishin me LDK-në, tradhtarë dhe bashkëpunëtorë serbë. Kur u
12 mbajtën të ndaluar në Likoc njëra prej viktimave u akuzua se
13 ishte spiun dhe bashkëpunëtor, pjesëtarë të UÇK-së i thanë
14 atij se do ta vrisnin atë dhe të gjithë ata që mbështesnin
15 Rugovën dhe i kërkuan dhe i pyetën atë pse nuk ishte në anën e
16 Hashim Thaçit.

17 Kërcënime të tilla dhe pyetje të tilla, për shembull, të
18 kësaj gjuhe gjenden në dokumentin që është në ekran. Kjo është
19 Komunikata 21 ku Shtabi i Përgjithshëm kërcënon që do të
20 tregohet i pamëshirshëm kundër pushtuesit dhe tradhtarëve.

21 Komunikata 43, siç e shihni, Shtabi i Përgjithshëm pasi i
22 bën thirrje të gjithë shqiptarëve që janë në gjendje të bëjnë
23 këtë gjë t'i bashkohen UÇK-së duke kërcënuar me vdekje armiqtë
24 dhe tradhtarët.

25 Në provën 287, që është në ekran tani, Komunikata 48,

1 Shtabi i Përgjithshëm bën thirrje "të gjithë forcave politike
2 të arsyeshme" që të distancohen nga "politikat anarkiste,
3 mashtruese, ndarëse ndërkombëtare në emër të institucioneve
4 fiktive në përpjekje për të eliminuar institucionet e vërteta
5 kombëtare dhe UÇK-në e saj".

6 Shtabi i Përgjithshëm dhe thotë:

7 "Çdo veprim që vë në rrezik interesat e atdheut dhe
8 qëllimet e luftës çlirimtare do të dënohet dhe ndëshkohet."

9 Gjuha e përdorur nga anëtarë të UÇK-së gjatë kohës që
10 marrin në pyetje dhe kërcënojnë dëshmitarët paraqitet
11 gjithashtu në gjuhën kërcënuese të përdorur nga Jakup Krasniqi
12 që është në provën që kemi këtu P00809, nga Hashim Thaçi dhe
13 që pasqyrohet në P00387 dhe Rexhep Selimi që pastaj doli gjatë
14 dëshmisë së datës 26 qershor 2024.

15 Një karakteristikë tjetër e ndalimeve të cilat paraqiten
16 në aktakuzë dhe që shfaqet në mënyrë të përsëritur është se të
17 ndaluarve nuk iu dha asnjë garanci për proces të mirëfilltë.

18 Në shumë raste, atyre nuk u jepej as informacioni i
19 përshtatshëm, i duhur, lidhur me arsyen për arrestimin dhe
20 ndalimin e tyre. Atyre nuk iu jepej mundësia që të
21 kundërshtonin arrestimin apo ndalimin e tyre. Ata nuk u
22 paraqitën, nuk u dërguan përpara një gjykatësi apo autoriteti
23 kompetent dhe nuk u akuzuan apo ngarkuan me ndonjë krim apo
24 dënuan.

25 Hashim Thaçi dhe Fatmir Limaj gënjyen lidhur me

1 ekzistencën e procesit të tillë të mirëfilltë, të drejtave për
2 një proces të duhur dhe të drejtë në nëntor të 1998-s, në
3 diskutimin që patën me përfaqësues të *The Human Right Watch*.
4 Por edhe gënjeshtria e tyre se dy gazetarët serbë të cilët
5 mbaheshin të ndaluar ishin gjykuar në mungesë pa patur qasje
6 tek një avokat dhe tani po vuanin dënimin e tyre, tregon
7 mungesën e procesit të duhur.

8 Vite më vonë Thaçi konfirmoi se dhe po citoj, "UÇK-ja nuk
9 kishte proces ligjor apo juridik, mekanizëm të tillë. Kjo
10 është diçka që është shpikur". Ky citim është nga P00742.14.

11 Garancitë e procesit të duhur mungonin edhe kur gjatë
12 marrjes në pyetje në disa vende ku anëtarët e UÇK-së kanë
13 marrë në pyetje persona duke vepruar në cilësi pseudo-
14 gjyqësore.

15 Të nderuar Gjykatës, ky ndoshta është momenti i duhur që
16 të bëjmë pushimin.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Do të bëjmë pushimin e drekës tani. Dhe kthehemi në orën 2.30.

19 Seanca ndërpritet.

20 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.56

21 --- Seanca rifillon në orën 14.30

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, jemi
23 gati që të vazhdoni.

24 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

25 Përpara pushimit, përmenda që garancitë e procesit të

1 rregullt nuk janë zbatuar në rastin kur janë marrë në pyetje
2 të burgosurit në disa vende të paraburgimit.

3 Në rregull është tani?

4 S'jam i sigurtë nëse është problemi tek unë.

5 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e seancës
6 këshillohen]

7 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

8 Përpara pushimit, përmenda që nuk janë zbatuar garancitë
9 e procesit të rregullt kur janë marrë në pyetje të
10 paraburgosurit në disa vende nga ana e anëtarëve të UÇK-së të
11 cilët silleshin sikur kishin funksione, pseudo-funksione
12 gjyqësore.

13 Për shembull, një viktimë iu nënshtrua një gjyqi të
14 tillë, pseudo-gjyqi në selinë e brigadës ku ishte parandaluar.
15 Kur duke e rrahur, i kanë bërë pyetje lidhur me pengimin e
16 luftës dhe me takimet me presidentin Rugova. Më pas e kanë
17 informuar lidhur me një urdhër që do të dërgohet në një zonë
18 operative të cilës i raportonte kjo brigadë.

19 Pas transferimit, i është nënshtruar një pseudo-gjyqi
20 tjetër, këtë herë nën dyshimin, nën të tjera, se ka shpërndarë
21 propagandë kundër UÇK-së. Shtabi i zonës operative e ka marrë
22 në pyetje lidhur me disa tema që kanë të bëjnë me përfshirjen
23 e tij dhe rolin në UÇK. Nuk i është paraqitur asnjë provë dhe
24 nuk ka patur përfaqësim ligjor. Megjithatë, atij iu
25 komunikua se ishte dënuar me burgim prej disa muajsh. Nuk i

1 ishte dhënë as mundësia për të apeluar kundër masës së
2 dënimit.

3 Pohimi në dosjen e Veselit në paragrafin 275, që ky
4 incident ishte thjesht një mosmarrëveshje lokale hidhet poshtë
5 nga provat, përfshirë edhe nga numri i aktorëve të UÇK-së në
6 nivelin e brigadës dhe të zonës siç paraqitet në paragrafët
7 1080 deri 1090 të dosjes sonë. Këto prova përfshijnë dëshminë
8 që është dhënë përpara këtij Trupi Gjykues dhe të vërtetuar me
9 anë të provave të cilat janë pranuar sipas rregullës 153 dhe
10 provave të tjera me shkrim.

11 Detyrimi për të zbatuar dispozitat e nenit të përbashkët
12 3 është automatike dhe absolute për shtetet, për palët e një
13 konflikti të cilat janë shtete apo jo shtete. Megjithatë, në
14 paragrafin 834 të dosjes së tyre, Mbrojtja e Veselit i
15 njoftohet të ashtuquajturit detyrim të zbatuar në proces të
16 rregullt, duke thënë që nuk e pranojnë që ky proces i rregullt
17 do të ekzistojë edhe gjatë një konflikti. Dosja e tyre pohon
18 që ky detyrim do të shihet në kontekstin në të cilin ka
19 operuar, ka vepruar UÇK-ja dhe zhvillimin e saj dhe në këtë
20 mënyrë dhe pritshmëritë do të jenë të tilla. Nuk ka patur
21 citim lidhur me këtë pohim.

22 Analiza e mëtejshme në dosjen e Veselit citon një
23 poshtëshënim të një dokumenti opinion të Kryqit të Kuq, ku
24 thuhet që shumica e grupeve të armatosura joshtetërore nuk
25 janë në gjendje që të paraqesin apo të sigurojnë *habeas*

1 *corpus*. Dhe kjo nuk e ndihmon argumentin e Veselit.

2 Siç paraqitet në këtë poshtëshënim nga i njëjti dokument
3 dhe po citoj:

4 "Nuk ka asnjë dyshim që e drejta humanitare ndërkombëtare
5 i detyron grupet e armatosura që nuk janë pjesë shtetërore që
6 të jenë palë të një konflikti të armatosur shtetëror siç
7 paraqitet nga traktatet dhe dispozitat relevante të traktateve
8 dhe të cilat janë pjesë e të drejtës humanitare
9 ndërkombëtare."

10 Siç e pranon edhe ky dokument opinion, ndërkohë që nenet
11 e artikullit 3 të cilat zbatohen në rastin e një konflikti të
12 armatosur jondërkombëtar, nuk kanë garanci gjyqësore, pranohet
13 se neni 75(4) i Protokollit I Shtesë duhet të reflektojë të
14 gjithë ligjin që zbatohet tek të gjitha llojet e konfliktit.
15 Mes kërkesave të nenit 75(4) është që të ketë informacion pa
16 asnjë vonesë për të gjitha hollësitë e veprës penale me të
17 cilën është ngarkuar një person dhe të drejta që ai të merret
18 në gjykim në praninë e tij.

19 Edhe në qoftë se Paneli do të shohë të gjitha rrethanat
20 që kanë të bëjnë me procesin dhe nivelin e organizimit të UÇK-
21 së, e drejta e procesit të rregullt duhet zbatuar në
22 kundërshtim me pohimin e Veselit.

23 Komunikatat dhe deklaratat e tjera publike të cilat i
24 kemi parë më herët, nuk janë të vetmet dokumente të Shtabit të
25 Përgjithshëm të cilat janë zbatuar në qendrat e paraburgimit

1 në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë.

2 Ata i kanë ndjekur të gjitha këto udhëzime, i kanë
3 goditur me grushte dhe me shqelma të parandaluarit në të
4 gjithë trupin. I kanë goditur me shishe, me shkopinj
5 bejsbolli, shkopinj druri, me pushkë dhe me shufra hekuri. I
6 kanë therur me thika, kanë shkelur mbi ta dhe kanë përdorur
7 rrymën elektrike.

8 Në Kleçkë, Rexhep Selimi ka rrahur një të paraburgosur me
9 tuba plastikë. Në Dobratin, anëtarë të policisë ushtarake kanë
10 shfrytëzuar po kështu edhe tuba plastikë për të gjuajtur apo
11 për të rrahur të parandaluarit.

12 Këto të rrahura të cilëve i janë nënshtruar të
13 paraburgosurit në qendrat e UÇK-së i kanë shkaktuar lëndime të
14 mëdha përfshirë ehe gjakderdhje, mavijosje dhe thyerje të
15 eshtrave.

16 Viktima të shumë vendeve të ndryshme në Likoc, në Verban,
17 Budakovë, Jeshkovë, Tusuz, në ndërtesën e MUP-it dhe në vendet
18 e tjera në Prizren, Kukës, Cahan, Jabllanicë, Llapushnik,
19 Malishevë, Kleçkë kanë humbur ndjenjat si rezultat i rrahjeve
20 brutale të cilave i janë nënshtruar dhe kushteve në të cilat
21 janë mbajtur.

22 Siç thuhet në Faktet e Gjykuara 676, shpeshtësia e
23 rrahjeve në Kukës nënkuptonte që të paraburgosurit kanë jetuar
24 me frikën e përhjetshme të dhunës dhe të vrasjes.

25 Në Llapashticë, të parandaluarit i kanë thënë që i ka

1 kërkuar personave të cilët e mbanin të ndaluar që ta gjuanin
2 me pushkë, ta vrisnin që ta gjuanin me plumb në kokë dhe të
3 mos abuzonin. Dhe kjo nga 286.

4 Dhe disa prej viktimave iu janë thyer dhëmbët dhe brinjët
5 apo të dyja.

6 Në Verban dhe në Llapushnik disa prej të paraburgosurve
7 iu janë hequr me pinca thonjtë. Në viktimën në Llapushnikut,
8 ishte një akt i dënimit pasi ai kishte ndihmuar një viktimë
9 apo një të paraburgosur tjetër të cilit i kishin prerë
10 gishtat.

11 Një numër prej viktimave janë rrahur në praninë e njeri-
12 tjetrit dhe u është kërkuar që ta rrahin njëri-tjetrin.
13 Rrahja, shpeshherë dhe me çdo gjë që i ndodhej përreth, nuk
14 ishte forma e vetme e keqtrajtimit apo vështirësive që janë
15 detyruar të durojnë të paraburgosurit.

16 Disa prej të paraburgosurve u janë marrë pasuri, para apo
17 makina.

18 Në Bubël, të paraburgosurit janë detyruar që të presin
19 dru.

20 Në Kukës kanë shkarkuar kamionë me pajisje për UÇK-në apo
21 kanë pastruar dhoma apo tualete.

22 Në Budakovë janë detyruar që të hapin istikame.

23 Në Likoc janë detyruar që të pastrojnë edhe vendet e
24 mbuluara me gjak.

25 Në Llapushnik janë detyruar që të varrosin trupat e

1 shkatërruar të bashkëparandaluarve.

2 Në Llapashticë, ata janë detyruar që të shkojnë në një
3 pyll, ku i është dhënë lopata për të hapur varrin e tyre.

4 Ka dhe forma të tjera të keqtrajtimit të cilat e kanë
5 dhunuar dinjitetin e tyre.

6 Në Taslixhë janë detyruar që të zhvishen dhe të rrinë me
7 të brendshme.

8 Si është mbështetur dhe nga faktet e gjykuara më parë, në
9 Zllash një i paraburgosur i është nënshtruar një simbolizmi të
10 ekzekutimit. Anëtarët e UÇK-së kanë urinuar mbi një të
11 paraburgosur tjetër atje.

12 Në Shalë, një i paraburgosur është detyruar që të heqë,
13 që të zhveshë apo të heqë pantallonat dhe të brendshmet kur e
14 ka urdhëruar një ushtar për ta bërë një gjë të tillë, pasi
15 ishte i pafuqishëm në ato rrethana.

16 Të paraburgosurit po kështu kanë duruar edhe forma të
17 tjera të keqtrajtimit psikologjik.

18 Në Verban, ushtarë të UÇK-së kanë kërcënuar një të
19 paraburgosur se do ta ekzekutonin. Ndërkohë që ishin atje kanë
20 dëgjuar edhe lidhur edhe të afërmit e tyre të cilët janë
21 vrarë.

22 Disa prej të burgosurve kanë dëgjuar të tjerët që janë
23 keqtrajtuar.

24 Siç mund të shihni në ekran, një i paraburgosur në Gjilan
25 tha:

1 "Kur isha në dhomë dëgjova piskama nga dhoma tjetër dhe
2 kur them 'piskama' e kam fjalën për piskamë njerëzore që ishin
3 si ato të kafshëve, pasthirrma. Këto piskama ta ngrinin gjakun
4 në vena. Po të dëgjoni këto do të ngrihej gjaku në venë. Këto
5 janë të pabesueshme. Sa herë që dëgjonim piskama të tilla, si
6 ato që kam përshkruar unë, do të dilni nga dhoma të shkoje
7 diku tjetër dhe sapo të hapje derën dëgjoreshin edhe më me zë
8 të lartë këto piskama."

9 Të nderuar Gjykatës, i keni parë në provat që janë
10 paraqitur që anëtarët e UÇK-së kanë transferuar disa prej të
11 paraburgusuve nga një pikë paraburgimi në një pikë tjetër në
12 të njëjtën qytet apo në një fshat në të njëjtin fshat.
13 Ndërkohë që të tjerë janë transferuar nga qendrat e
14 paraburgimit të UÇK-së në një vend në disa vende tjera në
15 zonat e tjera operative apo në Shqipëri apo në vende të tjera
16 brenda Kosovës.

17 Dhe provat tregojnë që këto transferime kanë përfshirë
18 një numër të madh të anëtarëve të UÇK-së në arrestimin,
19 transferimin, paraburgimin, marrjen në pyetje, keqtrajtimin e
20 një individi dhe kjo është në mes të atyre që ju, të nderuar
21 Gjykatës, do t'ju bëjë që të hidhni poshtë argumentet e
22 Mbrojtjes që këto krime ishin krime individuale apo akte të
23 hakmarrjes individuale të elementëve të cilët nuk bindeshin.

24 Dhe në bazë të fakteve të gjykuara tashmë, do të shihet
25 rasti i një të paraburgosuri i cili ishte i ndaluar në Bob

1 menjëherë para periudhës së marsit 1999. Pesë të
2 paraburgosurit të cilët nuk u liruan kur filluan granatimet
3 serbe në Ivajë ishin transferuar në vende të tjera në Varosh.
4 Katër prej të cilëve nuk janë parë më. Një numër anëtarësh të
5 UÇK-së kanë ushtruar brutalitet fizik apo keqtrajtuar disa
6 prej këtyre të paraburgosurve.

7 Siç e pamë, faktet e këtij incidenti janë vërtetuar gjatë
8 një gjykimi të mëhershëm.

9 Si dhe në rastin e incidenteve të tjera, faktet dhe
10 provat e tjera relevante e bëjnë tejet të qartë që Mbrojtja e
11 Krasniqit e shtrembëron realitetin kur thotë që të gjitha
12 krimet, ato krime të cilat janë bërë, janë bërë si përgjigje
13 ndaj sulmeve serbe apo si pjesë e mosmarrëveshjeve personale.

14 Dosja e Thaçit citon dëshminë e njërit prej viktimave të
15 paraburgimit në Ivajë, ku thotë atë që shihet në ekran tani.

16 Kur është arrestuar, provat tregojnë se atij iu tha se
17 "Tani ke punë me UÇK-në" dhe nuk ishte ky mendimi i
18 dëshmitarit që në këtë rast bëhej fjalë për një çështje me të
19 cilën merrej UÇK-ja.

20 Lidhur me këtë dhe parashtrimet e ngjashme që kanë bërë
21 shumë prej ekipeve të Mbrojtjes, opinioni i një viktime apo
22 një të afërmi se pse është parandaluar një viktimë duhet
23 konsideruar apo shqyrtuar me kujdes. Siç e kanë shpjeguar dhe
24 dëshmitarët, stigma që shoqëron akuzën për bashkëpunim të
25 ndjek gjatë gjithë jetës dhe në këtë kontekst është e

1 kuptueshme se disa prej dëshmitarëve do të përmendnin çdo gjë
2 tjetër përveç kësaj akuze kur ia kanë justifikuar keqtrajtimin
3 që iu është bërë atyre apo personave të tjerë gjatë kohës që
4 kanë dhënë dëshminë e tyre.

5 Si pjesë e të njëjtit argument që ka të bëjë me
6 konkluzione që dalin nga krimet e paraqitura në aktakuzë,
7 Mbrojtja e Thaçit pohon se të gjithë personat e paraburgosur,
8 së bashku me W4337, ishin pjesë e një mosmarrëveshjeje
9 personale. Kjo nuk mbështetet nga provat e cituara në
10 poshtëshënimin 253 të kësaj dosjeje.

11 Përkundrazi, provat tregojnë se gjatë paraburgimit
12 disamujor të bashkëparaburgosurit janë ndaluar për arsye të
13 cilat nuk kanë lidhje me këtë mosmarrëveshje personale,
14 përfshirë, për shembull, mbështetjen e tyre për UÇK-në,
15 mosndalimin në një postbllok të UÇK-së dhe bashkëpunim me
16 persona të etnitetit serb. Dhe për këtë, ju referoj, të
17 nderuar Gjykatës, në provën 206 në faqen që përfundon me 368,
18 621, 623, dhe 632, 633 dhe në provën materiale 202 në faqet që
19 përfundojnë me 836 dhe 839, 840.

20 Pretendimet e palës mbrojtëse lidhur me motivet personale
21 të ashtuquajtura në rastin e kryerjes së këtyre krimeve nuk
22 kanë baza. Siç është paraqitur në paragrafin 1365 të dosjes
23 sonë, konflikti i armatosur nuk ka nevojë që të jetë shkaktari
24 i kryerjes së krimeve për të cilët paraqiten në këtë aktakuzë,
25 por do të ketë luajtur një rol të konsiderueshëm pjesërisht

1 ose në mundësinë e kryesit për ta bërë këtë krim, vendimi për
2 ta bërë këtë, mënyra sesi është bërë apo synimi për ta bërë
3 një gjë të tillë është një objektiv i cili është vërtetuar
4 tashmë. Ekzistenca e motiveve shtesë si, për shembull, e
5 hakmarrjes, nuk e hedh poshtë klasifikimin e këtyre akteve si
6 akte të krimeve të luftës. Ligji është i qartë dhe kjo gjykatë
7 e ka parë, e ka pranuar një gjë të tillë në paragrafin 770 të
8 aktgjyqimit të apelit të Shalës.

9 Tani po i kthehem dhe transferimit apo lëvizjes së të
10 paraburgosurve nga ushtarët e UÇK-së nga një vend në një vend
11 tjetër. Në disa raste në qershor, për shembull, të vitit 1998,
12 dy kundërshtarë janë arrestuar, marrë në pyetje dhe në një
13 rast janë rrahur keq në selinë e UÇK-së në Drenoc dhe
14 personalisht kjo është bërë në selinë e UÇK-së nga Hashim
15 Thaçi dhe Kadri Veseli. Thaçi dhe Veseli fillimisht ishin në
16 shoqërinë e Rexhep Selimit gjatë këtij transferimi. Këta dy
17 kundërshtarë nuk janë parë më.

18 Pretendimet e Mbrojtjes lidhur me këtë incident kanë të
19 bëjnë me paqartësi të cilat edhe po të ishin të vërteta nuk
20 mund të shtrembërojnë faktin e provave dokumentare për këtë
21 dëshmitar që vërteton edhe faktet relevante.

22 Dhe nuk është çudi që pala mbrojtëse përpiqet që ta
23 zvogëlojë rëndësinë e këtyre provave.

24 Deklarata për ZPS-në e Rexhep Selimit i paraqet këto
25 prova në mënyrë -- provat e Thaçit në këtë incident në mënyrë

1 të drejtpërdrejtë. Përfshirë në këtë deklaratë është dhe
2 implikimi i vetë Selimit dhe provat kundër interesave të vetë
3 Selimit të cilat janë të besueshme.

4 Ndryshe nga pohimi i Mbrojtjes së Veselit, Rexhep Selimi
5 nuk e ka tërhequr pretendimin që Kadri Veseli ka marrë pjesë
6 në këtë transferim. Përkundrazi, ndërkohë që ka shprehur
7 paqartësi në rastin konkret menjëherë, nëse Veseli ishte i
8 pranishëm në kohën e këtij incidenti, dhe e kam fjalën për
9 761.1, Selimi në fund ka thënë që i kujtohen më mirë ngjarjet
10 në vitin 2003 kur ai tha se Veseli ishte me të dhe me Thaçin
11 në kohën që janë transferuar, është transferuar njëri prej
12 këtyre viktimave. E kam fjalën për provën 761.1.

13 Pretendimi i Selimit që dëshmitari ka manipuluar apo i
14 është nënshtruar presionit apo është kanosur Selimit për të
15 dhënë informacionin që ka të bëjë me këtë incident, në fakt,
16 është i pabesueshëm, përfshirë duke patur parasysh edhe provat
17 vetëfajësuese të Selimit që i ka dhënë ZPS-së lidhur me të
18 njëjtin incident pas disa viteve.

19 Pohimit të Mbrojtjes së Veselit që dëshmi të cilat janë
20 të një pale të tretë lidhur me këtë incident janë të
21 paprovuara, nuk marrin parasysh kundërpyetjet që janë bërë
22 dëshmitarëve relevantë të kësaj çështjeje.

23 Teoritë alternative që kanë të bëjnë me këtë incident
24 hidhen poshtë nga provat të cilat janë në paragrafin 766, 770
25 të provës sonë.

1 Transferimi i këtyre kundërshtarëve nuk ishte i vetmi
2 rast i transferimit në të cilin ka marrë pjesë Veseli. Në mars
3 të vitit 1999, Veseli transferoi një të paraburgosur tjetër
4 nga Drenica në Kleçkë dhe pasi ishte rrahur dhe ndaluar nga
5 ushtarët i UÇK-së ky i paraburgosur.

6 Një tjetër tipar dallues i provave që kanë të bëjnë me
7 krimet e paraqitura në aktakuzë është që të paraburgosurit u
8 mbajtën në një numër pikash të paraburgimit janë liruar vetëm
9 pasi janë -- vetëm pas ofensivave serbe apo ndërhyrjeve të
10 KFOR-it dhe në disa raste vetëm pas presionit ndërkombëtar mbi
11 ushtarët e UÇK-së, përfshirë disa prej të akuzuarve për t'i
12 liruar ata.

13 Ushtarët e UÇK-së nën kontrollin efektiv të të akuzuarve
14 jo vetëm që i kanë trajtuar viktimat në mënyrë të njëjtë
15 vetëm, po edhe të afërmit e viktimave në disa raste iu
16 nënshtruan të njëjtit model të trajtimit. Në disa raste i
17 është dhënë informacion fals. Nganjëherë të afërmit vetë janë
18 kërcënuar, rrahur, e ndaluar ndërkohë që ata kërkonin të dinin
19 se çfarë iu ka ndodhur të afërmeve të tyre.

20 Juridiksioni i Trupit Gjykues lidhur me krimin e zhdukjes
21 me forcë është pjesë e juridiksionit e krimeve të ndalimit
22 arbitrar dhe është vërtetuar për arsye të paraqitura nga
23 Gjykata e Apelit në këtë rast më datën 23 dhjetor 2021 në
24 vendimin IA009/F00030. ZPS-ja bazohet në Vendimin e
25 Konfirmimit lidhur me elementë të këtyre krimeve.

1 Një tjetër gjë e përbashkët që tregojnë të afërmit e
2 viktimave është pamundësia e tyre për ta mbyllur mendërisht
3 çështjen se çfarë u ka ndodhur anëtarëve të familjes. Eshtrat
4 e të afërmeve të tyre në zona si në Likoc, në Jabllanicë,
5 Drenoc, Kleçkë, Varosh, Rahovec dhe në Nerodime nuk janë
6 gjetur ende.

7 Sa i përket Nerodimës së Ulët dhe Novobërdës,
8 parashtrimet e Krasniqit lidhur me provat relevante nuk mbajnë
9 parasysh informacione kyçe.

10 Pranimi, për sa i përket Novobërdës, provat e një
11 dëshmitari të një rasti të krimit mbi të cilat bazohet UÇK-ja
12 janë pranuar në bazë të rregullit 153. Pasi e kanë informuar
13 ZPS-në se nuk e kundërshtonte këtë pranim, pala mbrojtëse nuk
14 ka bërë kundërpërgjigje ndaj kërkesës së ZPS-së sipas
15 rregullës 153 lidhur me këtë dëshmitar. Kjo do të thotë që
16 Mbrojtja nuk e ka hedhur poshtë këtë pranim ose nuk ka treguar
17 dëshirën për ta marrë në pyetje këtë dëshmitar kur i është
18 dhënë mundësia për ta bërë një gjë të tillë.

19 Dëshmia e këtij dëshmitari është e pranueshme dhe është e
20 hollësishme. Dhe sa i përket këtij dëshmitari provat e tij
21 janë të vërtetuara me dokumente shkresore dhe me dëshminë e
22 4868, i cili ka dhënë dëshmi sipas rregullit 154. Krimet janë
23 po kështu vërtetuar edhe në bazë të modelit të krimeve të bërë
24 në zonën e Karadakut dhe gjatë kësaj periudhës.

25 Në shumë raste kur janë gjetur trupat e viktimave të

1 vrasjes me paramendim, ushtarët e UÇK-së i kanë lënë ata në
2 fusha, në rrugë, në vende të tjera publike. Në këtë rast i
3 keni të përfaqësuar me pikat e kuqe në ekran.

4 Trupat e viktimave të ndaluar, për shembull, në Likoc,
5 Llapushnik, Malishevë, Barë, Bajgorë, Llapashticë dhe Kleçkë
6 kishin pikërisht shenja të gjuajtjes me plumba me pushkë dhe
7 kishin edhe shenja të rrahjes, të dëmtimeve në kokë dhe gjoks,
8 prerje të thella apo traumë të shkaktuar nga objektet e rënda.
9 Dëshmitë e ekspertit patolog 04826 dhe 4874 e ndihmojnë Trupin
10 Gjykues në këtë drejtim për sa i përket dokumentacionit
11 shkresor.

12 Dokumentet e tjera shkresore të pranuar në këtë çështje
13 konfirmonin dhe identitetin e viktimave të vrasjes përmes
14 testimit me ADN. Dëshmia e 4875 e ndihmon Trupin Gjykues në
15 këtë drejtim.

16 Argumentet e Mbrojtjes së Veselit se dëshmitë
17 pataologjike të pranuar përmes provave jo gojore janë të
18 analizueshme, në fakt, injoron faktin që prova i ka patur
19 mundësinë që të bëjë parashtime me shkrim lidhur me çështje
20 të cilat janë pranuar përmes procesit jo gojor dhe ta bënin
21 këtë dosjen e tyre përfundimtare. Pala mbrojtëse mund të
22 kishte shfrytëzuar këtë material edhe me dëshmitarët
23 relevantë, përfshirë edhe me dëshmitarët ekspertë të cilët
24 kanë dhënë dëshmi këtu. Asgjë nuk e ka penguar Mbrojtjen që ta
25 bëjnë një gjë të tillë.

1 Argumentet e Mbrojtjes së Veselit se disa autopsi të
2 raporteve të ADN-së, të cilat janë pranuar, nuk mund të jenë
3 të mbështetshme për sa i përket vërtetësisë së përmbajtjes së
4 tyre dhe duhet të hidhen poshtë pasi ato janë pjesë për ta
5 gjykuar edhe një herë çështjen e pranueshmërisë e cila është
6 diskutuar përmes një apeli të ndërmjetëm. Sa i përket kësaj, e
7 kam fjalën për paragrafët 38 deri në 42 të përgjigjes sonë
8 IA040/F00006 në këtë çështje.

9 Parashtrimet e Mbrojtjes së Selimit lidhur me provat dhe
10 rrethanat e vdekjes së një numri viktimash nuk mbajnë parasysh
11 hollësitë dhe provat. Dhe i kërkoj Trupit Gjykues që t'i
12 krahasojë parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit në paragrafin
13 647 dhe dosjet e tyre për sa i përket Mbrojtjes vrasjes së
14 gjashtë viktimave në paragrafët 651 deri në 657 të dosjes sonë
15 ku paraqiten provat mbështetëse. Dhe në këtë rast bëhet fjalë
16 për provat të cilat përfshijnë, mes të tjerave, edhe
17 kërcënimin për vrasje të UÇK-së dhe vrasjen nga ana e
18 personave të cilët i kanë mbajtur të ndaluar.

19 Sikurse konfirmohet nga Rexhep Selimi, anëtari i NKP-së
20 Sabit Geci, ashtu si vetë ai, ka qenë një prej atyre personave
21 të përfshirë brenda UÇK-së në 1997. Geci drejtonte një njësi
22 inteligjence që operonte në Drenicë dhe që i jepte llogari
23 Kadri Veselit dhe Shtabit të Përgjithshëm. Kadri Veseli pranoi
24 se ai e njihte Gecin dhe ishte takuar më shumë sesa një herë
25 me të, përfshirë në mars të 1998 në Drenicë.

1 Mbroytja e Veselit përpigëj që ta distancojë Veselin nga
2 Geci kryesisht për shkak të dallimit linguistik. Ata
3 pretendojnë që Geci e ka prezantuar veten dhe përmendet në
4 dokumentacion si pjesë e shërbimit sekret dhe jo si pjesë e
5 zbulim dhe kundërzbulimit. Kjo përpjekje nuk qëndron.

6 Për shembull, në rregulloren e përkohshme të organizimit
7 të jetës së brendshme të ushtrisë që e keni tani përpara në
8 ekranin tuaj, vetë Shtabi i Përgjithshëm i referohet shërbimit
9 sekret të UÇK-së dhe subjekteve të zbulim-kundërzbulimit si e
10 njëjta gjë. Sepse sikurse mund ta shikoni, ato i referohen
11 detyrave të policisë ushtarake për të bashkëpunuar dhe për të
12 ndihmuar "drejtorinë e shërbimit sekret dhe të zbulim-
13 kundërzbulimit".

14 Më vonë gjatë konfliktit, Sabit Geci ka pasur autoritet
15 në Cahan dhe në Kukës që janë dy qendra ndalimi atje dhe ka
16 qenë shefi i inteligjencës dhe kundërinteligjencës, zbulim-
17 kundërzbulimit për Shqipërinë dhe i ka raportuar
18 drejtpërdrejt Shtabit të Përgjithshëm. Në qoftë se do të
19 vlerësohet në tërësi të gjitha provat lidhur me z. Geci të
20 çojnë në pozicione të zbulim-kundërzbulimit dhe në raportimin
21 e tij përpara Veselit dhe Shtabit të Përgjithshëm.

22 Përpara pjesëmarrjes së tij drejtpërdrejt në krimet në
23 Qirez, Sabit Geci ka udhëtuar në një automjet drejt Shqipërisë
24 përmes Lladrovci me Hashim Thaçin dhe Xhavit Ferizin,
25 gjithashtu të njohur si Raketa. Përveç përfshirjes në Qirez,

1 Geci ka marrë pjesë gjithashtu në marrjen në pyetje, në
2 ndalimet në Likoc, ka marrë pjesë gjithashtu edhe në
3 arrestimet, ndalimet, marrjet në pyetje, keqtrajtimet e
4 oponentëve në Cahan dhe Kukës në 1999, duke i abuzuar
5 fizikisht dhe psikologjikisht të ndaluarit atje.

6 Pasi një viktimë më vonë është ndaluar në Cahan dhe është
7 arrestuar, Sabit Geci ka deklaruar, "Ne kemi të drejtën të
8 bëjmë një gjë të tillë sepse ai ka qenë mbështetës i Rugovës".
9 Dhe, "A ka mundësi Rugova të të shpërtojë ty tani?", kjo është
10 pyetja që i ka bëri Geci këtij personi të ndaluar atje.

11 Shumë nga viktimat kanë vazhduar që të vuajnë në mënyra
12 të ngjashme për shkak të keqtrajtimit në duart e anëtarëve të
13 UÇK-së. Ka pretendime të pambështetura nga anëtarë të UÇK-së
14 që viktimat kanë qenë spiunë ose bashkëpunëtorë, gjë e cila
15 donte të thoshte që viktimat dhe anëtarët e familjeve të tyre
16 vazhdonin që të njolloseshin dhe kjo donte të thoshte që ata
17 trajtoheshin si persona të jashtëm dhe që nuk ishin më të
18 mirëpritur në fshatrat nga ku vinin.

19 Viktimat e krimeve në aktakuzë është dashur që t'i
20 nënshtrohen trajtimeve mjekësore, përfshirë dhe operacione.
21 Ato vazhdojnë edhe sot e kësaj dite që të vuajnë dëme fizike
22 dhe psikologjike. Disa janë ende të paafte për të jetuar.

23 Anëtarë të familjes së viktimave po ashtu kanë qenë të
24 traumatizuar lidhur me atë se çfarë i kanë ndodhur personave
25 të tyre të dashur.

1 Dëshmitari 00072, vendosmëria për drejtësi e të cilit
2 është vlerësuar nga Prokuroria e Posaçme më herët sot, e ka
3 përshkruar humbjen e bashkëshortit dhe djalit të saj, të cilët
4 të dy ishin ndaluar dhe vrarë nga UÇK-ja, sikur ka humbur
5 gjysmën e shpirtit dhe të zemrës së saj. Dëshmitari ju ka
6 treguar juve, të nderuar Gjykatës, që ajo do jetë duke menduar
7 për djalin dhe bashkëshortin e saj edhe kur të marrë frymën e
8 fundit në këtë tokë.

9 Ndërkohë, Dëshmitari 04489, një grua, bashkëshorti i të
10 cilës nuk është gjendur edhe sot e kësaj dite tha që heshtja e
11 ka vrarë, e ka vrarë atë dhe familjarët e saj për herë të
12 dytë.

13 Ndërkohë që një dëshmitari tjetër, 4367, një nënë e cila
14 dekada pasi pa për herë të fundit të birin e saj e kalon kohën
15 duke qarë pjesën më të madhe dhe është thellë e lënduar.

16 Dëshmitë e ofruar nga anëtarët e familjeve të viktimave
17 tregojnë që edhe pse anëtarë të UÇK-së kanë siguruar që
18 viktimat e tyre asnjëherë të mos tregonin historinë e tyre për
19 askënd, të nderuar Gjykatës, ju keni mundur që të mblidhni
20 dëshmi të mjaftueshme për arrestimin, ndalimin, keqtrajtimin
21 dhe vrasjen e atyre. Keni pasur mundësi që të merrni dëshmi që
22 kanë të bëjnë me viktimat e vrasjes përmes personave që kanë
23 vuajtur bashkë me ta si të ndaluar dhe nga anëtarë të UÇK-së
24 që kanë qenë të guximshëm mjaftueshëm për të folur dhe për të
25 ngritur zërin.

1 Disa prej këtyre viktimave, pavarësisht frikërave për
2 veten e tyre dhe për jetën e familjarëve të tyre, kanë marrë
3 guximin dhe kanë dhënë dëshmi përpara jush.

4 Në lidhje me këto dhe me viktima të tjerë, të nderuar
5 Gjykatës, ju keni pranuar dhe deklarata me shkrim që kanë
6 dokumentuar krimet në hollësi në ato kohë dhe këto dëshmi nuk
7 kanë marrë asnjë kundërshtim nga asnjë prej ekipeve të
8 Mbrojtjes.

9 Dëshmia e dëshmitarëve që kanë të bëjnë me krimet e
10 ngritura në aktakuzë plotësohet dhe nga shkresat dhe
11 dokumentet me shkrim të shumta dhe nga praktika e zhvilluar
12 gjerësisht.

13 Ndërkohë që shqyrtoni këto prova, të nderuar Gjykatës, ju
14 duhet të keni parasysh gjithashtu që këto elementë kanë
15 ndodhur në një situatë të caktuar politike dhe etnike duke
16 përmbushur kështu elementët e krimeve të ngritura në aktakuzë
17 dhe të ndjekura prej nesh.

18 Megjithatë më lejoni të them që unë thjesht kam
19 gërvishtur sipërfaqen e akuzave në këtë çështje ligjore.
20 Ndërkohë që do ju ftoja që të lexonit parashtimet më të
21 hollësishme për secilin prej krimeve në Seksionin III. Prania
22 e të akuzuarve në vendet e krimit dhe pjesëmarrja e
23 drejtpërdrejtë në krime parashtrohet më tej hollësisht në
24 dosjen tonë.

25 Ndërkohë që prova që unë kam mbuluar sot është e

1 shumëllojshme sa i takon natyrës së saj, ajo është e tillë që
2 të çon në asnjë dyshim të paarsyeshëm që akuza të tilla kanë
3 ndodhur.

4 Ndërkohë që në prezantimin e radhës z. Quick do të
5 vazhdojë me diskutimin e strukturës dhe funksionimit të
6 Shtabit të Përgjithshëm dhe të UÇK-së gjatë periudhës së
7 aktakuzës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
9 z. Pace.

10 Z. Quick, kur të jeni gati mund të filloni.

11 Z. QUICK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

12 Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Mirëdita të gjithëve ju që
13 jeni këtu në Gjykatë dhe ju që na ndiqni nga distanca.

14 Përpara sesa të filloj, dëshiroj të them që diapozitivat
15 që do të përdor sot janë diapozitiva që mund të paraqiten për
16 publikun, me përjashtim të diapozitivit të fundit.

17 Kolegët e mi kanë trajtuar formacionin e hershëm të UÇK-
18 së dhe Shtabit të Përgjithshëm, qëllimin e përbashkët kriminal
19 dhe krimet e ngritura në aktakuzë. Ndërkohë që unë do të
20 trajtoj funksionimin dhe strukturat e Shtabit të Përgjithshëm,
21 të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe të zonave operative.
22 Këtu përfshihen selitë e tyre, vendimmarrja e tyre dhe takimet
23 si edhe rregulloret, urdhrat, komunikatat, përbërjet, rolet
24 dhe linjat e raportimit.

25 UÇK-ja ishte një grup i armatosur i organizuar që është

1 zhvilluar në përgjigje të rrethanave në ndryshim e sipër
2 ushtarake dhe politike. Nuk ishte një ushtri tradicionale.
3 Opinionet e dëshmitarëve të caktuar sa i takon organizimit,
4 strukturës dhe kompetencave të saj janë mbështetur në krahasim
5 me instancat ushtarake të ish-Jugosllavisë, Serbisë ose të
6 vendeve të NATO-s. Opinione të tilla të ndihmojnë pak për
7 vlerësimin e rrethanave unike të UÇK-së.

8 Sigurisht, që duhet të bëhet dallimi midis aspiratave dhe
9 realitetit. Disa rregullore dhe urdhra, në fakt, pjesërisht,
10 kanë qenë të avancuara ose avangardë për kohën kur UÇK-ja
11 synonte që të kontrollonte një Kosovë të pavarur. Një
12 planifikim i tillë i avancuar, në fakt, demonstroi organizimin
13 e UÇK-së dhe të Shtabit të Përgjithshëm.

14 Është realitet se me kalimin e kohës dhe përgjatë
15 ndryshimeve të shumta organizative, të akuzuarit kanë pasur
16 kompetencë mbi strukturat që ekzistonin dhe i kanë përdorur
17 ato për të ekzekutuar planin e tyre të përbashkët kriminal.

18 Z. Tieger shpjegoi më herë që në fillim të aktakuzës, të
19 periudhës së aktakuzës, UÇK-ja ka funksionuar nga bastione të
20 krijuara dhe nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Shtabit të
21 Përgjithshëm, përfshirë këtu të akuzuarit dhe anëtarët e NKP-
22 së të përcaktuar me emër.

23 Krimet e para të ngritura në aktakuzë janë kryer nga
24 bastione të tilla.

25 Ndërkohë që mbështetja për UÇK-në dhe vullnetarët u

1 rritën pas sulmeve në Likoshan, në Qirez dhe Prekaz, Shtabi i
2 Përgjithshëm, përfshirë edhe të akuzuarit dhe anëtarët e NKP-
3 së, bashkërenduan dhe drejtuan zgjerimin e UÇK-së nga bastioni
4 i tij ekzistues. Synuan vende logjistike, krijuan "zona të
5 lira" dhe konsoliduan kontrollin e tyre.

6 Nga maji i 1998-s, të akuzuarit dhe Shtabi i Përgjithshëm
7 mbikëqyrën krijimin dhe zhvillimin e zonave operative ku kanë
8 ndodhur krimet e përmendura në aktakuzë.

9 Të paktën në fillim të qershorit të 1998-s, Shtabi i
10 Përgjithshëm ka ndarë më tej përgjegjësitë ndërmjet anëtarëve
11 të vet, të cilët pavarësisht të gjithave vazhduan që të
12 kryenin një gamë të gjerë të funksioneve politike dhe
13 ushtarake sipas nevojës.

14 Përpara sesa të vijoje më tej me funksionimin dhe
15 strukturat e Shtabit të Përgjithshëm prej qershorit të 1998-s,
16 vendi i shtabit ose i vendit ku gjendeshe Shtabi i
17 Përgjithshëm ishte i rëndësishëm për kontekstin. Këto vende
18 janë përzgjedhur në mënyrë strategjike për të siguruar që
19 Shtabi i Përgjithshëm të mund të operonte dhe të mund të
20 ushtronte kontroll në mënyrë efektive.

21 Shtabi i Përgjithshëm ka përdorur disa vende në veçanti
22 në Drenicë, në Pashtrik dhe në Nerodimë për takimet dhe për
23 shtabin e vet. Në fillim të periudhës së aktakuzës, Shtabi i
24 Përgjithshëm e kishte bazën dhe funksiononte në Likovc. Nga
25 vera 1998, Shtabi i Përgjithshëm kryesisht e ka pasur selinë

1 në Divjakë dhe në vende të tjera aty rrotull. Këto vende dhe
2 këto seli në Malet e Berishës ishin në qendër të Kosovës dhe
3 në afërsi të zonave operative duke lehtësuar kontrollin e
4 Shtabit të Përgjithshëm dhe komunikimet, ashtu siç është
5 shpjeguar nga Fatmir Limaj në videon P836.

6 Në këtë video jepen gjithashtu dhe citimet në anglisht,
7 kështu që nuk është e nevojshme që të ndiqni përkthimin.
8 Kështu që ju lutem ndiqni vidën.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Fatmir Limaj: "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, pa marrë
11 parasysh terrenin, e kishte vendin pothuaj më të sigurtë
12 vendosjen në këtë pjesë të Kosovë nga ku do të ndërlihte
13 veprimet ushtarake dhe komunikimin me të gjitha njësitë
14 ushtarake anekënd Kosovës. Kjo ishte pika, si të thuash, mesi
15 i Kosovës, qendra e Kosovës me të cilët mund të komunikonte me
16 të gjitha anët e Kosovës. Edhe me sistemin e ndërlihdjes edhe
17 me sistemin e kalimit dhe parakalimit të ushtarëve nga një
18 zonë në zonën tjetër duhej patjetër të kaloje nëpër këto male
19 dhe të ndërlihdhej me zona tjera. Prandaj edhe ne vendosëm që
20 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në pjesën më të madhe ta kalojë
21 në këtë pjesë".

22 Z. QUICK: [Përkthim] Zgjedhja e bazës së Shtabit të
23 Përgjithshëm në vende të sigurta dhe strategjike dhe në vende
24 të kuptimta demonstroi organizimin dhe përshtatshmërinë e saj.
25 Po ashtu ajo është një shenjë e lidërshiptit edhe e kontrollit

1 të Shtabit të Përgjithshëm gjatë kohës.

2 Shtabi i Përgjithshëm ka bërë vendime përmes një procesi
3 të shqyrtimeve kolektive dhe pjesa dërrmuese e vendimeve janë
4 respektuar nga të gjithë.

5 Nga pranvera e 1998-s e në vijim, Shtabi i Përgjithshëm
6 ka organizuar takimet e veta dhe këto takime kanë ardhur duke
7 u rritur, përfshirë këtu edhe takime të zgjeruara në të cilët
8 kanë marrë pjesë komandantët e zonave. Megjithatë, sikurse
9 është shpjeguar prej Shukri Bujës, në transkript në faqen
10 21992, kur merrnin pjesë në takimet e Shtabit të Përgjithshëm
11 ai, si komandant zone, nuk ka pasur të drejtën për të votuar.
12 Pas krijimit të Qeverisë së Përkohshme, në mars të 1999, janë
13 organizuar takime të përbashkëta të Shtabit të Përgjithshëm
14 dhe zyrtarë të lartë të Qeverisë së Përkohshme.

15 Sikurse tregohet në paragrafin 112 të dosjes sonë,
16 takimet e Shtabit të Përgjithshëm trajtonin një gamë të gjerë
17 çështjesh, përfshirë emërimet dhe shkarkimet, aspekte të
18 disiplinës, strukturës, rregullore, policinë ushtarake dhe të
19 zbulim kundërzbulimit, arrestimet, ndalimet, trajtimin e
20 bashkëpunëtorëve dhe të oponentëve, aspekte logjistike dhe
21 financa dhe negociata të ndryshme.

22 Pas takimeve, Shtabi i Përgjithshëm, përfshirë dhe të
23 akuzuarit, vijonte që të lëshonte urdhra, rregullore dhe
24 deklarata publike dhe të merrte veprime konkrete.

25 Sa për ilustrim, urdhri që keni tani në ekran ka ardhur

1 pas një takimi të datës 27 qershor të 1998 dhe autorizonte
2 policinë ushtarake dhe ushtarët në punkte që të ndalonin
3 persona të dyshuar. Dhe ky është një urdhër i cili është
4 sekuestruar nga Jakup Krasniqi.

5 Ndërkohë që jo çdo anëtar i Shtabit të Përgjithshëm ka
6 qenë i pranishëm në secilin prej takimeve, një ose më shumë
7 prej të akuzuarve në mënyrë të rregullt kanë marrë pjesë në
8 takime personalisht. Që Veseli dhe Thaçi nuk kanë qenë në
9 Kosovë gjatë një periudhe të caktuar dhe në gjysmën e dytë të
10 1998-s dhe në fillim të 1999-s nuk i zhvesh ata nga
11 përgjegjësia, kompetencat apo pjesa, roli që kanë luajtur në
12 procesin kolektiv vendimmarrës.

13 Të katër të akuzuarit kanë qenë të pranishëm në Kosovë
14 dhe kanë marrë pjesë në takime në të cilat janë marrë vendime
15 kritike lidhur me organizimin dhe lidërshtipin e Shtabit të
16 Përgjithshëm, Qeverinë e Përkohshme të Kosovës dhe drejtimin e
17 ardhshëm të secilës prej tyre. Gjithashtu, anëtarët që nuk
18 kanë qenë të pranishëm janë konsultuar dhe janë informuar për
19 vendimet e marra në këto takime. Dëshmitë tregojnë që ka pasur
20 gjithmonë mënyra dhe mundësi për ta bërë një gjë të tillë. Të
21 dhënat dhe procesverbalet e takimeve janë mbajtur, ndërkohë që
22 urdhrat, rregulloret dhe deklaratat publike i referojnë
23 takimeve të tilla. Vendimet e arritura sa i takon roleve dhe
24 aktiviteteve të të akuzuarve dhe takimet shpesh në vetvete,
25 pra, janë përcjellë nga një takim tek tjetri. Ndërkohë që të

1 akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm janë
2 bashkërenduar ngushtë, janë parë me njëri-tjetrin shpesh dhe
3 kanë pasur mënyra të ndryshme komunikimi në dispozicion të
4 tyre.

5 Rexhep Selimi, në intervistën që i ka dhënë ZPS-së,
6 konfirmoi që Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë konsultuar dhe
7 janë informuar për rezultatet e takimeve kur ata kanë qenë
8 shteti. Dhe sa për ilustrim si shembull konkret, gjatë
9 negociatave për shkëmbimin e tetë ushtarëve serbë të kapur në
10 fillim të janarit të 1999-s, Jakup Krasniqi ka konsultuar
11 Hashim Thaçin dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm
12 përmes telefonisë satelitore. Në këtë kohë, sikurse
13 konfirmohet edhe nga dokumentet e tyre të udhëtimit, si Thaçi
14 edhe Veseli kanë qenë duke udhëtuar dhe ishin së bashku.
15 Sikurse do të trajtohet pak më tej nga z. Halling, dëshmitë
16 demonstrojnë se ata mundnin dhe në fakt kanë komunikuar pas
17 njoftimeve që ndodhnin në kohë reale me lidërshipë në Kosovë
18 në atë kohë.

19 Në fillim të verës të 1998-s, Shtabi i Përgjithshëm ka
20 nxjerrë rregullore të cilat mbulonin organizimin ushtarak,
21 disiplinën, zbulim-kundërzbulimin, marrëdhëniet e publikut,
22 administratën civile, detyrat e rojeve, si dhe policinë
23 ushtarake. Këto rregullore njihnin autoritetin e vetëm të
24 Shtabit të Përgjithshëm dhe autorizonin arrestime dhe ndalime.
25 Ato nuk përmbanin garanci të procesit të rregullt ose të

1 trajtimit njerëzor. Këto rregullore janë shpërndarë. Ndërkohë
2 që mosrespektimi i tyre mund të çonte në masa disiplinore.

3 Rregullorja e përkohshme e organizimit të jetës së
4 brendshme të ushtrisë ishte shtylla kurrizore e këtij kuadri
5 rregullator. Shtabi i Përgjithshëm gjithashtu miratoi
6 rregullore të brendshme duke konfirmuar në mënyrë të shprehur
7 si autoritetin më të lartë komandues të UÇK-së. Rregullore
8 disiplinore të Shtabit të Përgjithshëm i jepnin kompetenca
9 eprorëve në nivele të ndryshme që të caktonin një sërë
10 sanksionesh, përfshirë edhe shkarkimin dhe izolimin.

11 Rregulloret e Shtabit të Përgjithshëm formonin bazën për
12 urdhrat dhe vendimet, përfshirë këtu në nivel zone ose në
13 nivel brigade.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dëgjojmë
15 akoma përkthimin.

16 Mund të vazhdoni.

17 Z. QUICK: [Përkthim] Në ekran mund të shikoni faqen e
18 parë të një regjistri prej tre faqesh të Shtabit të
19 Përgjithshëm dhe dokumente të tjera të protokolluara. Ky
20 regjistër është sekuestruar nga Jakup Krasniqi së bashku me
21 një listë urdhrash, vendimesh dhe dokumentesh të tjera të
22 Shtabit të Përgjithshëm. Të paktën ekzistojnë 25 dokumente të
23 ngjashme. Në të majtë të ekranit mund të shikoni përkthimin në
24 anglisht, në të djathtë është dokumenti në origjinal në shqip,
25 ndërkohë që në mes të faqes mund të shikoni numrat përkues të

1 provave materiale.

2 Në faqen e parë mund të shikoni urdhrat që iu janë dhënë
3 zonave dhe për të parë më tepër mund të vazhdoni në faqen
4 tjetër. Në këtë faqe tregohen urdhra që kanë të bëjnë me
5 brigada konkrete në Pashtrik, në Dukagjin, Nerodimë dhe në
6 batalione të Shtabit të Përgjithshëm. Urdhrat dhe vendimet në
7 këto dy faqe të para kanë të bëjnë me unitetin komandues,
8 kërkesat e raportimit, emërimet, trajnimi, logjistikën,
9 tatimet, komunikimet, si dhe autoritetin për të kryer
10 arrestime dhe ndalime.

11 Në qoftë se do të kalojmë tek faqja e fundit do të
12 shikoni këtu tri prova të tjera të pranuar, përfshirë këtu
13 dhe një ftesë që i detyronte komandantët e zonave të merrnin
14 pjesë në një takim në janar të 1999-s.

15 Në këtë diapozitiv që shihni tani, mund të dalloni
16 nënshkrimet dhe vulat e të shtatë komandantëve të zonave. Ata
17 janë regjistruar nga Shtabi i Përgjithshëm për arsye
18 identifikimi duke përfshirë dhe kur janë shpërndarë urdhrat
19 dhe vendimet. Edhe ky dokument është sekuestruar nga Jakup
20 Krasniqi.

21 Shtabi i Përgjithshëm, përfshirë të akuzuarit, ka
22 shpërndarë urdhra, ka marrë raporte dhe ka bashkërenduar punën
23 brenda përbrenda dhe jashtë përmes takimeve ballë përballë,
24 radiove, korrierëve dhe telefonave mobile dhe satelitor.

25 Mbrojtja e Thaçit parashtroi se UÇK-ja nuk kishte

1 telefona satelitor përpara dhjetorit të 1998-s, ndërkohë që
2 ekipet e tjera të Mbrojtjes bëjnë të njëjta parashtrime.
3 Ndërkohë që dëshmia e paraqitur në gjykim, përfshirë dhe atë
4 të cituar në paragrafin 219 të dosjes sonë, tregon që situata
5 ka qenë e ndryshme. Në qershor të 1998-s, në shtabin e
6 Drenocit, ku gjendej një vendndalimi, ka pasur një telefon
7 satelitor. Në provën P1259, të lexuar së bashku me P1264, në
8 faqet 66, 67 të PDF-së, konfirmohet kjo që sapo thashë më
9 lart.

10 I nderuar Gjykatës, mendoj që është moment i përshtatshëm
11 ky për të bërë një pushim.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
13 Do bëjmë një pushim deri në orën 15.45. Do mbledhemi përsëri
14 këtu në orën 15.45.

15 --- Seanca ndërpritet në orën 15.24

16 --- Seanca rifillon në orën 15.45

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

18 Z. Quick, kur të jeni gati ju lutem vazhdoni

19 Z. QUICK: [Përkthim] Faleminderit.

20 Tani dua të flas për strukturën e Shtabit të
21 Përgjithshëm. Rolet dhe pozicionet e anëtarëve të Shtabit të
22 Përgjithshëm janë diskutuar dhe janë vendosur në mbledhjet e
23 shtabit, detyrat dhe përgjegjësitë janë pasqyruar në
24 rregulloret e Shtabit të Përgjithshëm.

25 Diapozitiva në ekran tregon drejtoritë e Shtabit të

1 Përgjithshëm bashkë me pozicionet që ka pasur më së paku nga
2 qershori dhe korrik '98. Korniza e verdhë tregon të akuzuarit
3 ndërsa korniza e zezë anëtarë të NKP-së me emër. Disa kutiza
4 nuk kanë emra. Edhe pse krerët e disa drejtorive të paktën
5 formalisht nuk janë emëruar deri në vjeshtën e '98-s, të
6 akuzuarit dhe anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm i kryenin
7 funksionet e tyre shumë kohë më përpara siç e kemi përcaktuar
8 në dosjen tonë përfundimtare.

9 Në ekran mund të shihni pozicionet e Shtabit të
10 Përgjithshëm që kanë ekzistuar të paktën nga fundi i '98-s.
11 Njësoj si dhe me diapozitivin e fundit korniza e verdhë tregon
12 të akuzuarit, ndërsa korniza me të zezë anëtarët e NKP-së.

13 Përbërja e Shtabit të Përgjithshëm tregon kontrollin që
14 kanë ushtruar të akuzuarit me anëtarë të NKP-së së bashku me
15 personat e tyre të besuar sa i takon vendimmarrjes së Shtabit
16 të Përgjithshëm. Sikurse e ka shpjeguar Bislim Zyrapi në
17 intervistën e ZPS-së ka qenë një nga anëtarët e Shtabit të
18 Përgjithshëm i cili ka qenë pjesë e grupit të personave të
19 besuar. Ai ka qenë i vetmi person i jashtëm.

20 Prokuroria në dosjen e vet trajton me hollësi pozicionet
21 e ndryshme dhe drejtoritë e ndryshme. Unë do të fokusohem sot
22 në rolin e zëvendëskomandantëve, inspektorit të përgjithshëm,
23 informimit, aspektit politik, zbulimit dhe policisë.

24 Nga mesi i nëntorit 1998 zëvendëskomandanti Krasniqi kur
25 mori dhe rolin ushtroi autoritet të plotë në mungesë të

1 komandantit të përgjithshëm.

2 Ndonëse e Mbrojtja e Krasniqit përpiqet të tjetërsojë
3 hierarkinë e UÇK-së, provat e bëjnë të qartë që shefi i
4 shtabit kishte në vartësinë e vet komandantët dhe zëvendës
5 komandantët. Kjo konfirmohet nga urdhëresa, raporte,
6 rregullore dhe dëshmi të tjera.

7 Mbrojtja e Krasniqit në mënyrë selektive citon dëshminë e
8 Naim Malokut për të mbështetur parashtrimet e veta. Maloku ka
9 dhënë dëshmi, dhe këtë mund ta shihni në faqen e transkriptit
10 25749 se zëvendëskomandant Krasniqi ka qenë i lartë dhe ka
11 qenë mbi Shefin e Shtabit Zyrapin, dhe ka ushtuar autoritet të
12 plotë në mungesë të komandantit të përgjithshëm. Krasniqi ka
13 lëshuar urdhra të cilat nuk kishte autoritet t'i lëshonte
14 Zyrapin.

15 Flasim tani për rolin e Rexhep Selimit në Shtabin e
16 Përgjithshëm. Të paktën nga qershori i '98-s ka qenë kreu i
17 drejtorisë operative, dhe nga mesi i korrikut 1998, ka qenë
18 inspektori i përgjithshëm. Mbrojtja e Selimit konteston datën
19 e saktë kur ka marrë zyrtarisht pozicionin e inspektorit të
20 përgjithshëm dhe thonë se vetë Selimi më parë ka thënë se ka
21 qenë në këtë pozicion nga gushti ose shtatori, por ai vetë nuk
22 ka qenë i sigurt. Ndonëse provat e bëjnë të qartë se Selimi e
23 ka pasur këtë pozicion nga mesi i korrikut i 1998-s, roli,
24 autoriteti dhe veprimtaritë e tij në thelb mbeten të njëjtat
25 edhe para edhe pas emërimit të tij zyrtar.

1 Në cilësinë e inspektorit të përgjithshëm Selimi ka
2 operuar në nivel të komandantit të përgjithshëm. Funkcioni i
3 tij ishte operativ, mbikëqyrës dhe disiplinor.

4 Vetë Selimi, përfshirë në deklaratën e TPNJ-së në 2004-n
5 dhe në intervistën e ZPS-në në 2019-n se ka qenë në kontakt të
6 vazhdueshëm me komandantët e zonave dhe ka marrë pjesë në
7 formimin dhe organizimin e zonave. Ai madje ka konfirmuar se
8 personalisht ka nënshkruar emërimet e disa personave, të cilat
9 janë konfirmuar dhe nga disa dëshmitarë. Madje disa nga këto
10 urdhra për emërimë janë tashmë të pranuar si prova gjyqësore.

11 Si inspektor i përgjithshëm në përputhje me rolet e
12 mëparshme në UÇK-së, përgjegjësia kryesore e Selimit ishte të
13 inspektonte njësitë vartëse në terren. Sikurse parashtrohet në
14 pjesë të ndryshme të dosjes së Prokurorisë, Selimi vizitonte
15 brigadat, njësitet e zbulimit dhe policinë ushtarake për të
16 vlerësuar gatishmërinë luftarake, moralin, organizimin dhe
17 komandën. Ai shpërndante dhe lëshonte urdhra të Shtabit të
18 Përgjithshëm. Ai ka konfirmuar edhe e konfirmonte nëse
19 kuptoheshin këto urdhra të Shtabit të Përgjithshëm dhe nëse
20 zbatoheshin këto urdhra. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe anëtarë
21 të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm kanë kryer funksione të
22 ngjashme në terren, por këtë e ka bërë më shumë Selimi në
23 mënyrë më të shpeshtë, në mënyrë më të shtrirë.

24 Roli i inspektimit të Selimit përputhet me dokumentet e
25 brendshme të Shtabit të Përgjithshëm. Një dokument i këtillë

1 është sekuestruar prej Rexhep Selimit dhe ka marrë numrin e
2 provës 3D27, ku parashtrohet koncepti i inspektimit. Në të
3 shpjegohet se inspektimet ishin krijuar për të mbikëqyrur
4 gatishmërinë luftarake, moralin dhe komandën, dhe për të
5 përforcuar synimet strategjike të Shtabit të Përgjithshëm. Në
6 faqen e fundit, flitet për evidentimin e dobësive dhe heqjen e
7 tyre të menjëhershme me anë të direktivave.

8 Selimi përcillte informacionin që mblihte gjatë
9 inspektimeve tek Shtabi i Përgjithshëm. Ai raportonte në
10 mbledhjet e shtabit dhe dorëzonte raporte me shkrim. Një
11 raport syresh ka numrin P2924, është i janarit 1999 dhe është
12 një përmbledhje e inspektimeve të tij në zonat e Nerodimës dhe
13 të Pashtrikut dhe të një njësitit të posaçëm të Shtabit të
14 Përgjithshëm.

15 Autoriteti i Selimit ilustron dhe më tej me anë të
16 emërimit të tij si kryetar i komisionit të Shtabit të
17 Përgjithshëm që e kishte për detyrë të përcaktonte kufijtë e
18 zonave operative. Ditë pas formimit komisioni dorëzoi raport
19 me shkrim i cili tashmë ka numrin e provës P1108, i nënshkruar
20 prej Selimit ku shpjegohet se si u përcaktuan kufijtë mes
21 zonës së Nerodimës dhe të Pashtrikut, bazuar në platformën
22 strategjike të Shtabit të Përgjithshëm dhe të inspektimeve në
23 terren. Mbrojtja përpiqet ta zbehë rëndësinë e këtij komisioni
24 dhe rolin që ka pasur Selimi në të. Sidoqoftë, Shtabi i
25 Përgjithshëm në mënyrë kolektive ka vendosur se ishte

1 pikërisht Selimi ai që do t'i zgjidhte këto problematike mes
2 zonave dhe kjo na tregon se çfarë roli ka pasur ai në terren,
3 dhe çfarë autoriteti ka pasur në terren, dhe rëndësinë e
4 këtyre çështjeve.

5 E njëjta gjë vlen për emërimin e Selimit dhe të akuzuarve
6 të tjerë në këshillimin e personelit. Ka qenë përgjegjës për
7 analizimin, dhënien e rekomandimeve për emërimet e komandës në
8 nivel të Shtabit të Përgjithshëm dhe nivel më të ulët. Për
9 këtë këshillë ne flasim në paragrafët 178 dhe 179 të dosjes
10 tonë përfundimtare.

11 Të marra së bashku provat tregojnë se Rexhep Selimi në
12 mënyrë të vazhdueshme ka udhëtuar mes Shtabit të Përgjithshëm
13 dhe zonave operative ndërkohë që ndodhnin krimet për të cilat
14 janë ngritur akuza. Ai shpërndatë dhe lëshonte urdhra në emër
15 të Shtabit të Përgjithshëm dhe garantonte që politikat dhe
16 urdhrat të zbatoheshin dhe që Shtabi i Përgjithshëm të merrte
17 informacion për atë çka ndodhte në terren.

18 Tani do të flas për drejtorinë e informimit dhe atë
19 politike. Thaçi, Veseli dhe Krasniqi, krahas përgjegjësive të
20 tyre të tjera që kishin pranë Shtabit të Përgjithshëm shtronin
21 autoritet politik të vazhdueshëm. Funksionet politike dhe
22 ushtarake pranë UÇK-së ishin në mënyrë të nevojshme dhe të
23 qëllimshme të ndërlidhura me njëra-tjetrën.

24 Drejtoria e informimit ka qenë nën Hashim Thaçin deri në
25 mesin e nëntorit 1998. Drejtoria lëshonte deklarata politike

1 dhe deklarata të tjera publike, kontrollonte qasjen në media,
2 dhe u kërkonte anëtarëve të UÇK-së, përfshirë komandantët e
3 zonave operative, të merrnin autorizim përpara se të dilnin
4 publikisht. Këto ishin mjete të rëndësishme që përdoreshin për
5 të formuar perceptimin e publikut, për të komunikuar politika,
6 për të shënjestuar oponentë dhe për të zbatuar disiplinën.

7 Prova 879, është një urdhëresë e Shtabit të Përgjithshëm
8 në fillim të korrikut '98, kur u kërkohet komandantëve në të
9 gjitha nivelet të merrnin autorizimin nga drejtoria e
10 informimit përpara se të jepnin intervista.

11 Tani në ekran mund të shihni një intervistë të
12 komandantit të zonës së Drenicës dhe që është anëtar i NKP-së,
13 Sylejman Selimi më 13 gusht 1998. Ai e fillon intervistën duke
14 konfirmuar se kishte marrë autorizimin nga drejtoria e
15 informimit pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për këtë
16 intervistë.

17 Më së paku, në qershor të '98-s Thaçi ka qenë dhe
18 drejtori i drejtorisë politike e cila përfshin edhe Kadri
19 Veselin dhe Jakup Krasniqin, ky i fundit ishte po ashtu
20 zëdhënës i UÇK-së. Në kundërshtim me atë që thotë Mbrojtja
21 drejtoria politike ka ekzistuar dhe ka funksionuar dhe ka qenë
22 Thaçi në krye të saj dhe Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi kanë
23 qenë anëtarë përpara nëntorit të '98-s. ky përfundim
24 mbështetet nga burime të ndryshme të pavarura të cilat ne i
25 kemi trajtuar me hollësi në paragrafin 224 të dosjes tonë.

1 Si provën 790, që është një deklaratë e UNMIK-ut e 2003-
2 shit, dhe P787, që është një deklaratë e SPRK-së nga 2011-ta,
3 vetë Veseli ka konfirmuar rolin e tij pranë drejtorisë
4 politike.

5 Në faqen 2 të provës 787, që na e tregoi z. Tieger më
6 përpara, Veseli thotë:

7 "Unë kam qenë anëtar i Shtabit Kryesor të UÇK-së qysh
8 prej fillimit. Më saktë, kam qenë edhe anëtar i drejtorisë
9 politike. Disa vite kam jetuar në Zvicër, ku kam punuar
10 ngushtësisht me Hashim Thaçin për një kohë të gjatë."

11 Ka dhe prova të tjera gjithashtu që kundërshtojnë atë që
12 thotë Mbrojtja. Të marrin këtu një intervistë në media në
13 2006-n me Rexhep Selimin dhe intervistën që i ka dhënë ZPS-së
14 në 2019-n, ku konfirmohet që Thaçi ka qenë drejtor i
15 drejtorisë në qershor të '98-s. Në ekran tani mund të shihni
16 biografinë zyrtare të z. Thaçi nga faqja e internetit e
17 qeverisë së Kosovës. Aty thuhet se ai ka qenë drejtor i
18 drejtorisë politike qysh prej 1997-s.

19 Edhe më tej sa i takon funksionimit të drejtorisë kemi të
20 dhënë për takimet më 16 dhe 26 qershor 1998 mes përfaqësuesve
21 të autorizuar nga drejtoria politike dhe ndërkombëtarëve,
22 është një dokument ky i sekuestruar prej Jakup Krasniqit.
23 Dokumenti ka marrë numrin e provës 3734. Dhe në faqen 7,
24 thuhet se drejtoria politike drejtonte betejën dhe trajtonte
25 aspektin politik.

1 Më së paku nga korriku 1998, Thaçi dhe Veseli kanë kryer
2 funksione politike dhe kanë takuar përfaqësues ndërkombëtarë
3 si dhe grupe të tjera të armatosura politike dhe të armatosura
4 në Kosovë në terren. Në fillimin e gushtit të '98-s drejtorja
5 politike e Shtabit të Përgjithshëm lëshoi deklaratën politike,
6 që tashmë ka numrin e provës 1D 50, ku ka evidentuar
7 përfaqësuesit politikë, dhe në të njëjtën kohë ka kërcënuar
8 personat që ishin përfshirë në një luftë të posaçme, speciale,
9 se do të trajtoheshin në mënyrë të pamëshirshme.

10 Përpara takimit të 12, 13 nëntorit, ku Mbrojtja pretendon
11 se është emëruar për herë të parë Thaçi, ai ka dhënë
12 deklaratën e parë publike si kreu i drejtorisë politike, ka
13 qenë tetor. Provat për këtë mund t'i gjeni paragrafin 55 të
14 dosjes së Prokurorisë. Mbrojtja e Thaçit pretendon se më 10
15 nëntor Thaçi është prezantuar vetëm si përfaqësues politik
16 gjatë një takimi me Frederick Abrahams. Sidoqoftë, Abrahams
17 ishte i qartë, dhe tha: "Dëshmia ime është që ai është
18 prezantuar si shef i drejtorisë politike". Këtë mund ta gjeni
19 në transkript në faqen 7602.

20 Pas takimit mes nëntorit '98, Thaçi mori drejtimin e
21 drejtorisë politike. Siç mund ta shihni në raportin që keni në
22 ekran, komandantët e zonës i drejtoheshin drejtorisë politike
23 për udhëzime, për agjitacionin, propagandën, krimin e moralit
24 dhe masat parandaluese politike për të ndaluar elementët
25 përçarës dhe tradhtarë. Mbrojtja e Thaçit pretendon në

1 paragrafin 307 të dosjes së vet se ZPS-ja nuk ka arritur të
2 vërtetojë se ky raport i referohet Thaçit dhe jo Demaçit, Adem
3 Demaçit. Së pari, i referohet drejtorisë të Shtabit të
4 Përgjithshëm që drejtohej nga z. Thaçi dhe jo z. Demaçi. Më
5 tej, Mbrojtja përpiqet në mënyrë të vazhdueshme të thotë që
6 ishte Adem Demaçi ai që kishte autoritet dhe pozicion, por kjo
7 është e pabazuar. Demaçi kishte një rol të kufizuar në
8 krijimin e institucioneve të Kosovës, por ai nuk ishte anëtar
9 i Shtabit të Përgjithshëm. Edhe ai ishte në vartësi të Thaçit.

10 Krahës rolit politik, Kadri Veseli gjithashtu ka qenë
11 shefi i drejtorisë informative. Fillimisht, shërbimi
12 informativ ka qenë një përgjegjësi që e ndanin anëtarë të
13 ndryshëm të Shtabit të Përgjithshëm.

14 Në maj të '98-s, komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm,
15 sikurse është rasti provës P155, raportonin për veprimtaritë e
16 shërbimit të zbulimit ose të shërbimit informativ. Në ekran
17 është shpjegimi i z. Veseli ku thotë se në qershor të '98-s
18 Shtabi i Përgjithshëm vendosi të krijonte drejtorinë
19 informative, e njohur ndryshe si G2. Në dosjen e tyre,
20 Mbrojtja në paragrafët 295, 296 i referohen kësaj që ka thënë
21 z. Veseli, por harrojnë provat që ka për këto drejtori përpara
22 nëntorit të '98-s, dhe thotë që kanë qenë thjesht aspirata dhe
23 tituj për ndere, por ne kemi fakte që tregojnë të kundërtën.

24 Pas vendimit të Shtabit të Përgjithshëm për të krijuar
25 drejtorinë informative, Veseli ka qenë i pranishëm në terren

1 në zona të shumta. Kur krijoheshin njësitet informative ato
2 ishin pjesë e strukturës që koordinonin të akuzuarit dhe
3 anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm që inspektonin, i
4 organizonin dhe i mbikëqyrnin.

5 Z. Pace e diskutoi rastin e Sabit Gecit që drejtonte një
6 prej këtyre njësiveve në zonën e Drenicës dhe i raporte
7 drejtpërsëdrejti Kadri Veselit dhe Shtabit të Përgjithshëm.

8 Në zonën e Dukagjinit shefi i shërbimit informativ, Faton
9 Mehmetaj, u emërua në fund të qershorit të '98-s. Sikurse e
10 kemi thënë në dosjen tonë, shefi i zbulimit në Dukagjin dhe
11 sektori i tij shënjestronin viktimat dhe i ndalonin në
12 Jabllanicë dhe kundërshtarë të tjerë gjatë periudhës e cila
13 përmendet në aktakuzë.

14 Kadri Veseli, si dhe Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, Jakup
15 Krasniqi dhe Lahi Brahimaaj kanë qenë të pranishëm në terren në
16 zonën e Dukagjinit dhe janë takuar me komandën e zonës së
17 Dukagjinit në qershor dhe korrik të '98-s. Ata kanë qenë në
18 dijeni të rolit me Mehmetaj dhe kjo duket ndër të tjera, mund
19 ta shihni në provën 2D26 dhe P13191.

20 Në fillim të gushtit të '98-s, ndërkohë që z. Veseli
21 kishte dhe rolin politik dhe atë të zbulimit, drejtorja
22 politike publikisht bëri të ditur se Mehmetaj ishte
23 përfaqësues politik përkrah Thaçit dhe Krasniqit. Këtë mund ta
24 gjeni në provën 1D50. Më pak se një muaj më mbrapa, Shtabi i
25 Përgjithshëm, në një urdhëresë të nënshkruar prej Rexhep

1 Selimit emëroi Mehmetajn si shef të shërbimit të informimit në
2 zonën e Dukagjinit. Ky dokument gjendet në provën me numër
3 1947.

4 Si në Drenicë dhe në Dukagjin, personeli i zbulimit
5 kishte synim të shënjestronte oponentët edhe të kontrollonte
6 zonat e ndalimit në Kosovë dhe në pjesën veriore të
7 Shqipërisë, në Shqipërinë e veriut. Kjo praktikë është në
8 përputhje me të gjitha rregulloret, më konkretisht rregullorja
9 që ka marrë numrin provës 890, e cila përcakton detyrat e
10 zbulimit, ku përfshihet evidentimi i personave që ishin të
11 rëndësishëm për armikun, qoftë këta brenda vendit dhe jashtë
12 vendit, detyrat për zbatimin e këtyre urdhëresave si rrëmbimet
13 dhe vrasjet e këtyre personave.

14 Përfshirja e sektorit të zbulimit po ashtu është në
15 përputhje me dokumentin që keni aktualisht në ekran. Versioni
16 në ekran që keni aktualisht është gjetur në kompjuterin e z.
17 Krasniqi dhe kemi dhe një version tjetër që është kopje
18 fizike. Përshkrimi i punës, që është pika e tretë nga fundi,
19 përcakton detyrat e zbulimit që përfshijnë "përpunimin e
20 materialeve që mbledhen nga personat e ndaluar dhe të
21 burgosurit civilë".

22 Brenda zonave, raportet e zbulimit përgatiteshin në
23 mënyrë të rregullt. Shefat e zbulimit nëpër zona përpunonin
24 apo më saktë përgatisnin dhe ua përcillnin këto raporte
25 komandantëve të zonave dhe Shtabit të Përgjithshëm. Shefi i

1 zbulimit në zonën e Pashtrikut, për shembull, ka dhënë dëshmi
2 se ka printuar tri kopje të raporteve të tij, një prej të
3 cilave i është dërguar Shtabit të Përgjithshëm.

4 Ndonëse Mbrojtja e Veselit në dosjen e vet thotë që ai
5 nuk ka qenë i pranishëm në Kosovë, paragrafi 266 i dosjes së
6 Prokurorisë e trajton pikërisht këtë pikë. Gjatë kohës që nuk
7 ka qenë në fillim të '99-s, të tjerë, përfshirë dhe persona të
8 caktuar nga z. Veseli, kanë ushtuar funksionet e zbulimit në
9 nivel të Shtabit të Përgjithshëm. Ai po ashtu kishte
10 komunikime, kishte mundësi për të komunikuar dhe kishte mjete
11 komunikimi në dispozicion, çka do të thotë se kishte mundësi
12 të koordinonte me personat që ishin të pranishëm në Kosovë kur
13 nuk ishte ai i pranishëm.

14 Veseli pretendon se emërimi i tij në SHIK, që është bërë
15 i ditur publikisht më 2 prill 1999, përfundoi rolin e tij
16 pranë Shtabit të Përgjithshëm. Sidoqoftë, ne kemi prova që
17 tregojnë se ai ka pasur vijimësi të këtij roli. Këtë mund ta
18 gjeni në paragrafin 268 të dosjes sonë.

19 Vetë Veseli e ka përshkruar Shërbimin Informatik të
20 Kosovës si një mision që ishte i shkëputur nga UÇK-ja. Dhe
21 këtë e ka bërë në një intervistë, që aktualisht ka numrin e
22 provës 1859, dhe e ka thënë këtë në një deklaratë publike që
23 ka bërë të ditur mbylljen e SHIK-un në vitin 2008. Kjo është
24 prova P4213.

25 Do të shohim një fragment të kësaj videoje. Ka titra në

1 anglisht dhe në shqip, çka do të thotë se nuk ka nevojë për
2 përkthim me gojë.

3 [Luhet videoincizimi]

4 "VESELI: Shërbimi Informativ i Kosovës ka nisur punën e
5 vet që nga fillimvitet e '90-ta, me krijimin e Ushtrisë
6 Çlirimtare të Kosovës dhe më vonë pjesë e Qeverisë së
7 Përkohshme të Kosovë me kryeministër Hashim Thaçin. Në të
8 gjitha periudhat e veprimtarisë së vet, Shërbimi Informativ i
9 Kosovës ka punuar me mision legjitim për çlirimin e vendit dhe
10 krijimin e shtetit të Kosovës. Pas çlirimit të vendit në vitin
11 1999, Shërbimi Informativ i Kosovës ka ruajtur vazhdimësinë e
12 misionit të vet".

13 Z. QUICK: [Përkthim] Në qershor të '99-s SHIK-u kishte
14 përafërsisht 30 anëtarë, përfshirë edhe nga persona nga
15 shërbimi i zbulimit të zonave. Pavarësisht përfshirjes së
16 drejtpërdrejtë në krimet kur ka qenë shefi i zbulimit në zonën
17 e Llapit, Latif Gashi ishte drejtori i përgjithshëm i SHIK-ut.

18 Pra, të marrin këto prova së bashku, kuptojmë se ka pasur
19 një sistem zbulimi të vazhdueshëm dhe të strukturën nën
20 kompetencën apo nën autoritetin e Veselit.

21 Flasim për policinë tani që bashkëpunonte ngushtësisht me
22 shërbimin informativ lidhur me krimet për të cilat ngrihen
23 akuzat. Nga fundi i pranverës së '98-s, njësoj si dhe shërbimi
24 informativ, policia ushtarake ka qenë operative në zonat ku të
25 akuzuarit dhe anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm kanë qenë të

1 pranishëm dhe kanë ushtruar autoritetin e tyre, po ashtu kanë
2 qenë pjesë e strukturave në zonat ku të akuzuarit dhe anëtarët
3 e Shtabit të Përgjithshëm koordinonin, inspektonin,
4 organizonin dhe mbikëqyrnin aktiviteti.

5 Në përputhje me detyrat që janë përcaktuar në rregulloret
6 provizore që i jepnin kompetenca të gjera policisë, policia
7 ushtarake në terren kontrollonte punktet, ndalonte civilët,
8 merrte të dhënat personale, arrestonte, ndalonte, keqtrajtonte
9 dhe vriste oponentë, sikurse e kemi përcaktuar me hollësi në
10 dosjen tonë përfundimtare.

11 Të paktën nga fundi i nëntorit 1998, Shtabi i
12 Përgjithshëm kishte emëruar zyrtarisht anëtarin e NKP-së
13 Fatmir Limaj si shefin e drejtorisë së policisë ushtarake.

14 Siç jemi shprehur në paragrafët 283 dhe 285 të dosjes
15 sonë, policia e zonës i raportonte drejtorisë, e cila
16 mbikëqyrte emërimet, logjistikën, trajnimet, inspektimet dhe
17 qendrat e ndalimit të Shtabit të Përgjithshëm.

18 Më 2 prill 1999, emërimi i Rexhep Selimit si ministri i
19 rendit publik pranë Qeverisë së Përkohshme u bë publik. Të
20 paktën nga fundi i qershorit 1998 ai kishte ndryshuar,
21 domethënë kishte filluar të vishej me një uniformë të zezë. Në
22 dy slajdet që do të shohim tani, në fakt, që ka numrin e
23 provës 4228, këto janë fotografi që janë bërë një ditë pasi
24 është nënshkruar Marrëveshja e Kumanovës. Këtu, pra, mund ta
25 shihni pikërisht z. Rexhep Selimi në fund të tavolinës që ka

1 një radio dhe është i veshur me të zeza. Edhe është në të
2 njëjtin pozicion dhe në fotografinë e dytë. Anëtarë të tjerë
3 të Shtabit të Përgjithshëm dhe zyrtarë të Qeverisë së
4 Përkohshme, përfshirë Hashim Thaçin janë me uniformë me lara-
5 lara, kamuflazh.

6 Katër ditë më pas, më 14 qershor 1999, KosovaPress, dhe
7 Radio Free Kosova, publikuan komunikatën e parë të Ministrit
8 të Rendit Publik e cila ishte nënshkruar nga z. Selimi. Në
9 komunikatë thuhej se rikthimi i popullatës do të ishte nën
10 drejtimin e policisë ushtarake të UÇK-së, e cila përshkruhet
11 si "nukla e forcës policore të ardhshme", dhe po aty flitet
12 për mandatin që kishin "forcat e rendit publik". Komunikata në
13 fjalë ka numrin P515_ET.69 dhe P814_ET.35.

14 Forcat e rendit publik që dolën në qershor të '99-s
15 kryesisht përbëheshin prej personelit të policisë ushtarake.
16 Dokumente të sekuestruara nga Selimi konfirmojnë këtë
17 strukturë dhe funksionin e Ministrisë së Rendit Publik,
18 përfshirë edhe aktivitetet e policisë në terren në verën e
19 1999-s. Siç kemi thënë në paragrafët 301, 302 të dosjes
20 përfundimtare, këto dokumente të sekuestruara përfshijnë
21 organigramat, të dhëna për personelin, raportin, përfshirë dhe
22 nga komandantët e policisë në zona, mjete identifikimi dhe
23 formularë regjistrimi nga anëtarët e UÇK-së në zona të
24 ndryshme operative. Këto të dhëna lidhen me persona të shumtë
25 të përfshirë në krimet për të cilat ngrihen akuzat.

1 E kam diskutuar SHIK-un dhe Ministrinë e Rendit Publik që
2 ishin një vazhdimësi e aspektit të zbulimit dhe policisë së
3 UÇK-së. Të akuzuar të tjerë dhe anëtarë të Shtabit të
4 Përgjithshëm po ashtu kanë pasur role të mbivendosura në
5 Qeverinë e Përkohshme. Në ekran aktualisht mund të shihni
6 përbërjen e Qeverisë së Përkohshme në pranverën dhe verën e
7 1999-s. Kutitë me blu të errët janë anëtarët e Shtabit të
8 Përgjithshëm që janë emëruar në pozicionet e tyre pranë
9 Qeverisë së Përkohshme. I njëjti grup personash të besuar edhe
10 një herë marrin shumicën dërmuese të vendimeve dhe kishin
11 mundësinë të kontrollojnë dhe të ushtronin autoritet në këtë
12 qeveri të përkohshme, përmes kësaj qeverie të përkohshme.
13 Kornizat me të verdha tregojnë të akuzuarit. Ato me të zezë,
14 anëtarët e NKP-së.

15 Një nga kutizat me ngjyrë bojë qelli ka një post që ka
16 qenë i caktuar për LDK-në i cili mbeti vend vakant. Për këtë
17 foli znj. Lawson. Janë dhe katër pozicione që kanë pasur
18 anëtarët e LBD-së me ngjyrë bojë qelli. LBD-ja e mbështeste
19 dhe ishte në të njëjtën linjë me LBD-në.

20 Sa i takon pretendimeve të Mbrojtjes së Krasniqit se ai
21 ishte emëruar si ministër i ndërtimit nga LBD-ja, mund të
22 themi që s'kemi asnjë provë që e konfirmon këtë dhe nuk ka
23 asnjë lloj rëndësie kjo. Edhe sikur të ketë qenë LBD-ja që e
24 ka propozuar këtë pozicion, nuk ndryshon faktin se z. Krasniqi
25 ka qenë zëdhënës i Qeverisë së Përkohshme, dhe ky nuk ka qenë

1 një post i propozuar nga LBD-ja, as nuk ndikon për faktin që
2 ka qenë anëtar për një kohë të gjatë i Shtabit të Përgjithshëm
3 dhe i UÇK-së.

4 Qeveria e Përkohshme u krijua pas negociatave të
5 Rambujesë. Në fund të shkurtit 1999, anëtarë të Shtabit të
6 Përgjithshëm konfirmuan që Thaçi ishte kryeministër dhe
7 Sylejman Selimi komandant i përgjithshëm. Emërimi i Sylejman
8 Selimit dhe më pas ricaktimi i tij tregojnë një shembull të
9 qartë dhe të hershëm se si të akuzuar dhe anëtarë të NKP-së
10 përdornin Qeverinë e Përkohshme si një mjet paralel për të
11 ushtruar autoritetin e tyre. Dhe do të vazhdonin ta përdornin
12 për këtë qëllim dhe të zbatonin planin e tyre të përbashkët.

13 Emërimi i mëparshëm i Sylejman Selimit u bë pas takimit
14 të mëparshëm të anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm dhe
15 komandantëve të zonave gjatë kohës që delegacioni i Rambujesë
16 ishte jashtë vendit. Megjithatë, në kundërshtim me
17 parashtrimet e Mbrojtjes, zgjedhja e Sylejman Selimit si
18 komandant i përgjithshëm në shkurt të '99-s nuk ishte *coup*.
19 Sylejman Selimi vetë e ka pranuar këtë gjatë dhënies së
20 dëshmisë së tij.

21 Kjo ngjarje nuk ishte siç e pretendon Mbrojtja e Thaçit
22 një shembull ilustrues, emblematic i autoritetit të
23 komandantëve të zonave mbi Shtabin e Përgjithshëm.

24 Për të mos thënë në mbledhjet, takimet e shkurtit të
25 1999-s ku u bë ndryshimi i komandës, debatimi ku kjo u

1 diskutua, pra, nuk kishte kundërshtime. Por, vetëm pretendimi
2 në asnjë mënyrë nuk e mbështet përfundimin në të cilin arrin
3 Mbrojtja.

4 Ndryshe, autoriteti i vërtetë i Shtabit të Përgjithshëm
5 është i vërtetuar nga rrethanat rreth kësaj dhe veprimet që
6 kanë ndërmarre. Së pari, Shtabi i Përgjithshëm vetëm konfirmoi
7 ndryshimin e komandës pas kthimit të anëtarëve të delegacionit
8 të Rambujesë. Provat që mbështesin këtë gjenden në paragrafin
9 148 të Prokurorisë.

10 Ndoshta shembulli më i spikatur, komandantët e zonave
11 përfundimisht u pajtuan me delegacionin e Rambujesë, përfshirë
12 të akuzuarit, se marrëveshja që rezultonte nga kjo, nga këto
13 bisedime duhej të nënshkruhej.

14 Thaçi nuk u angazhua në një përpjekje apo punë për të
15 bindur, për të përkëdhelur apo për t'ju lutur atyre që të
16 arrinin këtë rezultat, siç sugjeron Mbrojtja pa mbështeje në
17 prova. Në të kundër dhe anëtarët e tjerë të Shtabit të
18 Përgjithshëm, përfshirë të akuzuarit e tjerë, u konsultuan me
19 vartësit e tyre të nivelit të lartë ushtarak në terren për të
20 siguruar, për të garantuar pranimin e një marrëveshje që do të
21 kërkonte angazhimin e tyre për ta përmbushur atë.

22 Prova P227, në ekran, përmend qëndrimet pozitive të
23 shprehura nga ushtria lidhur me Marrëveshjen e Rambujesë. Kjo
24 vjen pas konsultimit të Shtabit të Përgjithshëm me komandantët
25 e zonave dhe vë në pah se Shtabi i Përgjithshëm do të marrë

1 vendimin përfundimtar. Në mënyrë të veçantë i caktuar nga të
2 gjithë të akuzuarit dhe anëtarë të tjerë të Shtabit të
3 Përgjithshëm, kjo nënshkruhet nga Sylejman Selimi, edhe pse
4 ishte caktuar.

5 Me datën 2 prill 1999, Thaçi në mënyrë publike shpalli
6 ministrat e Qeverisë së përkohshme, mes tyre ishte Azem Syla
7 dhe tani komandant i përgjithshëm ai që do të ishte komandant
8 i përgjithshëm në pozicionin e ministrit të Mbrojtjes. Më vonë
9 në prill 1999, Agim Çeku i cili ishte bashkëpunëtor i afërt i
10 Thaçit dhe Veselit u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm, shef
11 shtabi i Shtabit të Përgjithshëm.

12 Sylejman Selimi u emërua komandant i gardës kombëtare. Në
13 këtë pozitë, ai i raportonte Agim Çekut dhe ishte përsëri
14 vartës i Azem Syles, tani ministër e mbrojtjes. Kjo
15 marrëveshje raportimi është evidentuar nga raportet me shkrim
16 të Çekut që i dorëzonte Sylës, siç janë cituar në paragrafët
17 129, 165 të dosjes të Prokurorisë dhe dëshmia e vetë Sylejman
18 Selimit. Në transkriptin 25239.

19 Është kjo seri ngjarjesh, pra, të para në kontekstin e
20 duhur që ilustron gjendjen reale në terren. Shtabi i
21 Përgjithshëm dhe Qeveria e Përkohshme e udhëhequr nga Hashim
22 Thaçi mbanin kontrollin e përgjithshëm të gjithanshëm.

23 Mbrojtja e Thaçit në mënyrë të gabuar pretendon se nuk ka
24 prova se ministrat e Qeverisë së Përkohshme, Agim Çeku si shef
25 i shtabit të Shtabit të Përgjithshëm i raportonte Hashim

1 Thaçit si kryeministër.

2 Ndërsa Shtabi i Përgjithshëm dhe Qeveria e Përkohshme
3 vazhduan të merrnin vendimet përmes procesit të shqyrtimit apo
4 të vendimmarrjes kolektive, Thaçi kishte autoritetin për të
5 zbatuar këto vendime, përfshirë përmes emërimeve dhe dekreteve
6 dhe linjave të raportimit që i shkojnë atij.

7 Për shembull, Thaçi emëroi Çekun pas konsultimeve me
8 Shtabin e Përgjithshëm dhe në bazë të propozimit të Ministrisë
9 së Mbrojtjes. Kjo u konfirmua nga Bislim Zyrapi i cili
10 diskutoi dhe foli për këtë ndryshim të personelit në mënyrë të
11 drejtpërdrejtë e diskutoi këtë me z. Thaçi dhe z. Selimi.
12 Sylejman Selimi, në faqen e transkriptit 25540 deri 1,
13 gjithashtu u pajtua me dëshminë e Selimit dhe Rexhep Selimit.
14 Sylejman Selimi deklaroi se Hashim Thaçi kishte krijuar --
15 krijoi Qeverinë e Përkohshme dhe si kryeministër në mënyrë
16 zyrtare mori përgjegjësitë e UÇK-së, "gjeneral-komandant i
17 përgjithshëm". Krasniqi në librin e tij "Kthesa e Madhe", në
18 të njëjtën mënyrë konfirmoi se Shtabi i Përgjithshëm i dha
19 pushtet dhe autoritet kryeministrit që të formojë Qeverinë e
20 Përkohshme.

21 Për më tepër, përveç emërimit të Çekut, ishte Thaçi po
22 ashtu i cili emëroi Sylën si ministër i mbrojtjes në të
23 njëjtën mënyrë siç kishte emëruar ministrat e tjerë, përfshirë
24 Selimin dhe Veselin. Të dy, Selimi dhe Veseli konfirmuan se
25 Veseli, si kreu i SHIK-ut, i raportonte Thaçit. Kjo është në

1 paragrafin 266 dhe 514 të dosjes tonë.

2 Në pranverë të 1999-s Çeku i raportonte Azem Sylës si
3 ministër i mbrojtjes, i cili nga ana e tij i raportonte Thaçit
4 si kryeministër.

5 Më tej, në momentin e nxjerrjes së dekreteve, për
6 shembull, Dekreti 83/'99-s që është në ekran tani, Thaçi
7 ngarkon ministrat e Qeverisë së Përkohshme dhe shtabin, u
8 jepte detyra ministrave të Qeverisë së Përkohshme dhe Shtabit
9 të Përgjithshëm. Ky dekret ka të bëjë me formimin, krijimin e
10 Gardës Kombëtare. Dhe në të, Thaçi i jep detyrë Shtabit të
11 Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes me përgjegjësi të
12 ndarë për të zbatuar këtë dekret.

13 Diapozitivi i radhës tregon se si Kryeministri Hashim
14 Thaçi, me propozim të Shtabit të Përgjithshëm nxori vendimin
15 në maj të 1999-s për ristrukturimin e UÇK-së me nënshkrimin e
16 kryeministrit në pjesën e nënshkrimit dhe vulën e Shtabit të
17 Përgjithshëm. Duke bërë këtë, Thaçi i dha detyrë ministrit të
18 mbrojtjes për hartimin e skemës organizative të formimit për
19 secilën njësi të UÇK-së dhe strukturën e tyre.

20 Sipas fjalëve të vetë Agim Çekut, të raportuara në provën
21 materiale P4228, pak kohë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së
22 Kumanovës, "çdo vendim i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës
23 [...] do të konsiderohej si urdhër për Ushtrinë Çlirimtare të
24 Kosovës."

25 Në fakt, Thaçi dhe jo Çeku, e nënshkroi marrëveshjen në

1 të cilën UÇK-ja pranoi që të demilitarizohej, pra. Thaçi
2 nënshkroi dokumentin në cilësinë e komandantit të
3 përgjithshëm. John Duncan, vetë diplomati i cili e hartoi
4 marrëveshjen konfirmoi se komandanti -- titulli komandant i
5 përgjithshëm u shtua vetëm pasi Thaçi u bë nënshkruesi me
6 emër.

7 Në një shembull tjetër i gushtit 1999. Thaçi i dërgon një
8 letër kreut të -- shefit të UNMIK-ut, Bernard Kouchner, me anë
9 të të cilës i kërkon që individë të caktuar, përfshirë
10 ministrin e mbrojtjes Azem Syla, të lejohen që të mbajnë armë
11 në mënyrë ligjore, pra, me leje. Kjo është prova P880. Thaçi
12 nënshkroi këtë letër si Komandant i Përgjithshëm i UÇK-së.

13 Nuk mund të ketë asnjë dyshim lidhur me pozicionin e
14 Thaçit dhe autoritetin e tij si kryeministër, të cilën ai e
15 mori dhe e ushtroi përmes një procesi vendim-marrje kolektive
16 të Shtabit të Përgjithshëm dhe Qeverisë së Përkohshme.

17 Ndërkohë që forcat serbe tërhiqeshin, u tërhoqën në
18 qershor të 1999-s, UÇK-ja dhe Qeveria e Përkohshme vazhduan të
19 ndiqnin, pra, rrugët klasike të marrjes së pushtetit. UÇK-ja
20 dhe qeveria, anëtarë të UÇK-së dhe të Qeverisë së Përkohshme
21 morën, kapën infrastrukturën kyçe të shtetit dhe institucionet
22 publike. Ata instaluan kryetarët e komunave, mbajtën mbledhje
23 dhe takime, nxorën dekrete dhe vendime. Dhe anëtarët e UÇK-së
24 vazhduan të shënjestronin kundërshtarët në të gjitha zonat
25 operative siç janë paraqitur në aktakuzë.

1 Tani pas trajtimit të Shtabit të Përgjithshëm dhe
2 Qeverisë së Përkohshme, do të trajtoj zonat e krijuara dhe që
3 vepronin nën autoritetin e tyre, Drenica, Dukagjini,
4 Pashtriku, Shala, Llapi dhe Nerodime u krijuan në mënyrë
5 formale, pra zyrtare, dhe komandantët e zonave u emëruan dhe u
6 konfirmuan nga Shtabi i Përgjithshëm gjatë pranverës dhe verës
7 1998. Karadaku u krijua më vonë, dhe komandanti i saj u emërua
8 më vonë në 1998-n. Gjatë të gjithë periudhës së mbuluar, të
9 përfshirë në aktakuzë, UÇK-ja gjithashtu mbajti një seri
10 bazash në veri në Shqipërisë.

11 Siç paraqitet në aktakuzë vendet, vendndodhjet e krimeve
12 dhe vende të tjera në zona në veri të Shqipërisë, anëtarë të
13 UÇK-së, përfshirë policinë, shërbimet e zbulimit dhe njësitet
14 speciale shënjestruan, mbajtën të ndaluar, keqtrajtuan,
15 torturuan, vranë dhe i zhdukën kundërshtarët.

16 Siç vërtetohet nga provat si zonat dhe bazat në veri të
17 Shqipërisë u bindeshin urdhrave të Shtabit të Përgjithshëm dhe
18 udhëzimeve, dhe respektonin autoritetin e Shtabit të
19 Përgjithshëm. Kjo është -- shprehet në mënyrë -- është sqaruar
20 në mënyrë të hollësishme në dosjen e Prokurorisë, dhe unë do
21 të diskutoj shembuj të mëtejshëm sot.

22 Mbrojtja në mënyrë të gabuar pretendon se asnjë shtab
23 superepror nuk kishte nxjerrë urdhra për zonën e Dukagjinit.
24 Provat demonstrojnë, provojnë se komanda e zonës ka respektuar
25 autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm dhe i është bindur

1 urdhrave të tyre.

2 Mënyra se si kjo ka funksionuar në praktikë ilustruhet
3 nga një seri të dhënash të kohës së atëhershme nga fillimit të
4 korrikut 1998 menjëherë pas krijimit të zonës. Këto janë marrë
5 dhe sekuestruar nga burime të ndryshme.

6 Në ekranin tuaj tani kemi një vendim të 1 korrikut 1998
7 të Shtabit të Përgjithshëm me anë të cilit ndalohet komunikimi
8 me gazetarët. Më tej thuhet drejtoria për informim e Shtabit
9 të Përgjithshëm vendos për të informuar publikun, dhe vetëm
10 zëdhënësi i UÇK-së ka të drejtë të bëjë publike qëndrimet e
11 UÇK-së.

12 Diapozitivi në vijim përmban shënimet, procesverbalin e
13 një takimi pune në komandën e Dukagjinit i mbajtur po të
14 njëjtën ditë, 1 korrik. Ky takim, në këtë takim mori pjesë
15 Rexhep Selimi i cili përdorte pseudonimin e tij Agron, që
16 është edhe pseudonimi që ka përdorur në zonën e Dukagjinit. Ai
17 sipas procesverbalit të këtij takimit thuhet të ketë thënë se
18 zëdhënësi paraqet pikëpamjet e Shtabit të Përgjithshëm. Kjo
19 është në përputhje me vendimet që sapo pamë.

20 Pastaj me datë 2 korrik 1998 njoftimi i dërguar nga
21 komandanti i zonës Haradinaj Shtabit të Përgjithshëm. Ai
22 informon dhe këmbëngul që shtabi i zonës së Dukagjinit ka
23 "Zbatuar me përpikëri urdhrin e datës 1 korrik 1998, lidhur me
24 komunikimin e median dhe gazetarët".

25 Dhe në fund kemi një paralajmërim që Haradinaj i ka

1 dërguar vartësve të shtabit në zonën e Dukagjinit lidhur me
2 vendimin e Shtabit të Përgjithshëm të 1 korrikut. Në
3 përgjithësi, të gjitha këto prova tregojnë zbatimin e
4 menjëhershëm dhe efektiv dhe respektimin e urdhrave të Shtabit
5 të Përgjithshëm. Gjithashtu përforcon nevojën për të marrë
6 parasysh provat në tërësi.

7 Jo vetëm Shtabi i Përgjithshëm nxirrte urdhra që
8 respektoheshin, por të akuzuarit dhe Shtabi i Përgjithshëm
9 gjithashtu në mënyrë personale të drejtpërdrejtë ushtronin
10 autoritetin e tyre. Për shembull, kur Shtabi i Përgjithshëm i
11 përfaqësuar nga Thaçi, Selimi, Brahimaj dhe anëtarë të tjerë
12 të Shtabit të Përgjithshëm, hoqën nga detyra Tahir Zemajn i
13 cili ishte zgjedhur në mënyrë -- nga populli dhe me
14 mbështetjen e të gjithëve dhe rivendosën Haradinajn si
15 komandant të zonës.

16 Komandantët e zonave gjithashtu i raportonin Shtabit të
17 Përgjithshëm, përfshirë për çështje specifike konkrete për të
18 cilat Shtabi i Përgjithshëm kishte urdhëruar dhe kërkuar të
19 informohej. Në ekran kemi urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm
20 për komandantët e zonave që të raportojnë për çështje konkrete
21 specifike, probleme dhe propozime. Temat e saktësuara shkojnë
22 nga udhëheqja tek çështje personale, koordinimi me zonat,
23 organet civile, kërkesat për Shtabin e Përgjithshëm.

24 Diapozitiva në vijim përfshin fragmente nga zona e
25 Llapit, përgjigja e zonës së Llapit e cila përputhet me temat

1 për të cilat Shtabi i Përgjithshëm kishte kërkuar raportim.
2 Temat e mbuluara përfshijnë policinë ushtarake, mbrojtjen
3 civile, bashkëpunimin me zonat e tjera, kërkesa për municion
4 dhe armë, propozime për emërimet e komandave në brigadë dhe në
5 zonë. Ky informacion i dhënë nga zonat pastaj transmetohej në
6 formë raporti zëvendëskomandantit Krasniqi. Aty përfshihet
7 informacion që ka të bëjë me raportimin e zonës së Llapit,
8 përfshirë emërimin në zonën e Llapit, propozimet, mbrojtja
9 territoriale dhe civile, policia ushtarake, dhe bashkëpunimi
10 me zonat e tjera.

11 Provat e cituara, dhe mes të tjerave, paragrafi 363 i
12 dosjes së Prokurorisë tregon, demonstroi se, përveç
13 respektimit të detyrimeve për raportim, komanda e zonës së
14 Llapit zbatoi urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm lidhur me
15 organizimin, operacionet, qendrat e ndalimit. Dhe kjo u
16 konfirmua nga komandanti Mustafa dhe shefi i shtabit të tij.
17 Pra kjo u konfirmua në Gjykatë.

18 Mbrojtja pretendon se të ashtuquajturit -- e
19 ashtuquajtura linja, vija e Podujevës, incidenti i linjës së
20 Podujevës tregon rezistencën që shfaqën komandantët e zonave
21 ndaj Shtabit të Përgjithshëm apo udhëzimeve të tyre.
22 Megjithatë, ky ishte një incident i vetëm i izoluar. Refuzimi
23 nga ana e Rrustem Mustafës për të ndjekur -- për të zbatuar
24 kërkesën e Zyrapit lidhur me këtë pikë, nuk është -- nuk mund
25 të zhbëjë provat e konfirmuara dhe të plotësuara lidhur me

1 autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm në zonën e Llapit.
2 Gjithashtu kjo duhet të merret parasysh edhe të shqyrtohet në
3 kontekstin e vendimeve të mëparshme të Shtabit të
4 Përgjithshëm.

5 Me 19 nëntor 1998, Shtabi i Përgjithshëm komunikoi se
6 policia serbe do të tërhiqej nga pozicionet e tyre, përfshirë
7 nga Llapi, dhe kërcënoi se nëse nuk do të tërhiqeshin,
8 patrullat e UÇK-së do të godisnin. Qëndrimi i Shtabit të
9 Përgjithshëm pasqyrohet në provën materiale P668 dhe u
10 shpërnda dhe u diskutua në zona. Kjo vërtetohet, për shembull,
11 dhe tregohet në provën P3190, faqja U002-0275. Megjithatë ky
12 ishte udhëzimi i Shtabit të Përgjithshëm në fund të nëntorit
13 1998, nuk është për t'u çuditur se në fillim të 1999-s forcat
14 e Mustafës lëvizën në vendet që ishin bosh dhe kundërshtuan
15 policinë serbe.

16 Shtabi i Përgjithshëm gjithashtu dha udhëzime të
17 drejtpërdrejta lidhur me krimet për të cilat janë ngritur
18 akuza. Për shembull, në zonën e Drenicës, policia -- në zonën
19 e Drenicës komandanti i policisë ushtarake Sahit Jashari u
20 raportonte të dyve, dhe komandantit të zonës edhe Shtabit të
21 Përgjithshëm. Mbrojtja pretendon të kundërtën dhe shpërfill të
22 dhënat që janë në dosje. Sa i takon -- siç e përmendi z.
23 Tieger më herët, që në maj të 1998-s Sahit Jashari kishte
24 deklaruar se policia ushtarake do të zbatonte urdhrat e dhënë
25 nga Shtabi i Përgjithshëm. Më tej, siç u diskutua në

1 paragrafin 370 të dosjes së Veselit, Sylejman Selimi dëshmoi
2 se Limaj lëshoi një urdhër rreth nëntorit 1998 me anë të të
3 cilit urdhëronte policinë ushtarake t'i raportonte atij "në
4 mënyrë hierarkike". Provat e tjera gjithashtu konfirmojnë këtë
5 linjë të raportimit.

6 Në ekran keni tani shënimet të dorëshkruara të Rexhep
7 Selimit lidhur me takimin për çështje organizative në fillim
8 të dhjetorit 1998, midis drejtorit të policisë ushtarake Limaj
9 dhe komandantëve të policisë ushtarake në zonën e Drenicës. Më
10 vonë, në fillim të shkurtit 1999, Limaj urdhëroi zonën --
11 komandën e zonës së Drenicës që të dërgonte listën e
12 kandidatëve për policinë ushtarake që të shoqërohej me
13 fotografi për secilin kandidat dhe të dhënat edhe hollësitë e
14 nevojshme. Qëllimi ishte organizimi i mëtejshëm i njësive të
15 policisë ushtarake të UÇK-së. Rreth dy javë më vonë Sahit
16 Jashari dha këtë informacion lidhur -- për të gjitha -- për
17 gjithë pjesëtarët e policisë në nivel të brigadës dhe të
18 zonës, përfshirë bashkë me fotografi. Kjo është qartësisht në
19 përgjigje të urdhrit të z. Limaj dhe në kundërshtim dhe
20 parashtrim -- dhe kundërshton parashtrimin e Selimit në
21 paragrafin 245 të dosjes së tyre.

22 Drejtoria e policisë ushtarake gjithashtu pranoi kërkesa
23 nga dhe i dha udhëzime policisë në zona të tjera. Në ekran
24 kemi një kërkesë nga komandanti i policisë ushtarake në zonën
25 e Nerodimës, Isak Musliu, ku kërkon rregulloret e policisë

1 ushtarake, qartësime, sqarime dhe logjistika. Me 18 dhjetor,
2 siç shihet në diapozitivin e radhës, kreu i drejtorisë së
3 policisë ushtarake dha sqarime lidhur me rregulloret,
4 hierarkinë dhe autoritetin për të arrestuar. Fragmentet e
5 shënimeve të Selimit në diapozitivin tjetër lidhur me
6 inspektimin në zonën e Nerodimës në fillim të korrikut 1999.
7 Në fund, kemi një fragment tjetër. Dhe në numrin 10, shënohen
8 ndërlikimet apo vështirësitë e kaluara lidhur me autorizimin
9 për të arrestuar, duke theksuar se çështja është trajtuar pas
10 pranimi të rregulloreve relevante të policisë.

11 Në fund, nuk ishte vetëm drejtoria e policisë ushtarake
12 që mund të nxirrte urdhra për policinë ushtarake në terren.
13 Për shembull, në dhjetor 1998, Shtabi i Përgjithshëm, përmes
14 një sërë çështje urdhëroi -- të urdhëruara nga Jakup Krasniqi,
15 drejtoria financiare, drejtoria e administratës civile,
16 kërkuan kontribute përmes Fondit Vendlindja Thërret nga
17 punëtorët që punon jashtë vendit, dhe urdhëruan policinë që të
18 mbledhte këto kontribute financiare. Urdhrat janë në provat
19 materiale P3681, P3684, dhe P3686. Një bllok shënimesh i
20 asokohe në një pikë të shënuar aty nga fillimi i janarit, në
21 fillim të janarit përmendet ky urdhër. Dhe në diapozitivin e
22 radhës, dhe kjo nuk duhet të shfaqet për publikun, shohim se
23 si policia ushtarake zbatoi këtë urdhër. Brigada --
24 komandanti i policisë ushtarake i Brigadës 121 raportoi biles
25 dy pjesëtarë të policisë ushtarake Shtabit të Përgjithshëm

1 pasi dështuan të përmbushin dhe të zbatojnë vendimin në mënyrë
2 të plotë dhe të duhur. Ai përmend aty funksionin e LDK-së në
3 një fshat të veçantë si arsye kryesore për pengesën në punën e
4 tyre.

5 Parashtrimet e Mbrojtjes së Krasniqit lidhur me këtë seri
6 urdhrash nuk janë të sakta dhe janë të pavend, pra, që
7 përmendet që urdhrat e Shtabit të Përgjithshëm përfshirë ato
8 të nxjerrë nga Jakup Krasniqi janë shpërndarë dhe janë
9 respektuar, përfshirë këtu nga anëtarë të policisë ushtarake
10 të brigadës 121. Kjo tregon autoritetin e anëtarëve të --
11 autoritetin që kishin mbi anëtarët e UÇK-së -- anëtarët e UÇK-
12 së të përfshirë në këto krime.

13 Qeveria e Përkohshme e Shtabit të Përgjithshëm --
14 strukturat e Qeverisë së Përkohshme dhe e Shtabit të
15 Përgjithshëm që u diskutuan do të trajtohen në mënyrë më të
16 hollësishme -- janë trajtuar në mënyrë më të hollësishme në
17 dosjen e Prokurorisë. Të akuzuarit kishin autoritet mbi këto
18 struktura dhe i kanë përdorur ato për të zbatuar qëllimin e
19 tyre të përbashkët, planin e tyre të përbashkët kriminal.

20 Faleminderit, i nderuar Gjykatës, nesër në mëngjes do t'i
21 kaloj fjalën kolegut tim Matt Halling, i cili do të trajtojë
22 elementët që kanë mbetur lidhur me përgjegjësinë penale,
23 kriminale individuale.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Do të ndërpresim seancën deri nesër në orën 9.00 të

1 mëngjesit. Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen. Shihemi
2 nesër.

3 Mund t'ju pyes përpara se të largoheni, sa kohë keni
4 nevojë? Ka ngelur të paktën edhe dy orë e gjysëm.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po, pres që të marrim më pak se dy
6 orë, dhe pastaj Prokurorja e Specializuar do të japë fjalët
7 përmbyllëse dhe do të mbarojmë, pra, brenda kësaj kohe.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
9 Ju kemi borxh disa minuta nga sot në mëngjes, sepse filluam
10 pak me vonesë. Besoj se do të keni kohë të mjaftueshme.

11 Faleminderit të gjithëve. Shihemi nesër.

12 --- Seanca mbyllet në orën 16.37

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25